

FUTURUM I PAPRITUR

8SH2-32
K 90



novela

DHIMITER
KONOMI

8SHF-32

K 90.

BIBLIOTEKA E PIONERIT

DHIMITËR KONOMI

FLUTURIM I PAPRITUR

Novela



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NJË KTHIM
I VËSHTIRË



Troku i kuajve të egër drithëroi gjethet e pluhurosura të shkurrnajës. Zvarranikët u fshehën nxitimthi në barin e lartë, duke lënë pas gjurmë gjarpëruese. Kurrillat sqepëgjata brofën të trembara, në fluturim përtë formuar, gjerdanin e zakonshëm.

Këtë zgjim-të beftë shoqëroi me muskujt e tendosur Sydielli, pjesëtar i Fisit të Kallamave, që deri atë qast qëndronte shtmirë pranë dy trungjeve, duke përtypur me kënaqësi një rrënje të shijshme. Herë-herë kujtohej të pastronte thonjtë nga balta e zezë pa ia ndarë sytë kopesë. Ishte mësuar tashmë me këto vrapime të bujshme, që vinin, në lëvizje gjithë gjallesat e pyllit.

Kur kali i fundit humbi mes pluhurit, djaloshi u ngrit, peshoi biskun e hollë, ku vareshin disa ngjala, dhe buzëqeshi. Dielli pas qyrohej në lëkurën e argjendtë të ngjalës më të madhe, mes një perëndimi të kuqërremtë. Pas pak ky mysafir madhështor do të fshihej pas Malit-të Thinjur përt'u çlodhur në shtratin e vet të trëndafiltë. Të nesërmen do të

zgjohej po aq i bukur, me kurorën e artë në krye.

Kuajt tashmë ishin larguar, megjithatë, në veshë i kumbonte trokëllitja e thundrave, ndërsa në flegra shija e keqe e pluhurit. Shikoi rrëth e rrötull zhdukjen e hijeve 'dhe shpejtoi hapin. Edhe gjallesat e vogla ishin qetësuar. Jeta e pyllit regëtinte me ritmin e zakonshëm, fërshëllima nanuritëse e kallamavë ndanë kënetës prishej aty-këtu nga žukatja e insekteve dhe klithmat e vidrave.

Megjithëse larg vendbanimit, djali vëndosi të ecëtë më në thelli. Shtrëngoi fort heshtën e shkurtër me gür stralli të mprehtë dhe, i përkultur, rrëshqiti mes shkurrnajës. Në lirishfet ndanë ishujvë me drurë të dendur kullotnin lopët e egra. Dy dema të fuqishëm këputtin fijet e barit me buzët e trasha e në të njëjtën kohë përgjonin shtigjet me sytë e kùq.

Për fisanakun e ri gjuetia e lopëve të egra ishte gati e pamundur, por, sipas forcës së zakonit, Sydielli ngeli i ngujuar në pritë! Heshta e tij e brishtë dó të thyhej si kashë në lëkurën e fortë të këtyre barngrënësve, që bëheshin të tmerrshëm kur plagoseshin.

Djaloshi nuk ishte shumë i giatë. Piesa më e madhe e trupit mbulohej nga një lesh i shkurtër e i shpupurit mbi një lëkurë ngjyrë pishe. Në krahët e hollë muskujt jo shumë të zhvilluar lëvrinin si degë kulprash!

Sytë e gjelbër, pak të futur në zgavra, e ndihmonin të zgjidhë rrugën e përshtat shme më shpejt se çakalli. Djersa pikëlonë në ballin e ngushtë, rrëshqiste nënofullat e shtrënguara, deri në gjuhën e ashper. Athetirën e saj e shijonte shpesh duke pulitur sytë nga kënaqësia.

„Jo larg, të gjitha shtigjet të conin në thellësi të Pyllit të Madh. Atje sundonte e panjohura, ishte ariu i përhimë, kopetë e çakejve dhe qenve të degër, ishin Njerëzit e Pyllit...“

Befas djali u platis përtokë. Fărë pranë i kaloj duke turfulluar një derr më kokë pëtashiqë e dhëmbë të dalë jashtënofullave. Kjo kafshë e shëmtuar ishte shpesh më e rrezikshmë edhe se mëmuthi për njeriun e vetëm. Ndryshonte puna kur gjahtarët e fisisit ndodheshin së toku, atëherë vetë mamuthi gjigant dridhej nga frika, vetë kopeja e demave sykuq ikte nga sytë këmbët.

I fshehuri e shoqëroi me një britmë të mbytur largimin e derrit. Së shpejti muskujt do t'i forcoheshin, goja do të fliste fjalë të matura e heشتadò të qëllonte në shenjë. Veteni atëherë do të quhej i madh për t'u pranuar në grupin e gjahtarëve fë fisisit. Në moshën e tij gjuanin kafshë të vogla, rosa e peshq të kënetës.

.Veç nuk arriti të ngrihej për të valzduar rrugën. Qenien ia pushtoi një frikë

e madhe. S'po shikonte as mamuth, as bizon
Dicksa tjetër më të frikshme. Sa mirë që de-
rrri, e kishte detyruar të bëhej njësh me to-
kën!... Ndjeu një djersë të ftohtë në ballë
e zemrën t'i përpërlej në thellësi të kraha-
rorit.

Njëzet hapa më tej ecte i përkulur një
njeri. Cdo dyshim për këtë ishte i kotë. Ja
trupi muskuloz, hunda e shtypur sipër bu-
zëve të trasha e të përveshura. Ja çomangia
e rëndë në dörë dhe sëpata e gurit lidhur me
fije kulpre pas mesit.

Sydiellit i kaluan mornica në të gjithë
trupin. Njeriu shikonte me ngulm në drejtëm
të vendbanimit të tyre. Ky duhej të ishte
Njeriu i Pyllit. Aq i panjohur, sa dhe ariu
i përhimë, aq armik, sa dhe ujku i dëborës.
Djali nuk kishte parë njerëz të tjerë përveç
fisit, prandaj ndihej i trembur. Çfarë kërt-
konte Njeriu i Pyllit kaq afër shpellës së
tyre!?

Ngjeshi veshët pas barit e nga çasti në
çast priste sulmin e njeriut të panjohur. He-
shtatë dridhej lehtë në duart e shtrënguara,
kurse gjaku i vërshoi në damarë e fytyra iu
përskuq si zjarri në shpellë... A mund ta
vriste ky mëzdrak i vogël Njeriun e Pyllit?!

Një rrapiellimë krahostë oshëtiu e u
shpérnda në thellësi të tundrës, por njeriu
leshtor nuk lëvizi. Pra, ai s'kishte ardhur
përgjah! Ai shikonte në drejtëm të kënetës,

rrëzë kodrës ku ndodhej shpella e tyre. Pejzat e trupit iu mpinë si kallama të tharë e afshi i zjarrtë luftarak u shkri dalengadalë pér t'ia lënë vendin një pasigurie të ftohtë akull. Gati nuk po merrte frymë ashtu i platur përtokë me veshët pipëz.

Leshataku filloi të ecte drejt tij. Edhe mund ta kishte parë. Instinktivisht dora shtrëngoi më fort armën prej guri në pritje të një përleshjeje të pabarabartë. Por... asgjë nuk ndodhi. Njeriu kaloi bri djalit pa e vënë rë, pasi gjithë vëmëndjen e kishte përqendruar te kallamishtja dhe kodra shkëmbore. Pastaj nuhati dy-tri herë rrëth e rrötull, mbështeti çomangen në supin lakuq dhe u largua.

Fisanaku i ri vetëm pasi u bind mirë që rreziku kaloi, kërceu si këlysh ujku, tundi dy-tri herë heshtën në drejtim të armikut e sokëlliu:

— Sydielli pa Njeriun e Pyllit!... Sydielli lajmëron shpejt fisin!

Ky kushtrim i shqetësoi mjaft demat sykuq. Lopët e tufës pushuan së kulloturi, sytë e tyre të lotuar tregonin pakëz habi. Pse turfullonin e rrëmihnin tokën meshkujt e tyre?! Mos vallë kishin frikë nga një njeri i vetëm!

Sydielli sikur e kuptoi këtë mendim. Sokëlliu pér herë të dytë më fort. Oshëtima

u shpërndashesh gjethive gjelbërëshe e u shkru dalëngadalë në zhurmat misterioze. Shërbim i jashtë i dëgjatët kësaj vjetë është që sot është gjithashtu një vjet e lindjeve. Në këtë vjet, që është vjeti i dytë i përfundimit të viteve 1940-1944, u bën 20 vjetor i përfundimit të viteve 1940-1944.

Vendbanimi i Fisit të Kallamave ishte një shpellë e ulët, me tri hyrje. Lartohej në këmbë të kodrës mbi kënetë, duke u lidhur me një brez të ngushtë toke me të. Më tej vazhdonte një pllajë, harlisur me shkurre të larta, pastaj Pylli i Madh rrëzë Malit të Thijnjur.

Gjahtarët më të vjetër të fisit tregonin se, në shpinë të kënetës kalonte Pérroi si Mamuth. Asnjeri nuk kishte pasur guximin të hynte thellë në kënetë. Gjiri i saj, me ujë të ndenjur e llum fë trashë, gëlltiste menjëherë cdo kafshë a njeri që kuturiste të shkelte në brendësi... Kënelta ishte e egër, jo se hungëronte e të linte plagë, por kthetrat e saj të padukshme të mbytnin pa përdorur asnje lloj arme. Të gjithë e kishin frikë kënetën, aq sa e donin... E donin, pasi u mbronte mirë krahiët nga sulmet e bishave dhe të fiseve armike.

Shirat e shumta dhe ndryshimet e klimës i detvruai fisänakët të kërkonin streshim brenda gufave, ku flije ngrrohtë dhe i mbrojtur nga sulmet e grabitqarëve. Të vjetrit tregonin gojë më gojë se në kohët e

ngrohta shpellat përdoreshin vetëm për grumbullimin e ushqimit. Fisanakët bridhnin si era, vritnin kafshë e hanin mish të papjekur, ashtu siç ishin dhe vetë prë e bishave të më dhë, e kopeve të egërsuara dhe e thatësirës/së gjatë.

Në shpellë shtriheshin e flinin mbi lëkurë dreri. Në boshllëqet e zgavrat e vogla vendosej mish i freskët, frutat e egra, lëkurët dhe armët e gjuetisë. Nënët e Mëdha — kështu qutheshin gratë që grumbullonin më shumë fëmijë rrëth vetes — kujdeseshin për rrugjetje dhe ndarjen e gjahut, sepse atyre u dëgjohej shumë fjala në fis. Kryegjahtari mblidhte çdo mbrëmje gjahtarët e së bashku me ta bënte planet e së nesërmies.

...Djaloshi Sydiell vrapoi me sa i hanin këmbët. Shputat, megjithëse të kalitura nga ecjet e shumta në tokë të fortë, iu copëtuan këqas. Afër shpellës ndeshi një grup fëmijësh rrëth dy Nënave të Mëdha por nuk qëndroi t'u mëritë erë për të parë qfarë kishin ngrënë në mungesë të tij, as t'u tregonte gjahun, madje rrëshqiti dinakërisht, që Nënë e Mëdha e cila pastronte nga rrodot e papastërtitë disa vëlezër e motra, të mos e shikonte.

Ndali fare pak në hyrje sa për të marrë frymë thellë. Cudi! Pse gratë dhe fëmijët ishin jashtë shpellës? Me siguri që kryegjahtari po vizatonte kafshë për magjinë e gjuejisë. Gratë dhe fëmijët nuk kynin në ceremoni të tillë.

illiduhet të lëpijë kockat! Përse hyn Sydielli
këtu? Intha ai pas një heshtjeje, duke tën-
durr gjérdarin e guaskave. —
— Pritja e oftohtë dhe jodashamirëse bë
impaku djalin Goja iu mör. Luftëtarët e fosit
e shikomin vërigër.

— Djali ka parë kopenë e mamuthëva,
indihmoi i Kallamangrënësi, një gjahtar
ishkathët, me trupatë vogël, por dinak si
shqarthisi i jordit ibri. —
Sydielli mori zemër. Ata që dikur rro-
nir pranë Nënës së Madhe, pra vellezërit e
tij të mëdhenj, e pyesnin me sy. Sigurisht, e
qortonin përkëtoj fjalë të pamatura dhe fri-
kacakëh oibrom është. —
— Jo, nuk parkopenë e mamuthëve,
pa Njeriun e Pyllit! — përsëriti me një fry-
më djali. —

Prijesi nuk e fshehu habinë. Njeriun e
Pyllit vetëm të vjetrit e mbanin mend, sepse
nuk shtyhej jashtë pyjeve. Jetonte me kafshë
të pyllit, e shuanjetjen me fruta po të py-
llit. Jasod mordit të përfshirët.
Sydielli e ka vështrimin me re. Ka
parë arin e përhimë, që i ngjet shumë Nje-
riut të Pyllit, — qeshi papritur prijesi.
Të tjerët qeshën fort. Shpella e përcollë
të qeshurën valë-valë. —
Kallamangrënësi i shkathët, për habi të
të gjithëve, nuk qeshi, por iu afroa djalit
ngadalë. Heshtja sundoi përsëri shpellën. Pri-

jësi qëndron te madhështor me fytyrë ngâ
zjarri që po shuhej.

— Djali i kai shputat të copetuara!
tregoi Kallamngrënësi.

— Kalvrapuar, thirrën të tjerët
Djalit i rreh zemra si kafshë e godit
me mëzdrak! vazhdoi Kallamngrënësi
me të njëjtin ton.

Eshtë trembur, pasuan të tjerët.
Kallamngrënësi mbështeti mollëzat e
gjithërinjve në gjoksin lektor, picerroi sytë
dhe tha:

Sydielli nuk është trembur! Sydielli
nuk genjen! Ai e pa Njeriun e Pyllit.

Pjesa më e madhe e burrave britën me
kënaqësi. Si kështu! Ata kishin dale përdite
në gjueti, kishin ecur dhe deri në pyll. Mos
vallë nuk i besonin ata hundës së tyre të
mprehtë?.. T'u ishin dobësuar sytë?.. Kë-
të kërkonte të thoshte ky djalë, që ende
nuk ishte pranuar gjahtar?

Kallamngrënësi e kuptoi fare mirë me
ndimin e fisanakëve. Atij, aq i bente, Nënqeshjet e Ujkvrasësit, Leshataku t dhe Hundë-
trashit ishin kërcënuese, pak mund të mate-
shin me ta në fis. Vec njihnin dhe dinakë-
rinë e shkathësinë e tij, të cilat prijesi i
merrte parasysh kurdoherë.

Sydiellit ndërkohe i erdhë disi fytyra,
Përkrahja e një gjahtari të madh, vetë Ka-

bishat e shumta. Me gjithë besimin që kishin në zgjuarsinë e tij, pjesa më e madhe e vlerëson te këtë udhëtim si kuturisje lavdie. Të tjerët gjykonin më shtruar. Rreziku sado i vogël nuk duhej marrë lehtë; jeta u kishte treguar që sulmet nga fiset armike mund t'u vinin nga çasti në çast... Pse të mos zbulohet qëllimi i këtij fisi që rronte në pyjet e thella?... Këtu i puqej mendimi dhe prijësit.

— Kallamngrënësi të niset matanë, drejt pyllit, — tha hijerëndë Shtatfieri, duke tundur maskën dhe gjerdanin e guaskave, — bashkë me të të nisen dhe dy gjahtarë të tjerë!

— Kallamngrënësi dëshiron të marrë me vete Sydiellin, — u hodh papritur fisanaku i shkathët.

Këto fjalë e dyfishuan habinë. Çfarë bluante në kokë Kallamngrënësi?... A merrëj me vete ai djalosh, që ende nuk ishte pranuar gjahtar?! Nata do të ishte e gjatë, koha e shirave të rrëmbyera gati po trokiste në dyert e qiellit. Në pyllin e madh errësira dhe befasia të kafshonin më keq se ujku.

Leshataku nuk e përbajti të qeshurën.

— Sydielli është sa një këlysh ariu! Do të ngelet mes rrënjjëve.

Djaloshit iu prenë gjunjët. Përbuzja e të mëdhenjve e preku shumë. Ai tashmë

nuk ishte i ri, pse nuk kishin besim?!. . .
Muskujt i ishin forcuar mjaft, dinte të rrëshqiste në bar pa u ndier, duronte dy dalje dielli pa ujë. Vallë nuk mjaftonin këto?

— Ne po shkojmë për të parë afrimin e fisit armik, — vazhdoi Kallamngrënësi me fytyrë drejt prijësit. — Kopeja e mamuthëve nuk zbulohet nga gjithë gjahtarët. Thundrat e tre kuajve të mëdhenj bëjnë më shumë zhurmë në pyll, se zhurma e një kali dhe një mëzi.

Shtatfieri kryqëzoi duart. Në këto çaste duhej të merrte një vendim. Në ditë të vështira mendimi i prijësit ishte ligj.

Gjykimi në heshtje zgjati për disa minuta. Djali duhej të kishte parë diçka dhe kjo nuk ishte shenjë e mirë... Mendimi i urtë i Kallamngrënësit peshonte shumë; fiset e pyllit kërkonin shpella dhe kjo prapë nuk ishte shenjë e mirë. Fisanaku i shkathët duhej të shkonte për zbulim.

Prijësi uli duart, i kryqëzoi tri herë dhe tha:

— Kur të dalë Dielli i Natës sa gjysmat e gishtave të dorës sime, Kallamngrënësi të jetë pranë fisit. Sydielli le të shkojë me të!

Sydielli klithi nga gjëzimi. Madje iu duk se edhe Leshataku i ashpër e vështronë me admirim.

Vellezërit goditën jo lehtë në kurriz si shenjë miqësie, kurse Kallamngrënësi

vazhdoi të heshtte. Ë ndiente shumë përgjegjësinë e këtij udhëtimi.

3

Turma zhurmëmadhe e gjahtarëve të fisit i përçolli pranë kufirit të zakonshëm të gjuetisë.

Të dy ishin armatosur lehtë. Kallamngrënësi mbante një sëpatë të mprehtë guri dhe një heshtë të shkurtër, kurse Sydielli një topuz të vogël me eshtra bizoni.

— Ne do të kthehem! — tha në vend të përshëndetjes Kallamngrënësi e së bashku me djalin humbi në thellësi të shkurrnajës.

Koha nuk premtonte asgjë të mirë. Tisi i hollë i reve të mëngjesit u shndërrua pak nga pak nga era e lagësht në shtëllunga të dendura resh ngarkuar me rrebesch. Degët e pemëve dhe filizat e shkurreve fërshëllenin një këngë monotone, ndërsa bari i harlisur përkulte shpinën e gjelbër e dukej sikur i lutej tokës, që priste e vrenjtur pikat e shiut.

Dy fisanakët kishin kohë që nuhatnin lagështirë. Shiu do t'i pengonte shumë në rrugë.

Kallamngrënësi kontrollonte me kuj-

des çdo gëmushë e shteg, i ndjekur hap pas hapi nga djaloshi, që tashmë kishte mposhtur frikën e njeriut kur largohet nga trevat e njohura.

Fisi i Kallamave ndodhej në drejtëim të Yllit Mëngjesor. Asnjëherë nuk duhej harruar rruga, e vëtmja shpresë për t'u kthyer, Përvoja e gjatë i kishte mësuar gjahtarët të mbanin mend mirë gëmushat e vëçuara, ndonjë sop të ngritur, trungjet e rrëzuara, hijet e mbrëmjes, të cilat të ndihmonin mjافت për gjetjen e saj.

Duke çarë me vështirësi gruroret e egra, pellgjet me gjineshtra, gjembaçët e lartë, Kallamngrënësi herë pas here kthente kokën e kënaqej me ecjen e djaloshit. Sydielli e kishte syrin pishë e s'lejonte të zmadhohej largësia e ndjekjes. Sa mirë që zgjodhi këtë djalë të shkathët... Trupat e rëndë do të lodheshin gjatë vraptimit në rast rrëziku:

Sipër drurëve zhurmonin mjافت shpendë. Çafka, kurrilla, bajza e piska flatraverdhë lodronin majë degëve dhe në qiellin ngjyrë çeliku. Këtyre anëve gjahu ishte i shumëllojshëm dhe më i pasur, por dy njerëzit që ecnin lehtë si mace të egra kishin tjetër detyrë. Çdo veprim i shkujdesur, një zhurmë e kotë mund të sillte pasoja të pakëndshme.

Vendosën të pushojnë pranë një lirish-

teje me tērfil tē kuq. Tufat e bajukave që kērkonin qetësish ushqim, kērcyen tē trembura duke lēshuar klithma tē çjerra pakë-naqësie. Tej, nē shqopat e dendura, u ndien hungërima tē ndërprera dhe një erë kérme.

— Hienat! — u ngrit gati për luftim Sydielli.

— Nuk kemi kohë për to! — qeshi Kallamngrënësi, pa lëvizur fare nga vendi. Gjahtari i vërtetë nuk trembej kurrët nga hienat.

Djaloshi u qetësua. Duhej tē tregohej më i matur nē tē tilla raste. Shoku do tē mendonte keq për tē. Së shpejti do tē pranohej gjahtar, frikacaku nuk pranohej nē radhët e tyre.

Kapërdinë nē heshtje një copë mish dreri tē ftohtë. Mungesa e një zjarri u kujtoi vendbanimin. A i pritnin?... Tashmë ata ishin larg, por zemrat e njerëzve i bashkon kujtimi, i bashkon qëllimi i përbashkët, lufta për jetën...

Sydielli lëpiu mirë e mirë gishtat, mëdje edhe thonjtë e gjatë. Kallamngrënësi shikonte me vëmendje qiellin e rënduar me re. Ç'fshihej nē thellësi tē asaj mase tē vrenjtur?!

— Qielli së shpejti do tē sulmojë tokën!

Gjahtari shënoi me gishtin tregues tri hardhucka tē verdha që gërmonin me nxitëm. Puna e këtyre zvarranikëve tē vegjël

s'ishte e zakontë. Dukeshin të shqetësuara, tē trembura.

Shpejtuan dhe ca hapin. Përpara hasën trungje tē rralla, pra Pylli i Madh nuk duhej tē ishte larg. Dëgjuan ulërimat e një tufe drerësh që vraponin, por askush nuk u interesua pér to. Kafshët nuhatnin ajrin e lagësht me sytë drejt qiellit.

Vendi ku ecnim tanë ulej, toka bëhej më e lagët, më rrëshqitëse.

Kallamngrënësi ndali fare papritur me dorën drejt një bërryli, ku dallohej qartë një masë ujore, që shungëllonte frikshëm.

— Pérroi si Mamuth! — belbëzoi ai i tronditur.

Sydiellit i kaluan tē ngjethura emociioni në gjithë trupin. S'kishte parë asnjetëherë masë kaq tē madhe uji. Sa i gjerë ishte! Si shkumëzonte vende-vende, duke tërhequr me vete gurë e copa trungjesh! Djali qëndronte i heshtur pérpara këtij misteri tē natyrës, por sytë i shkëlqenin nga kërshëria. Befas u vrenjt dhe pyeti me shqetësim shokun:

— Si do tē kalojmë?

Tjetri ngriti supet. Pérderisa Njeriu e Pyllit e kishin parë fare afër vendbanimit, Pérroi si Mamuth kalohej.

Bregun e kontrolluan me kujdes. Nuk hasën asnjetë vend tē cekët. Kudo shtrihej uji që lëvizte. Dy fisanakët u lodhën duke

baritur anës lomit. Kjo pengesë ujore sikur ua veniti shpresat për të takuar Njeriun e Pyllit. Të kishte gabuar Sydielli?! Dyshimet e Leshataku po vërtetoheshin. Si mund të kalonin njerëzit Përroin si Mamuth?

Diku duhej të kalohej, shfrynte Kallamngrënësi, që nuk dorëzohej lehtë. Çdo kafshë ka dobësitë e veta, arsyetonte ai.

Do të kishin qëndruar gjatë pranë brengut, sikur të mos u kishte tërhequr vëmen-djen një trokëllimë e mbytur, që shpesh shkrihej në lëkundje si tërmët. Të tillë ecje, një vrapi i çmendur i shoqëruar me pluhur e pallje të frikshme, bënин vetëm urusët.

Lëkundja sa vinte e shtohej. Kopeja, sipas të gjitha gjasave, i afrohej lomit. Gjethet e drurëve filluan të fëshférinin lehtë, ndërsa buburrecët e insektet e tjera të tokës e shpejtuan më shumë punën për të hyrë thellë në tokë.

— Largo hemi!... Kopeja mund të na shtypë... — tha Kallamngrënësi.

Vendi ku u fshehën, një lis i trashë, të cilin e ngjitën me vështirësi, kontrollonte gjithë bregun e lomit. Prej andej dalluan shtëllungën e pluhurit e pas një çasti kopenë e urusëve. Fisanakët nuk e fshehën habinë. Askush nuk po i ndiqte. As tufa e qenve

të egër ose e ujqve, as leopardi që i sulmon-te zakonisht.

Sytë duheshin bërë katër... Njeriu shpesh sulmon fshehur mes barit... Por as-gjë!... Kopeja vraponte si e tērbuar, pa as-një shkak.

— Urusët janë trembur. — Sydielli vë-shtronte shpinën leshtore me dy gunga, kokën kaçurrele e mjekëroshe, sytë me bebëza të palëvizshme të këtyre thundrakëve të më-dhenj.

Gjahtari i vjetër përgjonte pëllitjet e mbytyra. Urusët parandienin diçka më të frikshme se sulmi i bishave ose i njeriut. Gjithë tufa ishte përfshirë në një panik të madh. Kafsha që rrëzohej, shtypej pa më-shirë nga kafshët që vinin më pas. Britmat e agonisë shpërndaheshin në pyll si një këngë e përvajshme.

Ndodhte që tufa kapërdinte barin e keq, mbasë i ndiqte miza e tmerrshme e pyllit, ose prijesi kërkonte të tregonte fuqinë e vet. Raste të tilla kishte parë dhe dëgjuar shumë, megjithatë, ky vrapim kishte diçka të veçantë.

Barngrënësit e fuqishëm ndaluan pa-pritur në breg të lumit. Përçori, një dem i lartë që dallohej nga të tjerët, nuhati dy-tri herë ajrin, pastaj ktheu në të majtë. Kopeja e ndoqi e bindur. Tashmë pëllitjet u dobësu-an. Kafshët shikonin ujin e turbullt dhe rrë-mihnin dheun.

Të fshehurit pritnin me padurim. Një shpresë e vakët ua ngrohu trupin. Si dukej kafshët kërkonin të kalonin lumin me çdo kusht. Do të dëshironin me gjithë shpirt të mësonin dhe ata vaun.

— Urusët po kalojnë Pérroin si Mamuth! — s'e përbajti gjëzimin Kallamngrënësi.

Uji u vinte kafshëve deri në gjunjë. Pra në atë vend lumi kalohej kollaj. Dy fisanakët pritnin me trupat njeshur rrëzë trungut.

Kur urusi i fundit kaloj matanë, Kallamngrënësi brofi dhe, gjysmë i përkulur, i bëri me shenjë djalit ta ndiqte pas me kujdes. Uji ishte i ftohtë dhe këmbët u rrëshqitnin në zallin veshur me llum e leshterikë të gjelbër. Po kështu, nuk duhej ndarë vështrimi nga shtigjet e pyllit, ku rreziku përgjonte vazhdimisht.

Vau i priu drejt Pyllit të Madh. që zhurmonte ngajeta e kafshëve, e shpendëve e insekteve të ndryshme. Bimësia harlisej në trungjet e veshura me myshk të dendur e pliksej në kulprat kacavjerrëse. Dendësia e madhe të merrte frymën. Ajri i lagësht përzihej me aromat e luleve petalemëdha, hynte në fytin e dy njerëzve, duke i detyruar të teshtinin vazhdimisht.

U ulën të clodheshin, por shpejt dëgjuan një zhurmë të dyshimtë:

Kallamngrënësi drejtoi shtatin. Kopeja e urusëve tashmë ishte larguar. Trupat e rëndë të kafshëve hapën një shteg të gjerë mes bimësisë së dendur, që kullonte gjak nga gërvishtjet. Kjo rrugë nuk duhej ndjekur kursezi. Më mirë të çanin me vështirësi në drejtim të pashkelur. Zhurma që dëgjuan pak kohë më parë, nuk ishte shenjë e mirë.

— Sydielli të mos largohet shumë! — porositi djaloshin Kallamngrënësi me gjysmë zëri.

Zhurma u përsërit, tashmë shumë afër. Ecje katërkëmbëshe, lehje të ndërprera dhe dihatje.

— Ujq! — skërmiti dhëmbët Sydielli. Tjetri mohoi me një të tundur të kokës. S'i dukeshin ujq. Këta mishngrënës të shkathët e të fuqishëm nuk ecin shpejt, as nuk lehin gjatë... Ishin qen të egër.

Kopeja e uritur nuhaste gjahun e dobët. Qentë e egër shpesh sulmonin edhe njeriun, sidomos kur i pengonte në pre. Kishin dhëmbë të mprehtë dhe kur bashkoheshin, bëheshin tepër të rrezikshëm. Një armik i tillë asnjeherë nuk duhej përbuzur.

Fisanakët u përgatitën për luftë. Qentë me siguri ndiqnin gjurmët e freskëta, të cilat nuk mund të fshiheshin lehtë. Rreth e rrotull sundonte bimësia e kreshpëruar, që do t'u vështirësonte vrapiçimin.

Sydielli shtrëngoi topuzin e lehtë. Ndo-

nëse ishte përlleshja e parë me të tillë mishngrënës, frikë nuk kishte. Njerëzit janë më të fortë se qentë e egër, flisnin sytë e ndezur. Zemër i jepte edhe gjakftohtësia e gjahtarit të vjetër.

Sulmi nuk vonoi. Përpara tyre kërcyen papritmas trupa laramanë me gojën plot jargë të bardhë. Gjuha e kuqe lëvizte lart e poshtë nga dihatja. Prej grykës dilte një gërvërimë e frikshme, e pasuar nga lehje të zgjatura.

Kallamngrënësi fluturoi mëzdrakun e mprehtë pa as më të voglin ngurrim. Njëri prej qenve u plandos përtokë barkçarë. Britma e përvajshme, përpëlitjet e agonisë në barin e thatë i detyruan qentë e tjerë të zbytheshin ngadalë. Gjahtari kérceu pranë mëzdrakut, duke lëshuar një piskamë të holdë. Qentë vrapiuan pas shkurreve.

Djaloshit i erdhi pakëz keq që nuk e përdori i pari topuzin me dhëmbë të mprehtë. Dora nuk do t'i gabonte në shenjë. Sa mirë që nuk sulmoi gjithë zogoria... Pjesa tjetër si dukej ishte sulur mbi ndonjë gjah më të majmë; në tokë shtriheshin urusë të shtypur e të dërrmuar nga vrapiimi i çuditshëm. Numëroi vetëm sa gishtat e dorës dhe ngeli i kënaqur. Le të afroheshin po të mundnin!

— Sydielli duhet të qëllojë me topuz në kokëne qenit! — porositi fisanaku i vjetër.

Gatishmëria dhe dëshira e djalit për luftë i pëlqente. Nuk kishte gabuar në zgjedhjen e vet; Sydielli do të bëhej një gjahtar i zoti.

Ndërkokë qentë e egër mësynë edhe një herë. Kësaj here u dëgjuan goditje të përpikta dhe një angullimë e dyfishtë. Në tokë përpeliteshin dy kafshë të plagosura rëndë. Edhe topuzi i lehtë kishte goditur në shenjë. Preja e tij, një qen i shëndoshë, dridhej nga dhimbjet. Sydielli kërceu përsëri, rrëmbeu topuzin dhe qëlloi së dyti, pastaj qetë-qetë hoqi thonjtë e qenit si trofe fitoreje.

Kallamngrënësi shoqëroi me admirim veprimet e luftëtarit të ri.

— Sydielli u dha dërrmën grabitqarëve!... Sydielli nuk është më fëmijë, ai është gjahtar! — tha me zë të vendosur.

Dita e shumëpritur. Sydielli mbërtheu rëndë-rëndë thonjtë e kafshës në brezin e gjëzofit dhe vështroi gjatë qiellin e rënduar me re.

Kjo fitore, ndonëse e lehtë, u dha krahë ta vazhdonin rrugën më shpejt. Tashmë ecnin krah për krah, duke çarë me vështirësi degët e ndërthurura.

Sëpata prej guri e priste me vështirësi bimësinë e virgjër të Pyllit të Madh, por krahët e fortë dhe vullneti për të çarë përrapa bënин të pamundurën.

Një bigë druri e porsathyer vetëm pesë

hapa përpara këmbëve i tërroqi vëmendjen Kallamngrënësit. Kështu mund ta thyenin drurin vetëm njerëzit.

— Njerëzit e Pyllit! — pëshpëriti trupnjethur, duke i bërë shenjë djalit të ndalonte.

Kërraba e zakonshme shtrihej pa lëvizur në barin e shkurtër të pyllit. Çdo dyshim ishte i kotë.

— Sydielli do ta njohë Njeriun e Pyllit! — u përgjigj me një zë të dridhur nga emocioni djali.

Fisanaku i vjetër vazhdoi të nuhaste rrëth e rrotull shtigjet pa bërë asnjë hap përpara. Njerëzit e Pyllit nuk ishin larg. Tanimë duhej të ecnin më lehtë se dhelpra, t'i bënин sytë më të mprehtë se skifteri, në qoftë se donin të ishin gjallë.

Më vonë rrëshqitën nën disa trungje të rrëzuara nga rrufetë e kaluan matanë shtegut që patën hapur urusët e fuqishëm. Në këto anë dalluan dhe shenja të tjera, goditje sëpatash, gjurmë në barin e shkelur dhe mbeturina hiri.

I pari që nuhati erën e tymit ishte Sydielli. Era karakteristike, aq e njohur për njeriun, përsihej me erën e mishit të pjekur.

Vendosën të afroheshin me kujdes në atë drejtim. Kureshtja e njeriut të asaj kohe për të panjohurën ishte e madhe. Si do të ishin njerëzit që i ishin afruar kaq afër

vendbanimit të tyre? Ç'plane kishin? A qenë më të fortë se fisi i tyre?...

— A vrapon Sydielli si dreri? — pyeti Kallamngrënësi, duke rrëshqitur këmbadoras. Njerëzit e Pyllit kishin mundësi të nuanatin erën e panjohur afro tri të hedhura mëzdraku larg.

— Vrapon më shpejt se dreri! — ia ktheu djali me trupin që i fërgëllonte nga kureshtja, padurimi dhe lagështia. Po sikur të pengohej në rrënjet e drurëve? Megjithëse më të rëndë, ndjekësit e egër do ta arrinin shpejt. Sydielli u shkund si për të hequr këto mendime ogurzeza nga koka.

Fisanaku i zgjuar bënte të tjera plane. Nuk kishte asnje dyshim në vullnetin dhe shpejtësinë e djaloshit. Ata do t'i linin shumë prapa ndjekësit po qe se arrinin t'u afroheshin, madje t'u rrëmbenin diçka si shenjë. Njerëzit e fisit s'bindeshin lehtë me fjalë, shenja ishte ndryshe. Të ktheheshin në vendbanim e të tregonin për çfarë kishin parë ishte e kotë; asnje nuk do t'i besonte. E vetmja mënyrë ishte rrëmbimi i një arme. Dihej edhe vështirësia: asnjeherë nuk e lëshonin armën pa luftë dhe pa përpjekje njerëzit e lashtë.

Këtu duhej pak dinakëri. Afrimi i kotë, i pamenduar, era që lëshonin trupat e djerisit, do t'i alarmonte ata më shpejt, kështu që rrëmbimi i shenjës do të dështonte...

Papritur Kallamngrënësit iu kujtuå gjahu i bizonit. Luftétari lyhej nga koka në këmbë me një bar që lëshonte aromë të fortë, pastaj avitej lehtë pranë tufës që kullos-te qetësish. Bizonët e ndiejnë shpejt rrezi-kun, por era e barit i tradhtonte. Ata nuk mund ta merrnin kurrë me mend marifetin e njerëzve. Afrimi në një largësi të përshtat-shme shoqërohej nga një kërcim i shpejtë, heshta e gurtë ngulej në trupin e bizonit më të afërm. Luftëtarët e fisit ngriheshin ndër-kohë me sokëllima të zgjatura si një trup i vetëm e me çomanget e rënda thyenin shpi-nën e fortë të kafshës. Tufa largohej e trembur nga ky sulm i papritur, e sidomos nga triumfi i gjahtarëve.

Bimën aromëlëshuese e njinte mirë Kallamngrënësi dhe e gjetën pa vështirësi. U lyen mirë e mirë me lëngun e saj dhe vazhduan rrugën gjithmonë të përkulur. Era e barit, që i mbronte nga nuhatjet, përhapej kudo. Dy fisanakët ecnin me sytë katër. Gjurmët e kopesë dredhonin përmes një zo-ne pylli të përzhitur nga zjarret e rrufeve. Trungjet e nxira dhe bari i shkurtuar si prej një kose gjigante vende-vende të shtinte frikën. Zonës ku dallohej tymi dhe mendonin se do të ishin Njerëzit e Pyllit, iu afruan me kujdes.

Sydielli nuk kishte gabuar.

Me mënjanimin e disa shkurreve panë

një grumbull njerëzish, shtatmëdhenj, pak të përkulur e leshtorë. Ndanë zjarrit piqej një kofshë urusi. Rreth e rrötull qenë shpërndarë heshta të rënda, me një majë të mprehtë guri të thyer, çomange me gunga të palatuara mirë dhe copa gjëzofësh.

Sydielli shtrëngoi fort krahun e shokut. Njerëzit e Pyllit!... Njeriu që kishte parë ishte midis tyre. Sytë e gjelbër të djaloshit nuk mund të gabonin. Po ajo ecje, po ajo lëvizje koke, po ajo shprehje e fytyrës.

Kallamngrënësi i buzëqeshi për t'i dhënë zemër. Edhe vetë ishte i lumtur; besimi që kishte pasur te djali nuk kishte shkuar dëm.

Njerëzit e panjohur rrinin të qetë. Si dukej nuk ishin shqetësuar aspak nga afri-mi i fisanakëve të tjerë; era e barit po e bënte punën më së miri. Njëri prej tyre, më i shëndoshi, me krahë të gjatë e muskulozë iu afrua zjarrit, nguli një copë shkop në mishin e pjekur, i mori erë për një kohë të gjatë, pastaj turfulloj i pakënaqur.

Fisanakët e fshehur gati nuk po merrnin frymë. Numëruan sa gishtat e dy duarve Njerëz të Pyllit, megjithëse s'po vendosnin ende të rrëmbenin diçka. Një çomange shtri-hej vetëm pesëmbëdhjetë hapa larg vendit ku ishin ngujuar.

Shiu i fortë që filloi papritur, i shqetësoi tepër njerëzit rreth zjarrit. U dëgjuan

thirrje ankimi, frike, përpjekje për të mbrojtur zjarrin nga shuarja. Rrufetë çanë ajrin duke prishur atë qetësi të rrème që sundonte pak caste më parë. Të gjithë diskutonin për një strehë pa lagështi, pa frikën e rrufeve. Sigurisht që lëshonin pak tinguj dhe copa fjalësh, megjithatë, shenjat kuptohe-shin mirë. Kérkonin shpella, kérkonin gufa të përshtatshme. Këto përpjekje tregonin më së miri edhe afrimin e tyre kaq afër kodrave shkëmbore, rrëzë Malit të Thinjur.

Kallamngrënësi bluante në kokë planin e rrëmbimit të çomanges. Njerëzit e Pyllit do ta kishin vështirë ta ndiqnin mes shtigjeve të pyllit, kështu që do të kishin kohë të largoheshin e të humbitnin mes tundrës së pafund. Gjahtari i zgjuar mbante mend mirë edhe vaun, pastaj fisin e kishin afër. Bashkë me luftëtarët e tjerë do t'u bënin më mirë ballë ndjekësve.

— Sydielli të vrapojë në shtigjet e ngushta. Kallamngrënësi do të rrëmbejë çomangen e do ta ndjekë pas, — i pëshpëriti planin djalit, që mezi priste. Uji i ftohtë rrëshqiste nga flokët e gjatë në shpinë. Shiu po e shtonte furinë. Një goditje rrufeje u dëgjua me tërsëllimë fare afër, shoqëruar nga klithmat e njerëzve të trembur, që shikonin qiellin e zi.

Gjahtari i shkathët këtë priste; kérceu si panterë pranë çomanges më të afërt, duke

e shtrënguar fort. Njerëzit e Pyllit shtangën nga kjo e papritur. Asnjë nuk lëvizi. Kallamngrënësi sokëlliu triumfator dhe çau me gjithë shpejtësinë drejt shtegut ku tashmë vraponte Sydielli. Dy fisanakët nxituan si zogu, duke i lënë njerëzit leshtorë gojëhapur.

Papritur turma lëshoi një «hua» të egër. Hutimi i çasteve të para i la vendin një tërbimi të madh. I kishin grabitur në mes të ditës vetëm dy qenie të panjohura, por që ngjasonin shumë me ta. Harruan shiun e madh dhe shkëlqimin verbues të rrufeve, harruan mishin e pjekur që s'e shijuan. U turrën drejt shtegut me thirrje luftarake.

Kërcitja e degëve të thyera dhe llokoçitja e këmbëve në pellgjet e ujit u ndien për një kohë të gjatë.

4

Koha e keqe i ndihmoi. Të thirrurat e ndjekësve, që vazhdonin me këmbëngulje vrapin, dalëngadalë u dobësan. Këmbët e shpejta krijuan një largësi të madhe, që sa vinte e zmadhohej. Rruga ishte mjaff e vështirë; duhej të caje bimësinë e pleksur si rrjetë që të kapërceje me një frymë trungjet e rrëzuara; shpeshherë të zhyteshe deri në gjoks në gropë të thella mbushur me ujë.

Sigurisht, këto pengesa i lodhën fort të dyja palët, të ndjekurit dhe ata që ndiqnin.

Dy fisanakët as guxonin të kthenin kokën pas. Nga goja u dilte një avull i dendur dhe kraharori gati sa nuk u çuhej nga lodhja e madhe. Rreth e rrotull nuk pipëtinte asgjë e gjallë. Një heshtje e keqe, që prishej vetëm nga pikat e shiut dhe krismat e rrufeve, sundonte kudo. Uji rridhte sikur të ishin shpuar gjithë hambarët e qiellit, që ishte bërë një me tokën.

Kallamngrënësi ndaloj më shumë i shqetësuar nga kjo heshtje që të kallte datën. Çomangen e Njerëzve të Pyllit e kishte në duar; ky send i çuditshëm mbante ende erën e armiqve. Me gjithë lodhjen dërrmuese, filloi të shqyrtonë me kureshtje armën e Njerëzve të Pyllit. Asgjë e veçantë... Pak më e gjatë se ato të fisit të vet, me një gdhenje të ashpër dhe pa rrumbullakim. Kjo ishte prova më e mirë e afrimit dhe vlente shumë. Pranë iu afrua edhe Sydielli, i dërrmuar nga vrapi i shpejtë, por edhe i gjëzuar nga fitorja.

— Kallamngrënësi është trim!... Ai ua hodhi Njerëzve të Pyllit.

— Sydielli është i shkathët... Shtatfieri do ta pranojë me gjahtarët, — ia ktheu Kallamngrënësi i kënaqur.

Pas kësaj vazhduan rrugën duke ngadalësuar hapin, jo vetëm se u bindën që

ishin larguar shumë nga ndjekësit, por edhe se ecnin pa asnë drejtim, të penguar nga rrebeshi. Moti u egërsua. Qielli u nxi më te-për. Rrëketë e ujit shpërthenin si përrenj të vegjël kudo. Në të tillë kohë ishte shumë vështirë të ndiqeshe. Tashmë fisanakët kërkonin andej-këtej ndonjë strehë të sigurt.

Toka gulçonte e mbytur nga stuhia. Asnjë ndriçim. Asnjë zë kafshe. Era fërshëllente e thyente pa mëshire degët e pemëve, që ankoheshin me kërkellimë të dhimbshme.

— Duhet të fshihemi, — tha me zë të shuar Kallamngrënësi. Shprehja e fytyrës tregonte një pasiguri të dukshme. Forcat e natyrës, këto forca të errëta për njeriun e asaj kohe, ishin të frikshme e misterioze. Askush nuk i kuptonte. Të gjithë tulateshin në gufa e shpella kur zemërohej moti, kur shungëllonte e dridhej toka nga dora e panjohur që kishte çelësat e qiellit. Secili pë-shpëriste fjalë të shkëputura, lutje e shenja në pritje të fatit.

Sydielli dridhej nga të ftohtët. Shkelte në gjurmët e gjahtarit më të vjetër, na ditur ku shkonte. Pak ditë më parë qielli ndriste e kaltëronte, zogjtë cicëronin, ndërsa insektet gëlonin mes gjelbërimit të dendur.

Nevoja për një strehë u bë e fuqishme. Poshtë degëve të pemëve s'qëndroje dot. Era e fortë rrëmbente në krahët e saj gjithçka. Litarët e pandërpërreë të shiut shembnin

edhe strehëzat më të forta me gjethe që mundoheshin të ngrinin aty-këtu... Dëshira për jetën, kjo ndjenjë e fuqishme njerëzore, nuk i la në baltë; poshtë një rrëpire vunë re disa trungje tepër të trasha, që dalloheshin mirë. Degët e gjata përkuleshin dëri në tokë, po nuk thyheshin. Trungu i vjetër kri-jonte disa zgérbonja të gjera e të thella.

— Ja, atje duhet të fshihemi, — tregoi i gëzuar Kallamngrënësi.

Njerëzit u drejtuan menjëherë për atje. Vec dikush tjetër ishte strehuar në zgérbonjën që gjykuani më të përshtatshme. Afri-mi i njerëzve e shqetësoi të strehuarin, që filloi të krakariste e të godiste trungun me sqep; siç dukej, ky banues s'donte kurrsesi të dilte jashtë në këtë kohë.

I pari vendosi të ngjitej deri në zgérbonjë Kallamngrënësi. Trungu i lagur e vësh-tirësonte shumë ngjitjen, megjithëse gjah-tari përpiquej me të gjitha forcat. Thonjtë e mprehtë e ndihmuan të kapej pas ndonjë plase e kështu, metër pas metri i afrohej zgavrës. Sydielli vëzhgonte hyrjen, i gat-shëm për të lajmëruar shokun. Brenda zgas-vrës tashmë dëgjoheshin fëshfëritje krahësh, kurse në tokë binin copa lëmyshqesh e lë-vozhga druri.

Kallamngrënësi ngjitej më kujdes. Herë-herë me sépatën e tij të mprehtë formonte të thelluara për të vendosur këmbët. Në të

njëjtën kohë kujdesej të çlodhej; e dinte që shpendi i strehuar në zgavër s'do ta lëshonte pa luftë vendin e ngrohtë.

Zgavra në trungun e trashë mjaftonte për të dy. Këtë gjë e vuri re menjëherë gjah-tari i vjetër. Një strehim të sigurt do ta kishte zili kushdo në këtë rrebesch, edhe pse ndodhej në një lartësi të madhe nga toka. Kur iu afrua mirë folesë, luftëtar u zembraps i trembur. Shpendi nuk ishte aq i vogël sa kujtonte, kishte dy krahë të fuqishëm, që llapashiteshin, duke krijuar një rrzymë të fortë ajri, një sqep të përkulur nën gushë dhe thonj të tmerrshëm në këmbët musku-lozë. Ky kundërshtar mund të copëtonte leh-të edhe trupin e njeriut.

Stepi për një çast i mbërthyer në degët e pemës gjigante. Mendoi të mos sulmonte vetë i pari, që për çdo rast të mos humbiste drejtpeshimin. Asyeja njerëzore triumfoi mbi instinktin. Shpendi, i zemëruar, sulmoi duke përplasur krahët me furi. Thonjtë e mprehtë do ta kishin rrëzuar përtokë luftëtarin po qe se ky nuk do të përkulej me shkathësi nën degë. Shpendi u përplas pas trungut ndërkohë që luftëtar kacavirrej në-për degë pa e humbur toruan.

Sydielli poshtë lëshoi një britmë para-lajmërimi. Shoku ndodhej në rrezik, pasi shpendi i fuqishëm do të sulmonte prapë. Si ta ndihmonte?... S'bëhej fjalë të hipte dhe

vetë në trung; do të vonohej shumë dhe ndihma nuk do të viente fare. Kështu që djalit i ngeli të shikojë me gjak të ngrirë veprimet e mëtejshme.

Kallamngrënësi i shkathët u rrotullua si ketër majë degës ku mbahej, pa lëshuar armën nga dora. Shpendi i përplasur keq pas trungut, e humbi drejt peshimin. Gjah-tari e priste këtë çast; i dha një goditje të shpejtë me sëpatën e gurtë në njërin krah, që u var si degë e thatë. Shpendi tani nuk mund të fluturonte, por përpiquej të mbahej me thonjtë e fortë dhe krahun e padëmtuar në trungun e lagur. Goditja e dytë, tanimë në kokë, e mundi krejtësisht shpendin, që u rrëzua në tokë mes përpëlitjeve të fundit.

Sydielli vrapi menjëherë pranë me topuzin ngritur lart. Sytë e shpendit të madh koteshin në agoni. Djaloshi u kthyte i sigurt, i shoqëruar nga vështrimi i Kallamngrënësit, që e priste lart në pemë.

Zgérbonja ishte e thatë. Dy fisanakët u shtrinë të mbështetur në supet e njëri-tjetrit, pa shkëmbyer asnjë fjalë. Pranë kishin comangen, që e rrëmbyen me aq mund e djer-së. Jashtë era tërbohej, duke shoqëruar me një piskamë të fortë zhurmën monotone të shiut të furishëm. Një gjëmim i mbytur, si zë kafshe kapur në kurth, vinte diku nga thellësia deri në veshët e tyre. Ky gjëmim i llahtarshëm i shqetësoi shumë njerëzit e

lashtë. As kopeja më e madhe nuk zhurmonte kështu. Rrufetë shungëllonin ndryshe... C'të ishte?!

Me gjithë lodhjen e madhe, dëgjuan për një kohë të gjatë me veshët ngrehur këtë gjëmim të dyshimtë. Por gjumi ua mbylli sytë vetiu dhe trupat u shkrinë në një preje, që ta jep vetëm ky mysafir i përditshëm.

5

Drita e mëngjesit hyri pak me vonesë në gufën e drunjtë, përkëdheli fytyrat e fisanakëve, që u zgjuan duke u dridhur. Trupi u ishte bërë akull. Kallamngrënësi vuri re se ana e brendshme e lëvores kishte futur ujë. Në fillim nuk u besoi syve dhe vendosi ta prekte me dorë pjesën e qullur. C'po ndodhët kështu... Kaq shi kishte rënë!

Largoi me kujdes shkarpat dhe gjethet me të cilat kishin maskuar hyrjen, dhe ngeli i shtangur. Pamja që vërente jashtë ishte e pazakontë. Kudo ujë, vetëm ujë... Uturima vazhdonte të dëgjohej pandërprerë, ndonëse shiu kishte pushuar. Degë të thyera, trungje të rrëzuar nga era e fortë lundronin andej-këtej në masën e ujit. Shumë prej tyre përplaseshin me një kërkëllimë të mbytur pas pemëve që ishin ende në këmbë.

— Përroi si Mamuth ka ardhur te ne!
— tha ai gojëhapur.

Sydielli ngeli edhe më i habitur. Shkulmet e ujit të shkumëzuar, që gati po përpinin gjithçka, të shtinin frikën. Mendimi se ishin në mëshirën e kësaj mase të stërmadhe uji i hutoi. Ku të zbritnin?... Ku të mbaheshin?!... Uji do t'i rrëmbente si fije kashte në gjirin e tij dhe ishin të humbur. Dy fisanakët u shikuan sy më sy. Një pëngesë e madhe u kishte dalë përpara. Kthimi do të ishte i vështirë.

Këputën me shumë mundime një degë të gjatë për të provuar thellësinë. Dega u zhyt thuajse e gjitha. E vërteta i hidhëroi pa masë. Po qe se nuk do të largohej uji, ata do të vdisnin me siguri nga uria në këtë zgërbonjë druri.

Pas disa orësh pushoi edhe era e rrëmbyer, por uji vërvonte kudo. Dy të ngujuarve në trung u duhej të luftonin edhe me milingonat e mëdha, të cilat, të trembura nga kjo përblytje, kërkonin shpëtim ku të mundnin. Ushtria e tyre s'u tërroq aspak para njerëzve. Insektet u kërcenin në qafë, nëpër gjymtyrë, duke i pickuar me egërsi. Fisanakët mundoheshin t'i shtypnin trupat e pështirë, por ato ishin mizëri.

Kallamngrënësit, që i pillte mendja, bëfas iu kujtua një marifet i vjetër. Me tym insektet largoheshin menjëherë. Gurët e zjarrtit i mbante gjithmonë me vete; i përplasi disa herë me njëri-tjetrin dhe ndezi disa lë-

myshqe të thata që tymosnin. Le të duronin pak djegien e syve, insektet e beszdisshme do të ngjiteshin më lart në pemë, ata mund ta nxirrnin pakëz kokën jashtë dhe të merrnin frymë lirisht.

Tymi i dendur përfshiu gjithë zgavrën, por dy njerëzit duronin duke dihatur rëndë. Pas pak milingonat u zhdukën si me magji. Tani mund të merrnin frymë lirisht e të mendonin për fatin e tyre. Uji nuk kishte zbritur nga niveli i mëparshëm. Mund ta prekje lehtë me dorë ose me thembrat e këmbëve. Edhe uria bënte punën e saj. Zorrët u kërcitnin dhe s'kishin asgjë për të vënë në gojë. Mishin e shpendëve e kishin mbaruar. Rreth e rrötull nuk kishte as fruta të egra. Trupi u kërkonte me këmbëngulje ushqim të freskët. Sytë filluan të kapiteshin, ndërsa gjymtyrët dridheshin nga të ftohtët e dobësia.

Më e keqja ishte se nuk dinin aspak sa ishin larguar nga vendbanimi dhe në ç'drejtëtim ishte fisi i tyre. Qielli i vrenjtur s'të tregonte asgjë. Asnjë shenjë s'mund të dalloje në këtë përblytje. Kafshët ishin zhdukur. Zogjtë nuk ndiheshin. Vetëm ajo zhurma ngjethëse zotëronte kudo.

Shumë kohë kaluan me përpjekje të dëshpëruara për të shpëtuar nga ky kurth i natyrës. Provuan të kapeshin nëpër degë e të kalonin nga pema në pemë, por edhe

më tej sundonte uji. Asnjëherë s'u kishte shkuar ndër mend se kishte armiq kaq të fuqishëm. Njerëzve të Pyllit u ikën paq, madje edhe me një trofe. Kundër qenve të egër fituan. Po tani?

Dy fisanakët, mbështetur sup më sup duke u dridhur nga të ftohtët dhe frika, pritnin vdekjen.

— Shiko!... — klithi papritur Sydielli me gishtin tregues përpara.

C'të kishte parë djali?!... Pse i shkëlqenin sytë dhe i mbahej goja?... Kallamngrënësi ndjeu një të dridhur të lehtë në krahun ku ishte mbështetur djali...

Mbi ujë lundronte një lëvore e trashë trungu, gati dy hapa e gjerë dhe katër e gjatë. Sipër saj mbahej sa mundej një kafshë leshtore, që herë pas here llokoçiste putrat në ujë. Për çudinë e tyre të madhe copa e trungut zhytej pakëz, por nuk përmbytej e as kthehej, por notonte me kafshën në kurri zyrejt rrymës.

— Është ari! — tha Kallamngrënësi.

Lëvorja tashmë notonte fare afër pemës, ariu i pa njerëzit, por nuk hungëroi siç mund të ndodhë në rastet e tjera. Gjithë vëmendjen e kishte përqendruar te lëvorja e trashë që po i shpëtonte jetën. Si kishte hipur ariu mbi trung?! Këtë ende s'po e kuptonin fisanakët, veç kjo mënyrë notimi u tërroqi vëmendjen.

Dy njerëzit ishkëmbyen vështrimë në heshtje. Druri i lehtë po e mbante për bukuri ariun e rëndë, madje edhe mbi ujë!.. E pse të mos i mbante dhe ata?!.. Ky do të ishte shpëtimi!.. Mjaftonte që pranë tyre të kalonte një lëvore e tillë dhe...

Shpresat u ringjallën. Kallamngrënësi, që për asnjë çast s'e kishte lëshuar çomangen e rrëmbyer nga duart, filloi ta rrotullonte në ajër me klithma luftarake. Ariu ktheu dy-tri herë kokën i shqetësuar, pastaj trungu lundrues humbi mes pyllit të përmbytur.

Vetëm tani e kishin të qartë rrugën e shpëtimit. Trupa lundrues kishin parë mjaft gjatë kohës që, të ngujuar lart në pemë, pritnin fare pa shpresa. Duhej të afrojn trungun më të gjerë, të hipnin mbi të dhe të notonin njësoj si ariu.

Kështu vepruan.

Pranë tyre kaluan disa lëvore, por gjah-tari i vjetër s'po vendoste, i dukeshin të vogla Trupat e tyre ishin të rëndë, madje atyre u duhej që trungu të kishte edhe ndonjë thellim ku të mbaheshin. Durimi fitoi. Që larg u duk një trung i goditur nga rrufeja. Kallamngrënësi këputi një bigë të gjatë dhe me përpjekje të mëdha arriti ta afronte në pemën ku qëndronin.

Uji i ftohtë nuk do t'i pengonte fisankët të braktisnin strehën e përmbytur; ishin mësuar me të; gjetkë qëndronte vështirësia.

A do tē rezistonte lëvorja mes shkulmeve tē rrymës?!

Kallamngrënësit i takonte tē shkelte i pari. Trungu u zhyt **disi**, u mënjanua goxha, por nuk u fundos. Iu duk se nga casti në çast do tē rrëzohej në ujin e turbullt. Një pavendosmëri e akullt e pushtoi tē gjithin. Dorën s'e lëshonte ende nga pema shpëtimtare. Por duhej provuar. Kur i shkëputi duart nga degët, gjunjët iu drodhën... Lëvorja e trashë u zhyt edhe më... E për cudi, Kallamngrënësi qëndronte mbi tē pa asnje rrezik. Gjahtari fshiu djersën dhe buzëqeshi fitimtar. Asaj kohe njerëzit buzëqeshnin rrallë. Paskëtaj, me fjalë qetësuese e ftoi edhe Sydiellin tē ndiqte shembullin e tij. Djaloshi shikoi pak me mëdyshje, por pastaj u shkëput me vendosmëri.

Për njëfarë kohe trungu me njerëzit në shpinë notoi pa drejtim, sipas rrymës, që ndryshonte shpesh nga pengesat e shumta. Fisanakët kujdeseshin që trungu — varkë tē mos pengohej në pemët e përmbytura. Kishin uri, ftohtë, por ishin shumë tē gëzuar që mundën tē ecnin mbi ujë, dhe këtë mënyrë notimi do t'ua tregonin edhe fisankëve tē tjerë.

Provuan tē shtynin ujin me copa degësh; shpjetësia e rrëshqitjes së trungut rritet, madje trungu mund tē kthehej nga njëra anë ose tjetra sa herë që ndryshohej kra-

hu i degës. Ky zbulim i madh u shpëtoi jetën.

Qielli i zymtë ende qëndronte varur mbi pyllin e përmbytur. Laraskat zhurmë-mëdha lëshonin piskama të çjerra e herë-herë ceknin me krahët e larmë tufat e barit, që, si ishuj të vegjël lundrues, ndiqnin rrymën të bindur.

Trungu — varkë ecte pa asnë drejtim. I kishte marrë malli për trojet e veta. Këto ditë me ecejake të ndryshme, me të papriturën e rrezikut, sikur ua kishin shtuar më shumë dëshirën për t'u kthyer. Po ku ndodhej fisi i tyre?... I gjithë horizonti mbulohej nga një mjegull e dendur, që ngjasonte me një shkretëtirë ngjyrë hiri.

Në këto anë pemët ishin më të ulëta dhe shkurret dendësoheshin; kjo tregonte se pylli nuk vazhdonte edhe shumë, diku duhej të ndodhej tokë e thatë. Toka vonoi të shfaqej. Njëzet të hedhura mëzdraku larg daliuan një rrip të papërmbytur, që fshihej herë-herë mes mjegullës. Megjithatë, copa e tokës rrethohej nga të katër anët prej ujit të turbullt.

— Të zbresim! — thirri i çliruar nga ankthi Sydielli.

Te kjo copë tokë ndoshta mund të shpëtonin, të thaheshin, të ushqeheshin. Kishin ngrirë mbi atë copë druri, trupi u dridhej nga të ftohtët, buza u ishte mavijosur e tha-

rë nga uria, duart u ishin nxirë nga shtrëngimi. Në bark ndienin një djegësirë të padurueshme.

Kallamngrënësi bëri me shenjë se s'duhej nxituar. Luftëtari i vjetër vëzhgonte me kujdes tokën, së cilës pas pak do t'i afroheshin. Ishte një sukë e ngritur me bimësi të rrallë, qarkuar nga shkëmbinj të mprehtë. Vendi dukej mjaf i egër. Shkëmbinjtë e zinj vullkanikë lëshonin një avull të lehtë, që luhatej bregut me një qetësi të frikshme. Duhej t'i ruheshin këtij vendi.

Kjo mëdyshje u solli shumë dobi. Kur iu afruan goxha kësaj toke dhe konturet dalloheshin qartë, dëgjuan britma të forta luftarake. Dy fisanakët ngrinë nga habia. Në të majtë të tyre, midis dy shkëmbinjve, kërcyen befas disa trupa leshtorë, që sokëllinin e tundnin armët prej guri.

— Njerëzit e Pyllit! — tha me gjysmë zëri Sydielli.

Bashkudhëtari tundi kokën e pas pak lëshoi një britmë të fuqishme në drejtim të njerëzve që kërcënonin lëvoren lundruese.

— Kallamngrënësi u rrëmbeu çomangen Njerëzve të Pyllit!.. Ai është më i shkathët!

Fisanakët armiq e kuptuan përbuzjen. Klithmat u shtuan edhe më, ndërsa trupat e ndërkryer gati preknin ujin. Me sa dukej këtë vend ata e zgjidhnin për të shpëtuar kokën gjatë përmbytjeve, sepse e njihnin mirë.

Kalonin shkëmb më shkëmb pa e parë fare vendin ku shkelnin. Bashkë me fisanakët e rritur ulérinin edhe gratë e fëmijët.

— Ata do të na vihen pas, — vërejti i shqetësuar Sydielli.

— Leshatakët nuk dinë të ecin në ujë, — qeshi Kallamngrënësi, i kënaqur nga dobësia e tyre. — Janë në mes të ujit...

Djali ngriti supet i habitur. Si në mes të ujit?!... A nuk vazhdonte toka më tej?

Fisanaku i vjetër i tregoi se kjo copë tokë shkëmbore ishte e lartë dhe nuk përmbytej. Njerëzit e Pyllit mund të shkonin në vendbanimin e tyre vetëm kur uji të kthehej në Përroin si Mamuth... Se kur do të ndodhët kjo, as vetë Kallamngrënësi nuk e dinte, megjithatë, djali u qetësua e filloi t'i shikonte britmacjerrësit pa frikë.

Njerëzit e huaj u bindën së fundi se me të bërtitura nuk trembeshin dy fisanakët që kapardiseshin mbi një trung. Mahniteshin nga zgjuarsia e notuesve, por më shumë ishin të egërsuar nga rrëmbimi i çomanges... Pas pak edhe atyre iu polli mendja, filluan të hidhnin në drejtim të varkës mëzdrakë e gurë të mëdhenj, që shkumëzonin ujin jo larg njerëzve, që, megjithëse përpinqeshin, rryma nuk i largonte nga ishulli shkëmbor.

— Fisi i Kallamave është i fortë! — thërriste gjahtari i vjetër për t'i dhënë zemër djalit.

— Sydielli noton si peshku! — përgjigjet Sydielli me një zë burrëror.

Për fat të keq ishulli zgjatej shumë dhe rryma tashmë lëpihej afër bregut. Kallamngrënësi e ndjeu shpejt rrezikun; ndjekësit tanë do ta kishin të lehtë për të qëlluar me gurë ose mëzdrakë.

Lundronin vetëm njëzet hapa larg bregut.

Ishullorët s'ishin aq budallenj sa duke-shin. Porsa e vunë re një gjë të tillë, u vërsulën majë shkëmbinjve e shkurreve. Gurët binin si breshër rrotull trungut-varkë.

— Lëvizi më fort degët! — gulçonte Kallamngrënësi i djersitur. — Duhet të ecim më shpejt!

Djalit iu mpinë duart nga lodhja. Sytë e mjegulluar shikonin ylberë shumëngjyrësh, ndërsa zemra i rrihte fort. Një lëvizje e pakontrolluar mbi lëvoren që po u shpëtonte jetën, sillte rrotullim dhe ngecje në vend, ose më e keqja, rrëzim në ujin e turbulluar e të rrëmbyer.

Papritur ndjeu në sup një goditje të fortë, që e detyroi të lëshonte një klithmë dhimbjeje. Shtrëngoi më fort dhëmbët, por gjymtyrët iu prenë e s'urdhëroheshin më. Iu duk se do të binte dhe çdo gjë do të merrte fund në pak caste. Sytë i shkuat padashur te shoku, që po luftonte me ujin... Edhe pak... Edhe pak. Ja, pas atij shkëmbi të

përkultur rryma kthehej në të djathtë. Dhimbjja në shpinë sikur iu pakësua, por ndjeu një dobësi të përgjithshme dhe trupi iu anua. Gati po rrëzohej. Britmat e fisit armik i shungëllonin në veshë si zhurmë daulleje...

Një shtrëngim i fortë e përmendi. Hapi sytë dhe në atë mjegull të ndriçuar pa një siluetë të voziste me një dorë... Sydielli u mbështet i lodhur në shpinën e shokut. Lëvizjet e muskujve, ajo nxehësi e zakonshme e trupit të djersitur sikur ia pakësuan dhimbjen.

— Sydiell... Jemi larg... Gurët dhe heshtat e tyre s'na arrijnë dot, — buzëqeshi Kallamngrënësi.

I plagosuri me mundim të madh hodhi shikimin në drejtim të copës shkëmbore, që dalëngadalë shkrihej mes mjegullës. Sokëllimat, britmat hakmarrëse dëgjoheshin gjithnjë e më dobët.

6

Mbi trungun-varkë lundruan gjatë. Qielli vende-vende kishte grisur rrobën e përhimtë, duke treguar pjesë të kaltra. Rosat e egra kërkonin njëra-tjetrën me gagaritje monotone; rrëshqitnin mbi ujë mes vazhdazh të shkumëzuara.

Dy fisanakët e guximshëm s'ngopeshin

së admiruari ndryshimet e motit, që ishin jetë, ishin shpresë. Duart e shkathëta s'ki-shin pushuar së vozituri drejt një cekëtine. Sytë i mbanin vazhdimisht hapur, pasi kë-to vende të pashkelura gëlonin ngajeta. Diku, matanë bregores që u shfaq pas cekëtinës, u dëgjua edhe një ulërimë e thekshme çakalli.

Sydielli ndiente ende një dhimbje të fortë në shpinë, por nuk e jepte veten. Fundja plaga tani ishte tharë dhe për disa orë korja do ta mbyllte plotësisht.

— Uji po mbaron, — vërejti i lehtë-suar Kallamngrënësi.

Dy të hedhura mëzdraku larg shtrihej një brez i gjerë mbuluar me kallamishte të dendura, që rrethonin një tundër të ulët me pemë të rralla, por gjigante. Këtu sigurisht kishte jetë dhe të papritura.

— Do të zbresim? — pyeti djali jo fort i sigurt.

Gjahtari i vjetër i shpjegoi me durim se nuk kishin rrugë tjetër, do të fshiheshin, pastaj Ylli i Mëngjesit do t'u tregonte drejtimin e fisit.

Trungu kaloi me vështirësi barrierën e kallamave dhe ndaloi jo larg një trungu tjetër të rrëzuar nga rrufetë, që lidhte si urë kallamishten me bregun e thatë. Kjo i ndihmoi të shmangnin llumin e trashë e të rrezikshëm.

Viset e panjohura buisnin nga gjallesat. Një kor i fuqishëm zogjsh të merrte veshët. Qukapikët trokëllinin sqepin e gjatë në lëvoren e njomë si për të treguar **fillimin** e ditës së re. Zëra të largët, disa fëshfërima, përplasje të befta flattrash, s'të linin të dyshoje për gjallërinë dhe luftën për jetën që bëhej prapa çdo gëmusheje ose dendësie pemësh.

Endacakët në fillim u kujdesën të ushqehen dhe gjahu u shkoi mbarë. Sigurisht, me barkun mbushur mund të ecje lehtë. Ishin larguar mjaft nga vendbanimi dhe këto vende fshihnnin rreziqe e pusira. Jeta, përpjekjet e kishin mësuar Kallamngrënësin të llogariste kohën. Se sa larg kishin shkuar, nuk guxonë as ta mendonte, jo më t'ia thoshte Sydiellit. Ylli i Madh ishte fshehur netëve të stuhisë dhe duhej pritur nata me qiell të pastër. Tani për tani duhej të ecnin me kujdes.

Shtegu u priu drejt një lirishteje të bukur. Bimësia e dendur, drurët dhe gëmuhat u zhdukën si me magji. Përpara kishin një brez kodrinash të ulëta përcëlluar nga zjarret e rrufeve, në këmbë të të cilave gurë të shkëputur sajonin figura fantastike.

Ndalën të pavendosur. Kallamngrënësi u trembej vendeve të hapura, megjithëse këto kodrina i kujtonin vendbanimin. Sydielli s'ua ndante sytë dy shkëmbinjve që

ngjasonin çuditërisht më kokën e një kali. Thua t'i kishin vendosur njerëzit në këtë mënyrë!?

— Sydielli të rrëshqasë mes barit e të shikojë ç'ka pas shkëmbinjve, — porositi djalin Kallamngrënësi.

Natyrisht, ai e priti me gëzim këtë detyrë nderi, sepse dinte të lëpihej si mace pas shkurreve dhe, në rast nevoje, të tërhiqej me shpejtësinë e një majmuni.

Fisanakut të vjetër s'i dridhej asnjë muskul i fytyrés. Heshtja që zotëronte rrëth këtij vendi i ngjalli një dyshim. Pse dredhuan dy çifte drérësh nga rruga, kur rrëth e rrotull shkëmbinjve kishte bar të njomë?! Pastaj dhe pëllumbat e egër fluturonin larg këtyre shkëmbinjve të ulët... Fillin e mendimeve ia ndërpren shfaqja befas e trupit të Sydiellit, që po i bënte me shenjë se s'po shikonte asgjë. Djaloshi maskohej për mrekulli e pas pak humbi nga sytë e tij. Tashmë qetësia u bë e madhe.

— Atje nuk ka asgjë! — tha djaloshi kur u kthye.

Kallamngrënësi u gëzua.

— Atje ka vetëm një gufë... — vazhdoi djali.

Një gufë!... Çudi, pse nuk e kishin zë-në Njerëzit e Pyllit këtë gufë?! Edhé po të ishte banesa e arinjve, njerëzit dinin t'i nxirrin prej andej.

Vendosën t'i afroheshin edhe ca vendit tē çuditshëm. Rrugës nuk hasën asnë qenie tē gjallë. Kaluan ngadalë gëmushat dhe u gjendën pranë një gufe tē heshtur. Këtu diçka nuk shkonte.

— Shpella është foleja e mishngrënësve, — tha lehtë Sydielli.

— Ku janë gjurmët e tyre? — pyeti Kallamngrënësi.

Vërtet, rrëth e rrotull asnë gjurmë **grabitqari**. Hijet e mbrëmjes filluan tē pushtojnë si njolla tē mëdha sipërfaqen e barit, që rrudhej lehtë nga flladi. Pylli i madh dukej si një gojë gjigante që lëshonte aty-këtu ndonjë britmë ose trokëllimë tē vonuar. Së shpejti yjet do tē ndritnin në pjesën e qiellit ku retë kishin marrë me kohë arratinë. Gjatë kësaj kohe do tē shfaqej edhe Ylli i Madh.

Kallamngrënësi rrotulloi dy herë çomangen sipër kokës. Atij do t'i pëlqente të çlodhej pak në shpellën e zbrazur. Përgatiti me kujdes mëzdrakun dhe heshtën me gurtë mprehtë dhe kuturisi tē hynte në thellësi. Sydielli u ngarkua tē vëzhgonte drejt pyllit tē paanë.

Çastet e para djali i kaloi me gëzimin e këtij zbulimi. Veç, kur mugëtira u shtua dhe koha fluturoi, u shqetësua. Rrëth e rrotull qetësia vazhdonte. Vetëm diku larg zërat e natës shtyheshin deri tek ai tē dobëta.

Pse nuk po kthehej Kallamngrënësi? . . .

Zëri i brendshëm e ftoi të ndiqte gjurmët e shokut. Para hyrjes dyzoi vetëm disa çaste. Heshtja që po vinte prej asaj goje të lagësht, ia shtoi mornicat në trup. Muret e shpellës gati nuk dalloheshin nga errësira. Këmbët iu përplasën në një grumbull kockash, që shkaktuan një zhurmë ngjethëse. Sydiellit iu mbajt fryma. Djersa në ballin e rrudhosur pikoi drejt e në gjoksin që i ulej e i ngrihej nga frysëmarrja plot shqetësim. Befas jo larg tij u dëgjua një dihatje e rëndë. Hodhi dhe dy-tre hapa, por klithi si i kafshuar... Këmbët i prekën një trup të ngrohtë.

Vetëtimthi u kujtua se duhej të ishte trupi i shokut. Çfarë të kishte ndodhur me të!... Pse nuk fliste?!

Dihatja e rëndë u ndie së dyti. Tani djalili u bind se poshtë këmbëve të tij ishte shtrirë Kallamngrënësi, largoi çdo frikë dhe filloi ta tërhiqte trupin jashtë shpellës... Dicka po i zinte frysëm. Një dorë e padukshme kërkonte t'i shkëpuste frysëmarrjen. Po i merreshin mendtë.

Përmblodhi gjithë forcat dhe, pa e lëshuar trupin e squllët, u zvarrit për nga hyrja. Ajri i freskët ia largoi atë marramendje të fortë. Vetëm tani po e shikonte me vëmendje trupin gati pa jetë të Kallamngrënësit. Kaloi me një frysëm duart nëpër gjymtyrët e të shtririt, por nuk hasi asnje plagë. Kjo ishte më e habitshmja nga të gjitha. As-

një shenjë mëzdraku, asnjë gjurmë kafshimi ose gërvishtjeje!

Sydielli ferkoi dy-tri herë sytë nga habia. Dukej se Kallamngrënësi flinte një gjumë të rëndë, zemra i rrihte lehtë, por anash buzëve shkumëzonte një lëng i bardhë. Megjithatë ishte gjallë dhe duhej shpëtuar.

Lart në quell u shfaqën yjet e parë. Ja dhe Ylli i Madh... Shpresat i dhanë më shumë forcë e gjallëri. Përfshiu nga sinqeritet trupin e shokut dhe filloj ta tërhiqte me një mijë mundime drejt kodrinave të ulëta.

Pranë pellgut të parë me ujë u ul, lagu pëllëmbët dhe me duart që i dridheshin nga padurimi, i lagu faqet dhe gjoksin. Kallamngrënësi filloj të merrte frymë më thellë. Uji i freskët sikur e gjallëroi, por nuk u përmend. Sydielli s'e ndërpree ecjen. Tej undie një bulërimë e zgjatur, klithma të ndërpresa shpendësh, një kërkëllitje trungu që rrëzohej. Jeta vazhdonte edhe pse shumë kafshë strukeshin në foletë e tyre të frikuara nga e papritura.

Sydielli vazhdoi të tërhiqte trupin e shokut drejt kodrave shkëmbore pa ia ndarë sytë Yllit të Madh. Ato pak re që lundronin majë Malit të Thinjur, ishin shpërndarë dhe tani kupa qellore qëndisej nga mijëra xixëlli.

I lodhur, me gjymtyrët që s'i mbanin, u struk në një gropë të thellë, pa e lëshuar tru-

pin e shokut. Aty nga mesi i natës Kallamngrënësi shqiptoi fjalët e para. Djalit iu duk se terri i natës u zbut. Ashtu i mpirë priste me durim agun. Koka i këpütej në gjoks e herë-herë ngulte vështrimin në një pikë, ku errësira prishej nga ndonjë ndriçim kalbësire.

— Ajri i lig!... Ajri i lig!¹⁾ — murmuriti së dyti Kallamngrënësi duke hapur sytë.

— Sydielli nuk e la vetëm Kallamngrënësin, — i shtrëngoi fort dorën, djali i gëzuar.

Për një çast gjahtari i vjetër rrotulloi sytë me habi, pastaj u ngrit vrik ndenjur. Të gjitha i dukeshin një ëndërr e keqe. Mbante mend hyrjen e shpellës, hapat e parë, ajrin me atë erë të panjohur dhe... Instinktivisht vendosi dorën në kraharor si për të kujtuar mbajtjen e frymës, sytë e lotuar, humbjen e ndjenjave... Por ja, ishte gjallë bashkë me djaloshin trim të fisit. Asnjëherë nuk ishte ndeshur me një armik të padukshëm dhe ndihej tepër i frikësuar.

— Kallamngrënësi flinte në shpellë, — qeshi Sydielli.

— Ajri i lig e mundi Kallamngrënësin, — shqiptoi turivarur gjahtari i vjetër.

1) Ajri i lig — gazi métan, që shpeshherë shfaqet në shpellat karstike.

— Ajri i lig!?

— Njerëzit e Pyllit nuk hyjnë në atë shpellë, as ariu, as pëllumbat. Ajri i lig është kafsha më e fortë! — tha si një profet Kallamngrënësi.

— Ajri i lig nuk duket, prandaj është i fortë! — kuptoi së fundi edhe djali.

7

Agu i gjeti në këmbë. Qielli kaltëronte si një ligen i paanë. Disa re të bardha lozonjare u kthenin shpinën rrezeve të diellit, sikur donin të luanin me to.

Dy fisanakët e mardhur kthenin fytyrën nga ngrohtësia, pa e ndalur për asnjë çast ecjen drejt kodrave shkëmbore. Ylli i Madh u kishte treguar drejtimin dhe së shpejti do të ishin afër trevave të tyre. Një brez i artë farfuritës rrethonte kënetën, ndërsa brezat me gjineshtra dhe lëndinat me tërfil të kuq lëshonin një avull të lehtë marramendës.

Kallamngrënësi ndaloj i dalldisur nga bukuritë e natyrës.

— Sa i madh! — tregoi vendin përreth, si për të treguar se bota ishte e pafund dhe vende pér ushqim e gjueti kishte plot.

Sydielli s'i ktheu përgjigje. Po shikonte me ngulm në një drejtim, ku këneta pér-

mbyste disa shkëmbinj. Ky vend i kujtoi gjuetinë e ngjalave.

— Arritëm, — murmuriti papritur, duke treguar me gishtin e madh shtegun. Kallamngrënësi vendosi pëllëmbën si strehë. Vërtet atje diçka lëvizte.

— Janë fisanakët, — kërceu djaloshi duke thithur ajrin fort. Kallamngrënësi rrotulloi me gëzim çomangen. Tani të gjithë do t'i besonin fjalët e tij. Të gjithë do ta nderonin po aq sa prijësin.

U turrën drejt shtegut, ku pas të gjitha gjasave lëviznin njerëz. Ata asnijëherë nuk mund të gabonin. Njeriu ecte me të dy këmbët dhe mbante në duar diçka, kurse kafshët barisnin.

Sydielli kërkoi të lëshonte një kushtrim luftarak, por befas gjahtari i shtrëngoi krahun me egërsi. Djali pa me habi luftëtarin ta ftonte të ulej mes barit. Çfarë po ndodhte?... A mund të kishin frikë prej fisankëve?

Kallamngrënësit i dridheshin flegrat e hundës. Nuk kishte asnijë dyshim që kjo ishte treva e tyre, madje prapa atyre shkëmbinje ndodhej edhe shpella, por njerëzit që lëviznin, s'ishin njerëzit e fisisit dhe nuk kishin dalë aspak për gjah.

U afruan rrëshqanthi për të parë nga afër turmën e armatosur me shtiza kocke dhe çomange të rënda.

— Njerëzit e Pyllit! — mezi e përmbajti habinë Sydielli.

Kësaj radhe Njerëzit e Pyllit ishin përgatitur për luftë. Shiu i rrëmbyer u kishte kujtuar shpellat dhe ata do të hynin në to me forcë. Ecnin përkulur mes barit dhe hap pas hapi kërcenin mbi shkëmbinj.

— Fisanakët do të gjenden keq... Njerëzit e Pyllit kërkojnë t'u dalin prapa, — kuptoi planin Kallamngrënësi.

Përpara syve i dolën skena të tmerrshme, ulërima. Njerëzit e tij do të shpërnda-heshin si gjethet e vjeshtës në pyllin e parfund, pa strehim, pa shpellën e ngrohtë, në mëshirën e erës dhe të shiut.

Fuqi nuk kishin të luftonin kundër një turme të armatosur dhe këneta ishte një pengesë e pakapërcyeshme.

— Njerëzit e Pyllit nuk e kalojnë dot kënetën, — tha Kallamngrënësi.

— Sydielli dhe Kallamngrënësi e kalojnë! — ia ktheu djali. — Ata dinë të notojnë mbi ujë...

Gjahtarit të vjetër i shndritën sytë... Fjalët e Sydiellit ishin të arta.. Tani mund ta lajmëronin fisin për t'u mbrojtur...

U zbythën heshturazi në fund të kënetës dhe mes ujit të ndenjur kërkuan ndonjë trung të rrëzuar. Rrebeshi i madh dhe rrufetë kishin rrëzuar disa syresh dhe s'e patën të zorshme të zgjidhnin më të përshtat-

shmin. Barriera e kallamave s'i lejonte Njerezit e Pyllit të vëzhgonin veprimet e tyre.

Kallamngrënësi ngulte me forcë një kallam të trashë dhe trungu-varkë shtyhej për mrekulli në ujin e ndenjur. Sydielli mundohej me të gjitha energjitetë të mbante drejtimin. Këneta me ujin e qetë s'i pengoi aspak t'i afroheshin kodrës ku ndodhej shpella.

Disa klithma të forta habie treguan se lëvizjet e tyre ndiqeshin me admirim nga bregu. I kishin njojur dhe gjithë fisi, si një kor i vërtetë, shprehte admirim. Prijësi dalohej mbi të tjerë. Në dorë mbante një stap kockë dhe hijerëndë shikonte manovrimet.

Kallamngrënësi për një çast rrrotulloi çomangen e grabitur sipër kokës. Ky veprim u shoqërua me klithma të papërbajtura të fëmijëve dhe grave, ndërsa shumë luftëtarë tundën armët. Kishin njojur çomangen e armiqve dhe u bindën se ata mund të sulmonin nga çasti në çast. Veç më të shumtët qëndronin të ngirirë nga habia. Si mund të qëndronin vallë mbi ujë fisanakët?!. Tani këneta mund të kalohej pa frikë. Ky zbulim u dukej si jashtëzakonshëm dhe në sytë e tyre Kallamngrënësi rritej si një njeri me mendje pjellore.

Shumë djelmosha admironin Sydiellin, heroin e zbulimit, dhe me mend kërkonin të bëheshin si ai, të merrnin lavdi për t'u pranuar në grupin e gjahtarëve.

Fjala e parë që tha Kallamngrënësi por-sa vuri këmbën në tokë, ishte: «Njerëzit e Pyllit po sulmojnë shpellën!»

Gjithë fisi u drodh nga kjo e papritur. Leshataku dhe Hundëtrashi kundruan çomangen e rrëmbyer dhe tundën kokën të bindur.

Kryegjahtari nuk e humbi toruan. Tregoi në heshtje xhepat shkëmborë sipër shpellës dhe tundi stadin prej kocke:

— Fëmijët në shpellë! Gratë të mble-dhin gurë!

Ligji i mbrojtjes së strehës u dha krahë fisanakëve. Kallamngrënësi u rreshtua. në krah të mbrojtësve, duke e përshkruar me ngjyra të gjalla pamjen e Njerëzve të Pyllit.

Sulmi nuk vonoi të vinte. Njerëzit e Pyllit kishin kaluar në heshtje brezin e thâtë të shkëmbinjve, që rrethonte kodrën shkëmbore me kënetën, dhe, të bindur në fitore, u turrën me armët e gurta. Thirrjet e egra të leshtorëve u përzien me britmat luftarake të mbrojtësve.

Një breshëri gurësh dhe mëzdrakësh rannë si rrufe në kokat e Njerëzve të Pyllit, që s'e pritnin. Rënkime, thirrje të trembura sunduan deri larg në pyll.


Njerëzit e Pyllit sulmonin si të verbër, por nga xhepat shkëmborë vinin goditje vde-kjeprurëse. Vendi i përleshjes u mbush me

copa gurësh, mēzdrakë me strall tē mprehtë,
shtiza kocke dhe trupa tē sulmuesve.

Pérleshja nuk vazhdoi gjatë. Njerëzit e
Pyllit morën arratinë mes pyllit. Shumë sy-
resh u mbytën në kënetë, pasi u përpoqën
të shpëtonin. Në qìell një tufë korbash pér-
shëndeste me krakaritje tē forta sheshin e
betejës.

Rreziku tashmë kishte kaluar dhe fis-
nakët bridhnin duke mbajtur nëpër duar
trofetë e luftës, ndonjë armë guri ose gjer-
dan, ndonjë vath kocke ose gëzof tē lëshuar
në panik e sipër.

Atë mbrëmje zjarret e shpellës ndritnin
më shumë se kurrë. Gratë dhe fëmijët hidh-
nin vazhdimisht shkarpa e degë me veshët
pipëz për tē dëgjuar bëmat e Sydiellit dhe
të Kallamngrënësit, që ishin kthyer me fi-
tore në shpellën e tyre.



FLUTURIM I PAPRITUR

Novelë fantastiko—shkencore

1

Eshtë ora e ngritjes!... Eshtë ora e ngritjes! Këto fjalë i përsëriste vazhdimisht aparati i zgjimit me një timbër të fortë metalik. Mbulova si munda kokën në jorganin e ngrohtë ajror, por nuk shpëtova dot nga kokëfortësia e tij. Pas disa minutash ky apparat i bezdissihëm do të lëshonte një paralajmërim edhe më të fortë.

Mëngjeset me shi kanë diçka të vecantë. Rri gjatë në shtratin e ngrohtë e shikon rrebeshin që sajon në xhamat e dritareve harta fantastike nën një copë qiellos ngjyrë hiri. Të vjen keq për gjethet e verib

dheme që luheten e bien një nga një. E kushedi për çfarë tjetër do të ëndërroje, sikur të mos ekzistonte aparati i zgjimit.

Në goftë se do të vazhdosh të shtriqesh, në ekrinan e dhomës do të shfaqet ftyra e vrenjtur e gjyshes. Atëherë lamtumirë, gjethë të vogla, të pafajshme, lamtumirë, rrebesch trokëllitës, lamtumirë, shtrat i ngrohtë. Ajo nuk do t'ia dijë për ndjenjat e tua, për shiun e breshrin. Veprimet kërkon të bëhen sa më shpejt dhe në kohën e duhur. Herë-herë më duket se aparati i zgjimit komploton bashkë me gjyshen që të ngrihen më shpejt.

Nejse, të gjitha kalojnë. Pa hedhur sytë në ekrinan e vogël, u ngrita, u vesha duke turfulluar dhe pëshpërita atë mirëmëngjesin tim gjysmak. Në sallën e ngrënies, përballë takëmeve të porcelanit, qëndronin, si zakinisht, gjyshja dhe im vëlla.

E njëjta gjë do të ndodhë edhe këtë mëngjes. Vëllai më përshëndeti, ndërsa gjyshja dëgjonte me vëmendje emisionet televizive të mëngjesit.

— Fjete mirë? — pyeti vëllai me një shikim hetues. Është gjashtë vjet më i madh se unë dhe vazhdon shkollën e mesme të prodhimeve plastike. Si kryetar i grupit shkencor të shkollës, sigurisht i takon të lëvdohet për këtë, po me mua nuk i shkon. I di të gjitha, edhe pse ai mendon se unë jam

i vogël. Për çdo gjë do të thotë: «Shiko, Skerdi, këto gjëra do t'i kuptosh në thelb kur të bësh elektronikë të zgjeruar. Ju të shkollave të ulëta...» Ec e mos pëlcit nga inati po deshe!

— Dukesh i mërzitur! — vërejti im vëlla duke përtypur ngadalë copën e kekut. — Nuk e besoj të kesh marrë ndonjë përfundim të dobët?!

Gjysëmbuzëqeshja, që shoqëron përherë këto fjalë, më la të dyshoja se diçka nuk shkonte. Mos vallë ka marrë vesh rastësisht eksperimentin me lepujt? Të ketë treguar Peti?

— Më dhemb pak koka, — dhe u ula në vendin tim për të qenë më i qetë në gjykime. Peti s'duhej të kishte treguar. Në fund të fundit është edhe vetë bashkëfajtor. Pastaj Gjergji, kështu quhet im vëlla, shumë rrallë e pyet atë për mbarëvajtjen time në shkollë. «Nuk u besoj shumë fjalëve të Petit!» Qesh përherë, sa kujton shokun tim. E unë, ta themi midis nesh, prekem pakëz, por edhe i jap të drejtë. Peti ka një zakon të keq: ose i zmadhon shumë gjërat, ose i zvogëlon po aq.

— Lëre djalin të hajë! — ndërhyri gjyshja.

Im vëlla vetëm buzëqeshi. Ndërkohë mbillaçtesha e mendoja për ditën e re. Përfytyroja me ngjyra të gjalla skenën kur më-

suesi i zoologjisë do të gjejë lepujt e butë
të shtrirë sa gjatë gjerë në shtrojën e kafazit. C'rrëmuje do të bëhet! Peti do të më
shkelë syrin. Le të presë, fundja. E di vetë
kur duhet të ringjallen lepujt.

— Derdhe qumështin! — tha gjyshja
tërë kujdes.

Gjergji kukurisi pa të keq. Hutimi im
atë e zbavit më shumë se çdo gjë tjetër. Sa
keq që je i vogël dhe nuk je as në shkollë
të mesme, as kryetar grupei shkencor!

— Do të vonohesh sot, Gjergji?

— Mundet, gjyshe... Së shpejti filloj-
më praktikën shkencore dhe na duhet të
krijojmë diçka... Grupi i shkollës «Rilindja»
është më përpara.

«Se janë më të zotët, prandaj!» thashë
me vete. «Vjet ndërtuan një batiskaf të vo-
gël, kurse ju një koleksion peshqish të rrallë.
Krahasohet një koleksion peshqish me një
batiskaf? Edhe ne kemi mbledhur gjithfarë
peshqish e molusqesh. Të paktën nuk mbu-
rremi me një palo koleksion!»

Po t'ia thuash këto Gjergjit, do të mu-
ndohet të të mbushë mendjen se një krimb i
rrallë vlen më shumë se një batiskaf prej
peksiglati.

Gjatë kohës që Gjergji vishej, duke pa-
losur me kujdes çantën, unë më në fund mo-
ra frymë lirisht. Së shpejti ai do të dalë dhe
pushteti mbi gjyshen, kur mungon ai, është

i madh. Zë e i përrallis asaj gjithfarë avenirash me raketa e robotë, që, megjithëse gjysmë të trilluara, i dëgjon me qejf deri në çastin kur më duhet të largohem.

Rrëmbeva çantën dhe kapërceva pragun. Porta u mbyll menjëherë pas meje. Ka kohë që përdoret një sistem elektronik për dyert dhe dritaret. Këto të fundit janë ndërtuar në mënyrë të tillë që lejojnë të hyjë drita dhe ngrohtësia e diellit sipas ndriçimit. Mua më pëlqen më shumë shkalla vetëlevizëse në pallatin prej xhami të Petit. Shtëpia ime e ulët nuk ka nevojë për shkallë vetëlevizëse, kështu, dashur padashur, nuk e shijoj një kënaqësi të tillë.

Poshtë gardhit plastik të kopshtit befas pashë një copë letër që më tërroqi vëmendjen. Për fat të mirë letra e bardhë s'ishte lagur plotësisht dhe në të lexoheshin dy-tre rreshta.

Mënjanova me kujdes mushamanë e këqyra nga të gjitha anët püsullën pa u nxjerrë dot kuptimin fjalëve të shkruara, *Gje... Nesër, në orën pesë mblidhemi tek shpe... e Bardhë. Bledi.*

Po kjo! Picërrrova sytë si për të lexuar shkronjat e fshira nga shiu. Ishte e pamundur të lexoja më. Frazës misterioze nuk i dilte kuptimi. Kush e ka shkruar këtë pusullë?! Ç'është kjo mbledhje tek, «Shpe... e Bardhë»?

Merreni me mend sa do të çuditet Peti kur t'ia tregoj. Autobusi elektrik rrëshqiti lehtas para meje, ndezi sinjalin dhe priti të hipja. Dy-tre udhëtarë u bezdisën nga hutimi im, por autobusi nuk pyet për ta, ai do të niset vetëm pasi të kem hipur. E kanë këtë të mirë autobusët pa shoferë.

— Mendoja se nuk do të vije fare në shkollë sot! — më priti turivarur Peti.

— Më vonoi autobusi, — nxitova të mbroja veten, — pastaj kam një sekret të madh për të të thënë.

— Hë...?! — sytë e Petit shkëlqyen. Për një çast ferkoi cullufet dhe prekat e vogla në hundë sikur iu shtuan. — Sekret?!

— Ta them në pushim, — vazhdova unë hijerëndë e i pazakontë.

Petit iu skuqën faqet. E, kjo të paktën s'është një lojë e thjeshtë. Më shikoi nga koka në këmbë për të dalluar ndonjë fije shaka, por, pasi nuk vuri re asgjë të tillë, s'i ngeli gjë tjetër veçse të plaste nga kureshtja.

— Për lepujt e ke fjalën? — Ndërkohë duart me gishtérinjtë hollakë trazojnë pare-shtur xhepat e thellë, ku gjenden vazhdimisht transistorë radiosh, bateri diellore, lupa të madhësive të ndryshme e gjithfarë xhinglash që Peti i mbledh me kujdes.

— Jemi vonë. Në pushim bisedojmë shtruar.

Shoku më ndoqi duke përplasur çantën gjunjëve. Shiu tashmë kishte pushuar. Rreth e rrotull çdo gjë ka marrë ngjyrën e tullës. Retë, vende-vende holluar nga ai gulçim mëngjesor, përfkeshin nga rrezet e diellit. Gjethet e rralla të blirëve shushurin e herë-herë shkëlqenin me një ndriçim marramendës.

Ja, së fundi u duk shkolla disakatëshe, e bardhë, ndërtuar krejtësisht me plastmasë dhe xham kristali.

2

Gjatë orës së matematikës s'më mbante vendi. Sytë i kisha ngulur në ekranin e madh, ku mësuesi demonstronte ushtrime të ndryshme duke shtypur me shkathtësi dhjetëra butona në fund të tij, po mendja më fluturonte gjetiu. Vetëm një orë na ndante nga mësimi tregues në zoologji dhe trimëria ime do të shpalosej fare hapur.

«Zgjidhje e ekuacionit të gradës së tretë... Kalimi i parë... Koordinatat...», zëri metalik i trurit elektronik, kur s'e ke mendjen, të vë në gjumë. Gati m'u mbyllën systë, koka m'u këput dhe mua më erdhi të pickoj veten nga inati.

Sa të lumtur duhet të ishin nxënësit dhjetëra vjet më parë! Kishim parë nëpër filma dërrasa të zeza dhe fëmijë që shkruanin me shkumës. Kishte gjë më të bukur se kjo! Në fund të fundit çdo gabim trashanik shuhej menjëherë me fshirëse. Kursetani, veprimi regjistrohej e përsëritez sa herë donte mësuesi, madje dhe lajméronte përgabimet që bëje në detyrat e shtëpisë. Po më e keqja ishte se dërrasa elektronike të kujtonte gjithë gabimet e vitit. Thoni si të doni, po paraardhësit tanë ishin më rehat! Dikush mund të thotë se ordinatorët sot e kanë lehtësuar mjaft punën e njeriut. Sigurisht këtë unë e pranoj, por jo përxënësit amë. Le të kishte ushtrime e problema të lehta, pa unë do shkruaja ditë e natë me shkumës.

Ajo që prisja s'vonoi të vinte. Gjithë klasa dalloi në videofonin e lajmërimit përgjegjësin e shkollës. Mornica të shpeshta më kaluan në trup ndonëse isha veshur mirë.

«Nxënësit e mëposhtëm lutemi të vijnë pakëz në zyrë», dëgjuam zërin e trashë të profesorit. Vetë nuk isha i pari në listë, po kjo s'më shpëtonte, ndërsa mësuesi i zoologjisë bariste sa në një qoshe në tjetrën, sikur donte t'i maste perimetrin.

— Është e paspjegueshme, shoku Clinton! E paspjegueshme! Lepuj të racës, të ngordhur?! Kjo është, si të të them, maka-

bre! — Vazhdonte ecejaket mësuesi i zoologjisë.

Fjalën makabre diku e kisha ndeshur. Mundet në ndonjë libër, që kishte për subjekt luftërat e shekujve më parë. Nënkuptohej diçka e tmerrshme, çnjerëzore.

Një djersë e ftohtë më përfshiu të gjithin. Si, të shkretën, kishte shkuar i pari mësuesi! Ne zakonisht punonim me ditë të tëra vetëm në laborator, bënim eksperimente, shënonim në fletore rezultatet e punës dhe në fund të javës konsultoheshim me mësuesin.

Ishim katër veta në grupin eksperimental. Peti, i bindur për bashkëfajësinë, mundohej të mos shikonte njeri në sy. Pak më tej Adriani, si një dele e butë, pyeste në heshtje herë përgjegjësin, herë mësuesin. Mbahet si i dyti në klasë dhe ishte «i përkëdheluri» i mësuesve. Gjithë qenia e tij protestonte me forcë për këtë vepër të padëgjuar. Kush e kishte bërë, xhanëm?! I kishte ushqyer mirë e bukur me dorën e vet. Ç'të kishin pësuar lepujt e shkretë!?

Dy hapa përpara meje fërkonte këpucët në parketin e lustruar Beni, futbollisti më i mirë i klasës dhe pjesëtar i grupit tonë të eksperimentimit. Çapkënlëqet e tij bëheshin përherë objekt dyshimi nga mësuesit kur ndodhët diçka që nuk shkonte. Megjithatë i përballonte me kurajë shikimet e mësuesit

të zoologjisë, pajisur me armët e forta që të jep pafajësia. Kuptohet, sa isha unë futbollist i shquar, ishte ai «helmuesi» i lepujve.

— Ja, le të pyesim në fillim Benin, — prishi heshtjen profesori. — Ju punuat si grup, apo jo? Lepujt tani s'kanë gojë të flasin...

Beni ndërpreu lëvizjen e këpucës mbi parket. Prej tij kërkohej diçka e pakuptueshme. Lepujt i la shëndoshë e mirë. Si mund ta merrte me mend përse u ishte tekur të shtriheshin e të mbyllnin sytë?!

— Mbase, — kaloi pështymën ai, — mbase janë ftohur, shoku Kliton. — Mësuesi i zoologjisë kërceu përpjetë, sikur t'i kishin dhënë një dackë të mirë.

— Ftohur?! Lepujt në kafaz, ftohur?! Ah, jo, Beni! Nuk jua fal çapkënllëqet. Lepujt janë ngacmuar, janë shqetësuar. Përgjegjësia rëndon mbi ju, djem të mbarë...

Sigurisht isha penduar. Ç'm'u tek t'u jepja substancë gjumëndjellëse! Të tregoja, gjithçka do të shkonte për bukuri, por ec e vendos. Më duhej të mbaja paskëtaj të gjitha fajet, talljet e shokëve, përbuzjen e Petit.

Befas dëgjova zërin e tij që vinte si prej fundit të një pusi.

— Sa orë mund të flenë lepujt, mësues?

Të gjithë shtangën. Unë më shumë nga të tjerët. Ç'i duhej Petit të ngatërrrohej me të tilla pyetje! Ec e ki besim tek ai pastaj.

Përherë do të m'i prishte planet në minutën e fundit.

— Përse pyesni? — shkëmbeu një shikim profesori me mësuesin e zoologjisë.

— Po ja... Lepujt mund të jenë duke fjetur dhe ne kujtojmë se kanë ngordhur, — shkrepri «idenë gjeniale» Peti.

Ky ishte kulmi! Tavani i zyrës tashmë më dukej pakëz i shtrembër. Si, o Pet, si, o Pet, bie vetë me këmbët e tua!? Ne vendosëm ta mbajmë sekret eksperimentin e gjumit. Fundja, ç'kuptim kishte të mos bëje diçka vetë, pa ndihmën e mësuesit?

— Mirë, mirë, — buzëqeshi përgjegjësi i shkollës, — ju të tjerët shkon! Ne do të bisedojmë shtruar me Petin.

Peti e përballoi me burrëri këtë gjendje. Sigurisht, i dukej vetja hero! Atë çast vendosa t'ia bëja kurrizin më të butë se barkun. Grabitet në mënyrë të tillë lavdia e tjetrit?!

* * *

Gjatë orëve të mësimit Peti rrinte si guhak. Bile në orën e fizikës së zbatuar këputi një copë gjashtë, e cila do t'ia zbukuronte përmrekulli dëftesën e notave. Mirë t'i bëhej! Kishim vendosur të mos flisnim për

gjumin e lepujve. Çudia do tē ndodhte kurata tē ngriheshin fup nē këmbë, do tē lëviznin mustaqkat, do tē rrotullonin syçkat e xhamta dhe tē gjithë do tē thoshin: Kishte tē drejtë Skerdi, pas aq e kaq minutash lepujt do tē ngjalleshin! Po ku tē linte Peti!

Pérpiqesha që tē mos ia ndaja sytë Petit. Dëgjova si nëpër mjegull pyetjen e Benit: «Ishte e vërtetë që lepujt flinin?» Zgjata ca më shumë veshët tē dëgjoja përgjigjen e Petit: «Kuptohet që flinin. . .»

Mirë o mirë, po ideja ishte imja!

Përsëri sytë më shkuan te Peti. Pas atij balli tē ngushtë, pakëz tē rrudhosur, lexoja një brengë. S'duhej ta shikoja më. E ndieja se do tē zbulohesha shpejt dhe ec e mbaje Petin pastaj. Megjithatë rrudhëzat e holla nē ballin e shokut nuk më linin rehat. Peti nuk ishte i keq, fundja nuk kishte bërë ndonjë gjë tē madhe. Kërkonte tē më shpëtonte nga dënimini, kjo ishte e gjitha.

Po më shikonte përsëri. Për një çast sytë e tij u takuan me tē mitë. Dukej sheshit që kërkonte tē falur.

Ora e mësimit kaloi shpejt, po ndihesha i lodhur si pas një pune tē rëndë.

Inati pothuaj më kishte ikur, megjithatë nxitoja. Dëgjoja fare mirë hapa prapa shpine, por kokën nuk e ktheja. Cfarë u ishte përgjigjur! . . . A do tē merrej ndonjë masë?

Kureshtja doli më e fortë se inati, nga-

dalësova ecjen me shpresë se Peti do të më arrinte.

Për çudinë time, tashmë i ngadalësoi hapat Peti. Diç kuptonte edhe ai nga taktika ime. Atëherë përdora mjetin e fundit. Nxora nga xhepi pusullën e famshme që kisha gjetur në mëngjes e u zhyta në një lexim të thellë, si Arkimedi përparr figurave gjeometrike. Ilaçi e bëri punën e vet, Peti u afroa duke ecur në krah.

— Cfarë shkruan letra? — më pyeti me zë të mekur. Pa i kthyer përgjigje i bëra me shenjë se atij pak i interesonin të fshehet e mia.

— Skerdi, s'kisha si të vaproja...

— Si?! — kërceva si kaposh. — Të mos flisje fare, ja si të vaproje!

— Po ishte turp! Mësuesi i zoologjisë është aq i mirë, m'u duk shumë i mërzitur.

— E si kujton ti, unë nuk e dua mësuesin, hë?! Në fund të fundit do të gëzohej kur të shikonte lepujt në këmbë si diva, — thashë, duke ia këputur një krahasimi që pas-këtaj m'u duk budallallëk.

— Emri yt nuk doli. I mora vetë të gjitha fajet, — tërhoqi hundët Peti.

Po kjo?! Edhe gjysma tjeter e inatit më iku. Hapat tanë u shkrinë në një të vetëm.

— U thashë se kisha derdhur padashur substancën gjumëndjellëse në kafaz dhe ndodhi ajo që ndodhi...

Vetëm Peti mund të sajonte diçka të tillë, veç sakrifica nuk kishte të sharë. Kot i mbaja kaq gjatë mëri! Për një nxitim të vogël shokut i bëhej kabull, pastaj fajin e kishte marrë në shpinë si burrat.

— Të hoqën vërejtje? — pyeta më shumë pér t'u siguruar. E kisha të freskët rastin e balonës me lëndë kërcitëse. Babai s'më pa me sy dy ditë vetëm se e thirrën në shkollë pér t'i treguar «bëmën» time, që tronditi gjithë lagjen.

— Më falën pér sinqeritetin. Mësuesi kërkoi që unë të marr pjesë patjetër në eksperimentin me ultratinguj.

Pse diskutohej? Të gjithë kishim dëshirë pér eksperimente!

— Mirë, mirë, — sikur u pajtova unë, — kjo do të ishte diçka e bukur.

Pas shiut të mëngjesit, nga toka ngrihej një avull i lehtë. Kullat dhe panelat e ngrohjes diellore shndritnin verbtas kur ndeshnin rreze dielli të pingulta. Kundërmimi i dheut, afshi i asfaltit të lagur ngacmonte flegrat e në gjoks ndieje një shtrëngim të këndshëm.

— Mund ta shoh pusullën?

I besoja këtej e tutje Petit?! Ky mendim më rrötullohej në kokë si një mizë e zënë pas perdeve. E pranoja që ishte disi më afër nga shokët e tjerë. Më pëlqente pushteti që kisha mbi të, falë shkathësisë dhe zgjuarës sime në mësime e lodra. Më shumë pse

kërkoja të kisha një «dëshmitar» për to, megjithëse Peti të ngaterronte punë shpesh. — Unë ël di që më mban mëri. Mirë, mos ma trego.

Duhej ta kisha zemrën prej guri që të mos përulesha para tij.

— Jo, mio, unxitova të ktheja përgjigje. — Po të betohesh!

Petit i ndriti fytyra nga gjëzimi. Nëpër xhepa ë dëgjuat trokëllitja e famshme e nëtë njëjtën kohë ai hapi çantën përtë nxjerë racionin e ushqimit. Kjo u vuri vulën të gjithave! Nuk mbaja mend ndonjë rast që paketa e ushqimit të mos ishtë asgjësuar gjatë pushimit e aq më shumë të ndahej më dysh. Ky veprim bërazohej me bëtimin më të rendë. Shkëmbeva pa e zgjatur pusullën me copën e kekut. Peti e lexoi më një frysë.

— E shikón sa e çuditshme është?

— Cëk! kaloi pështymën shoku. — Vërtet shumë e çuditshme! Ku e gjete?

— Poshtë strëhëzës së gardhit, afér shtëpisë.

Papritur Peti u kujtua të rrëmonte në për xhepa e të nxirrte një lüpë të vogël. Kontrolloi me imtësi çdo fjalë, por pa dobi, shkrimit nuk i dilte kuptimi. Pikat e shiut e kishin prishur mjart.

— S'po kuptoj gjë! — ngriti sëpët. — Ia cojmë Fatmirit, ai gjurmon nëpër shpella dhe ka njofturi për shkrimet e palexueshme.

Fërshëlleva, si për t'i thënë që të tillë gafë zor se kisha dëgjuar. Shkrimi ishte në shqipe të pastër, ndërsa emri Bledi nuk ishte parahistorik.

— Përderisa e gjete afër shtëpisë, — nxitoi të shlyente fjalët e pamatura Peti, — Bledi duhet të jetë komshiu yt.

Kujtova gjithë komshinjtë me emër të tillë, por asnjeri nuk ma mbushi syrin. Disa ishin fëmijë që nuk dinin të shkruanin, disa pleq që nuk kishin nge për lojëra.

— Jo. Nuk njoh njeri me emrin Bledi.

— Mos është Bled Krina, ai që e ka babanë kozmonaut?

— E pse të shkon mendja tek ai?!

— Kot. Ai duhet të jetë!

Bled Krina ishte një djalë i gjatë, pakëz, vëngërosh, që fliste vetëm për raketa e satelitë. Në pëshime rrotull tij mblidheshin një turmë për të dëgjuar historitë me protagonist babanë. Të gjithë dyshonin në vërtetësinë e historive, por kishin qejf të dëgjonin e kështu dashur padashur, Bled Krina mbulohej me lavdi.

Edhe ai mund të ishte. Po ç'kuptim kishte plani tek «Shpe... e... Be».

— Unë them që nesër ta ndjekim, — fliste pareshtur Peti.

— E përse?!

— Të kuptojmë planin.

Heshta i pavendosur. Si mund ta ndiq-

nim pa e parë? E kishim këtë, të drejtë? Mbështetje lënë takime shokët e klasës për të luajtur dikur dhe ne kërkonim të futim hundët. Ky duhej të ishte zëri i ndërgjegjes, sigurisht. Por ai krimb i vogël i kureshës, që shpesh tek unë bëhej vetëm pas disa çastesh një gjarpër i madh, më ngacmonte cér, cér, cér... Qfarë donte pusulla e Bledit pranë shtëpisë sime? Një të drejtë, të vogël e kisha, të merrja vesh se kush qëndronte pas pusullës, madje dhei planin që po sajonin.

— Do të veprojmë si thet Pasqytë mbarojmë mësimet më kërko në videofon... I ngulemi përpara shtëpisë dhe s'ka kushtkon.

— Po sikur të dalë më përpara? — pri shi fytyrën Peti. Ej, bela! Përherë terçillëk do të ndillte!

— Çudi me ty! Këtu shkruan e zeza mbi të bardhë, në orën pesë! Pranë postës këfmbyem autobusin elektrik, Ishai sigurt që Peti më ndiqte me libuzët ngjitur në xhami duke rrëmuar në xhepat, që s'u gjendej fundi.

Drekën e thava me një frysë, pastaj iu futa mësimeve edhe më i babëzitur. Do të shkoni ekskursion?! pyeti gjyshja e habitur.

— Si punë ekskursioni, — u përgjigja shkurt, pasi nuk doja të hasja ndonjë pengesë të paparashikuar.

— Nuk do të më thuash gjë?

— Si?... Unë... I jam bëtuar Petit.

— Mirë, mirë. Kam besim se nuk do të jetë diçka që vërtet duhet të ma thuash, — buzëqeshi gjyshja. — Edhe Gjergjit nuk kemi pse ia themi.

U ngrita nga tryeza për ta përqafuar! Sa shpejt më kuptonte! Më krijonte përherë letësira në lodrat e mia edhe pse babai kërkonte regjim të rrëptë studimi.

— Kështu do të vepron te edhe gjyshi, — u mallëngjye ajo. — Me siguri do të të kishte marrë në udhëtimet nëntokësore. Ti, Sandri, i ngjan shumë.

Kjo ishte lëvdata më e madhe për mua.

Gjyshja në shumë raste nuk besonte, por kishte dëshirë të zbulonte tek unë diçka. Ndoshfa i kujtoja gjyshin, një burrë hijerëndë, me thinja aty-këtu në flokët e zëz, me dy sy të gjallë që duket sikur flasin nga fotografia. Aksidenti në termocentralin nëntokësor i kishte marrë jetën, por asnjëherë kujtimin tonë.

Në çast Gjergji mbërriti, si përherë, në orën dy.

— Hë, buçko! — më rrahu shpatullat.

Kujtdo kjo përshëndetje do t'i dukej e ëmbël mjaltë! Po mua, të them të drejtën,

m'u duk si kumbull e ithartë. Për Gjergjin isha vëllai i vogël, njeriu që duhet të mësoja mirë, të sillesha mirë, të mos futja hundët në punët që s'më takonin e të tjera. Shpesh më merrte më shëtitje e kinema, por këto nuk mjaftonin. Përgjigje të tilla si «Do t'i marrësh vesh më vonë. Ti nuk ka bërë elektronikë të zgjeruar», mëbënин të dridhesha nga inati.

Nga dera gjysmë e hapur e dhomës së tij befas më zunë veshët këto fjalë: «Një pusulle e vogël ishte, givshe...» dhe përgjigjen e gjyshes: «S'kam gjetur gjë mor bir. Të bëvesim njëherë Skerdin»? «Jo, nuk ka nevojë. Po të më kërkojë njeri në videofon, të lutem, më zgjo!»

U shtanga me fletoren mbledhur tub para gojës. Nië pusulle? Thua të ishte e Gjergjit? Rrëmbeva copën e letrës si i urituri copën e bukës. Që prej këtij çasti vetja më dukej një eksplorator i madh. Sa do të habitej Peti përkëtë zbulim!

Tia kthëja përséri pusullen e kumburtim vëllai sikur nuk shkonite. Cdo gjë do të merrte fund si fluskë sapuni. Isha i bindur që Giergji me shokë po bërgatitnin diçka. Tanj i kuptojal qartë mbylli jetët tij në dhomën e studimit së bashku me shokët duke diskutuar pareshtur për disa skica. Mirë po ky rast s'do të më shpëtonte lehtë. Le të qesh të im vëlla pastaj, jo nuk ke

bërë këtë, jo nuk di atë. Më ishte mbushur mendja top t'i zbulojë të gjitha.

Prita rastin më të përshtatshëm dhe u turra në videotfon.

— E kishim lënë të të merrja unë, — ferkoi sytë Peti.

— Ngjarjet u përbysën, — imitova unë një artist të famshëm filmi. — Eja tek unë para orës së caktuar. Gjyshes thuaji se do të shkojmë në ekskursion.

— Në sikur e kishim lënë... — Ende s'po kuptonte Peti pikalosh. — Shumë gjëra nuk thuhen në videotfon, — mbylla aparatin i kënaqur që Peti po plaste nga kureshtja.

Në fund të rrugës kalimtarët ndalnin hapin. Dikush hiqte syzet përtë na parë më mirë, po mëritë shumtët buzëqeshnin. Unë dhe Peti vrapuam me sa na hanin këmbët.

— Më mirë ta heq shallin, — fshiu djersën Peti. — Eshtë vapë...

Kasketën verore e ngjesha më thellë në kokë duke i kthyer një përgjigje të vendosur:

— Si kështu?! Bashkë vendosëm të maskohemi! Dëshiron të na njohe Gjergji?!

— Nuk' e kam aty... — tregoi me kokë kalimtarët.

— Po të të pyesin, thuaju se si ke bajamet e sëmura.

Peti shfrytësi lokomotivë trëni. Sigurisht mallkontenjëqind herë vefen që nuk zgjodhi kasketën vërore. Të mbaje atë shall të trashë ishte torturë e vërtetë. — Shëëët! Rò vjen! — Gjergji hapi derikëndre gardhitësirëthues. Në dorë mbante një çantërlëkure. U fshehiëm vetëtimthi pascëpit të pallatit përballë. Shoqëruam me sy lëvizjet e tij të binduri seze kishim gjetur fijen e lëmshit. Letëmos, tregonte tani Gjergji për «shpikjet» e tij. Letu shkruante shokëve pusulla. Ne dønta merrnim vesh planin e tyre, e pastaj...

— Ta ndjekim? — pyeti shokù. Bulëza të mëdhandjerse rrëshqitnin në fytyrën e skuqur. Prekat e shumta në hundë i ngjasonin me grupin e ishujve të Malajzisë në atllasin gjéografik. — Prifti... — Të nxitoje ishte kollaja. Gjergji ndërkohe kaloi trotuarin dhë po i afrohej stacionit, të trenit elektrik.

— E pse të mos ia japim vetë pusullën? Ai mund të na tregojë gjithçka. — Sa lehtë është merrte gjërat! Gjergji na quante të vegjël. Përsë nuk dönte që të më

pyeste gjyshja pér pusullën? Përse po ikte me një çantë të bukur në dorë jashtë qytetit? Kjo trëgonte, si një e një bëjnë dy, fshehtësi të plotë.

— Mos uibëj budalla! Gjergji nuk do kurrsesi të merret vesh plani.

Treni rrëshqiti lehtë në shinat e trotuarit. Ky tren përdorej vetëm pér shërbime urbane e pér transporte udhëtarësh në pikat turistike. Gjergji hipi bashkë me një grup kalimtarësh.

— Ej, më dëket isë ma pa! — u tërhoq Petii duke fërkuar hundën.

— Shikon ëndrra mes sy hapur? — ia ktheva jo fort i sigurt. Dicka kisha parandier edhe unë, por zhuk doja kurrsesi të besoja se gjithçka do të merrte fund aq shpejt.

— Bile edhe buzëqeshi, — shtoi Petii. — Jo, more... Mós vallë edhe të përshtëndeti. — u ngërdheshat unë, po me vete sikur i dhashë të idrejtë. Peti ishte i tmerrshëm pér këto punë. Mund t'i dallonte zogjtë edhe në fluturim, jo po ky është gushë-kuq, ky tjetri bishttundës, ai tjëtri në degë mëlljenjë! Madje një ditë Beni solli aparatin filmiik që zmadhonte pér të fituar bastin dhe e fitoi.

— E vëmë me bast? — dëgjova thënien e njohur të Petit.

— Jemi përpara një misioni të rëndësishëm, ti na flet pér baste.

— E... Vërtet... G'na duhen bastet tani, — fshiu djersën Peti.

Përparuam me sa na phanin këmbët, u kapëm fort pas derës së paçme dhe u ulëm si qengja në kolltukët e fundit. Fati ishte me ne; Gjergji nuk mori mundimin të shikonte në kolltukët e fundit, madje hapi çantën, nxori prej saj një libër të trashë dhe u zhyti në lexim.

Kjo anë e qytetit më kujtohej si nëpër mjegull. Kaluam dy parqe të mëdha, një stadium, të mbuluar dhe një varg ndërtesash shumëkatëshe. Peti dukej më pak kureshtar. Babanë e kishte rregullues të paneleve të ngrohjes që punonin me energji diellore dhe shpesh udhëtonte me të nëpër qytet.

— Një herë hogëm keq, — filloi të trigonte Peti, sikur të ishte vetë mjeshtër elektronik. — Pallati ishte bërë akull, kallkan. Lajmërojnë babanë. Eja, Peti, më thotë, do të shkojmë të rregullojmë panelin e ngrohjes te një banesë këtu afër. Unë pa ë zgjatur rrëmbeva çantën e veglave, shaluam trenin urban e për disa sekonda u gjendëm në vendin e caktuar. C'të shikonim! Banorët kërcëllonin dhëmbët nga të ftohtët.

— Pse, nuk kishin mjet tjeter për t'u ngrohur?! — ndërhyra unë me mosbesim. — Kishin, — u zu ngushtë Peti; — po përparrë ngrohtësisë së diellit nuk vinin as gjë tjeter. Ku e lamë? Hëm, ata kërcëllonin

dhëmbët nga të ftohtët. Sa na panë ne, thirrën tri herë urra, urra, urra!

— Kjo gjë s'më besohet!

— Pyet babanë në të gënjej! — u hodh Peti i fyér, por edhe i bindur që asnjeri nuk do të merrte mundimin të pyeste babanë.

— Hipëm me shkallë vetëlëvizëse. Ishte bërë batërdi! Mineralet e rralla, që kthenin energjinë diellore në elektrike, kishin shkëputje nga ushqimi. Ti e di që pà to as bishtin e denit nuk mund të ngrohësh. C'të bënim! Njerëzit ende kërcëllonin dhëmbët nga të ftohtët.

Vetëm ndalesa e trenit i dha fund tregimit të Petit, që do të zgjatei pa mbëram dhe ndoshta do të ishte pikërisht ai shpëtimtari i njerezve të shkretë.

— Kuides! Nuk duhet të na shikojë, — i përshnërita tregimtarit të shquar.

— Ashtu them dhe unë, — u kujtua përmisionin delikat Peti.

I ndjekuri vazhdoi të ecte qetë. Zgjodhi një rrugicë zhytur në gjelbërim e pas pak ktheu në një shteg që të conte në rrethinat e qytetit.

Papritur dëgjuam një fërshëllimë. Në shteg u shfaq edhe një shok i Gjergjit, u takua me të dhe të dy ecën krah për krah. Peti më goditi me një goxha bërryl. Mezi e përbajta veten pa thirrur prej dhimbjes,

Në fund të fundit nuk isha prej hekuri! Të gjitha i kisha pârë me këta sy!

— Ti, Skerdi, je i madh! Dicka po përgatitet!

— Fjalët të pakta! Fshiu pas drurëve!

— Ata po shkojnë drejt kodrës...

— Ehë... Aty si duket e kanë lënë takimin.

Ecnimi si lëpuiti Tashmë rruga kalonte pranë brigjeve të plumit. Zalli kërciste nën këmbët tonë, e ndienim sikur zemra do të na pushonte aq herë sa kërciste zalli. Ndallëm duke mbajtur fryshtë pezull. Për një çast kujtuam se Gjergji ktheu kokën, prandaj u fshëhëm.

— Përse ndale? — pyeti shoku që e shoqëronte.

— A të shkon ndërmend se mund të na përgjojnë? — tha Gjergji duke këputur një degë të thatë.

— Të n'a përgjojnë?! Kush, ata të shkollës «Rilindja»? Jo, jo, as kam dyshim përnjë gjë të tillë, — qeshi djali që quhej Bleidi. — Kujton se dikush nga ne do të ketë folur përfshirur fluturimin?

— Jo, mo, jo, po... Desha të thëm që atë cipë shënim që më dërgove e humba.

— Oh, e pastaj? Kujt i hyn rië punë?

— E kam edhe unë një vëlla kureshtar.

Po të futej me Bledin nëpër shkurre ishin të humbur. Trupat tanë të struktur u

bënë një me tokën. Të rrahurat e zemrës së Petit i ndieja më shumë se të miat. Kjo afërsi na ngrohu e na dha më shumë kurajë.

— Të thashë unë që dyshojnë?! — pësh-përiti Peti.

— Shëët! — A nuk e shikon? Po largo-hen.

Peti nxori hundën nga shalli i trashë. Dy siluetat vazhduan të ecnin më tej shoqëruar nga disa itë qeshura që të themi të drejtë mua nuk më pëlqyen aspak. Kështu kukurisej përherë Gjergji, kur donte atë më ngacmointe ose kûromerrte vesh për ndonjë bëmë timen.

— A t'u mbush mendja që diçkà po përgatitin... C'ishte ky flútürim? — Irregullova kasketën unë.

— Jemi përparë një enigme, ke të-drejtë; — ferkoi duart Peti dhe u bë gati t'u lëshohej pas.

— Të presim pak! Mund të kenë lënë röjë.

— Ngjitemi asaj ane! — më tregoi një shpat veshur men shqopë, që lartohëj në të djathtë.

S'është zëqe. Pëqj andej kishim mundësi të vroitonim në thellësi pa u diktuar. Vec mendimi im se duhej pritur edhe-pak u gjet me vend.

Pritëm dhjetë minuta, pastaj u drejtua më asaj ane. Duart na u gjervishtën keq,

kurse trupi lëshonte avull. Peti e mbështollë shuk shallin. Unë hoqa kasketën, duke e justifikuar me ngjyrën e saj të bardhë. Në të vërtetë më shumë ndieja vapë, koka më dukej se ziente si krater vullkani.

Nëpërmjet dy të çarave pamë atje poshtë. Një lëndinë e vogël, rrëthuar me shkëmbinj, dukej se ishte formuar enkas për një aerodrom të maskuar.

— Nuk shoh gjë! — dihaste Peti.

— Sa i nxituar je, — i tërroqë vëmendjen. — Atje tej dallohet një hyrje.

— Peti, Izgjati kokëng Vrimat e hundës iu hapënpaq dhe gati sa s'thirri.

— Ja! Jaku janë!

Tashmë po i shikoja edhe unë. Jo larg hyrjes, përpara një letre të shpalosur diskutonin një grumbulli djemsh, madje në mes tyre lëviznin dy bishtaleca. Sigurisht ndonjë vajzë.

Vendosa gishtin në gojë dhe rrëshqita në atë drejtim. Peti më ndoqi si një qengj i urtë. Shkurret dhe bimësia kacavjerrëse që kishte mbirë në gropat shkëmbore masroi mirë afrimin tonë. Zumë vend dhjetë metra mbi kokat e tyre për të dëgjuar më mirë.

— Hidrogjeni është i rrezikshëm, — fliste një djalë i hollë me një laps në dorë që tregonte diçka në skicën e shtruar përpara.

— Edhe unë i këtij mendimi jam, — vazhdoi Gjergji duke rrrotulluar nëpër duar çantën prej lëkure.

Pakëz më tej qëndronte Bledi me grushtet në dhe. Djali tjetër dhe vajza me bish-taleca miratonin me kokë. Këta të dy i shikonim për herë të parë.

— Drejtuesi shkencor mendon se heliumi është më i përshtatshëm, — ngulte këmbë djaloshi që nuk e njihja. Ishte zeshkan, me trup atletik, në fytyrë i dallohej një nishan sa një kokërr kafe.

— Shikoni, shikoni, — vazhdoi Gjergji. — Na duhet një aerostat që vetëm për nga forma t'u ngjasë atyre të kohës së lashtë, kurse nga funksionimi të jetë i sigurt për studime aeronautike. Konkursin e vjetëm e humbëm. Këtë vit besoj se do të ndero hemi.

— Koha është e shkurtër, Gjergji, — kumboi zëri i vajzës. — Ku do t'i pörositim koshin, balonën, aparaturat?

— Koshin do ta ndërtojmë vetë. Në bazën tonë prodhuese do të ndërtojmë pjesët e veçanta, pastaj e montojmë në vend. Bledit i premtoi i ati për tekstolitin e balonës. Edhe profesor Bardyli do të na ndihmojë për planin tonë.

— Ç'ta zgjatim, — hidhet Bledi, — t'i futemi punës. Vetëm, shokë...

— Përfitova nga ky çast për t'i u afruar
Petit, që qëndronte si mumje.

— E shikon, Peti? Dojtë ngrënë aerostat.

— Si atë të Qendrës Kërkimore Aeronaute?

— Diçkare tillë.

— Oh, usq qejf do të ishte të fluturonim dhen!

Peti sikur ma mori mendimin nga koka. Që atë çast e përfytyrova veten në qiell. Prej lartësive dojtë shikoja shtëpitë kullat, do të prekja retë e dendura.

— Fute kokën! — m'i ndërpreu mendimet Peti. — Ata po ngrihen!

Të rinjtë u shpérndanë një nga një. Në veshë na jehonin, ende thirrjet e tyre të gëzuara. Heshtja, që përfshiu vendin, ma hoqi disi ëmbëlsinë e së papriturës. C'e do! Prapëserapë nuk do të kishim mundësi të hipnim në aerostat! Plani i këtij grupei më dukej mrekullia vetë. S'kishte gjë më të keqese, të ishe njëmbëdhjetë vjeç! Në rrëthet tonë shkençore mjaftoheshim me ndonjë ekspeditë, e shumta fluturonim me planer. E ku planeri që drejtohej me pilot, ku aerostati!

Edhe Peti, si dukej, këto mendonte, sepse luante me cullufet e pashtuara.

— Sikur t'i ndihmojmë në punë, mba se hipim edhe ne; — tha me zë të shuar Peti.

— S'është kollaj tē fluturosh me balonë, — ia ktheva më shumë nga dëshira që tē tregohesha i ditur. — Ata do tē kenë me vete një aeronaut me eksperiencë.

— Nuk i them, — u tërhoq Peti.

— Si nuk thua?! — shfryva sikur makishte fajin ai. — Balonai mund tē ngjitet në lartësi tē mëdha deri në 5000 metra.

— Pse tē mos shkojë deri në dhjetë mijë metra? — filloj zmadhimini si zakonisht shoku im.

Rrallohet ajri, — ia prevaj shkurt. Kisha frikë se pyetjet e mëvonshme do tē më detyronin bëtë rregelesha keq, gjë që Peti do ta dëshironte shumë. Shpesh këtë «kryengritje» tē vogla kërkonin tē rrëzönin autoritetin tim, sepse Peti më mban te më tē ditur se veten jo vëtëm se dëftesa ime ishteme nota më tē mira, por edhe pse nuk ngu-rroja tē futesha në bëma që ai s'guxonte t'i provonte.

Ndarjen, si zakonisht, e bëmë para postës. Të nesërmeni kishim premtuar mësuesit të zoologjisë ta shqëronim në zhjtjen e zakonshme tē natyralistëve pranë lumit tē qytetit. E prisnim me qejf këtë ditë, po zbulimi i sotëm ia shtonte dyfish rëndësinë.

Në mës tē grupit tē akualangistëve tē shkollës dikush fliste me këmbë e duar! U

afrova për të parë ç'bëhej në atë turmë entuziaste. Për habinë më të madhe, ciceroni që fliste e i kishte lënë të tjerët me gojë hapur ishte Peti. Asnjeri nuk e vuri re afri-min tim, kështu që unë pata mundësi t'i dëgjoja ligjëratat e shokut me gjak të ngrirë.

— Ju thashë që në plazh nuk mund të zhyteshim. Urë do ta provoja si një e një bëjnë dy, po ç't'i bëja Skerdit, që druhej. Bëmë ca debate, pastaj vendosëm t'i hipnim hidroplanit. Unë, kuptohet që e ngas me sy mbyllur, kurse Skerdi e mësoi me vësh-tirësi. Hipëm në hidroplan, ia lëshuam me gaz dhe në det të hapët...

— Sa milje larg? — pyeti Adriani, që i gëlltiste të gjitha.

Unë gati sa nuk plasja nga inati. Me ç'të drejtë më merrte nëpër këmbë Peti? Unë frikacak?! Ia tregoja më vonë. Në sy të shokëve s'duhej nxjerrë fjalë. Më thuaj me kë rri, të të them se cili je, do të ma përplasnin menjëherë në fytyrë!

— Po nja dy, tri... shtatë milje, — vazdoi Peti pa as më të voglin ngurrim. — Veshëm akualangët dhe bëlldumb... benda. Deti kishte një ngjyrë të shkëlqyer. Ç't'ju them! Peshqit me miliona. I them Skerdit: «Hyjmë në thellësi?» Bëri ca naze, po pranoi. Zhytemi në thellësi... Aha, këtu e pamë veten keq! Skerdit filluan t'i dri-dheshin këmbët nga të ftohtët. Ç't'ju them.

Bile edhe mua filluan të më dridhesin.

— Po ju ishit veshur me akualang?

— Ishim veshur, nuk them, po deti është i ftohtë në thellësi. Pse, lumë është deti?! Pranë një shkëmbi vumë re një vrimë të zezë. Skerdi më tha: «Atje është frikshëm, Peti, ec kthëhem!» E pashë një herë me inat dhe ia ktheva përgjigjen fët e fët: «Unë do të hyj, ti, po pate frikë, më prit në hyrje!» Me të thënë e me të bërë. Hyra në thellësi. Ndeza projektorin, por ç'të shikoja! Një goxha oktapod flinte si mëshqerrë. Tentakulat i kishte dhjetë metra të gjata, kurse sytë sa një pjatë gjelle. Këtu, të them të drejtën, u tremba, por, e mblodha veten, përderisa flinte...

— Nuk lëvizte fare? — vazhduan pyetjët.

— Ore, si i ngordhur ju them! Do të doja të përparoja më tej, por ai oktapodi i pështër më kishte zënë rrugën. Për një çast mendova ta goditja e të çaja përparrë. Kisha vefém thikën e molusqeve, po më të nuk mund të prisje as bishtin e qenit, jo më atë alamet kafshë deti. Befas trupi i oktapodit u drôdh. Si duket u zgjua. Duhet ikur sa nuk është vonë, mendova dhe fap... u drejtova për nga daljë. Ç'të shikoja, oktapodi e kuptoi qëllimin tim dhe ma zuri rrugën me tentakulen më të gjatë, që rrrotullohej si gjarpër përparrë syve të mi. Hëm...

Papritur sytë e mi ndeshën me të Petit. Kaloi pështymën nga zori, po tregimin nuk e la në mes. Shokët nuk kuptuan gjë nga ky vështrim. Historia e Petit ishte mjaft interesante dhe do të dëshironin ta dëgjonin deri në fund.

— Tentakula ishte goxha e gjatë. — vazhdoi Peti, tashmë me zë të ulët. — Si të veproja? Nxjerr thikën, pastaj lajmëroj Skerdin në radio. Skerdi nuk e humb toruan, vjen si vetëtimë, me thikë në dorë. Përleshemi një copë herë me tentakulën, çlirohemi dhe dalim fitimtarë...

Tregimi i Petit kishte mbaruar dhe kushdo nga ne shikonte tjetrin në sy. Disa syresh u kujtuan dhe për praninë time.

— Pritej me zor tentakula, Skerdi?

— Hëm! — u përtypa unë. — Jo dhe aq! Mishi i oktapodit është i butë. Që ishte gjë e tmerrshme, duhet ta pranojmë...

Petit i ndriti fytyra. Kujtonte se unë do t'ia përplasja në sy bombën e gënjeshtës. Ah, mor Peti, nuk më njihke mirë! Unë jam burrë e nuk i braktis shokët në fatkeqësi.

Mësuesi i zoologjisë erdhi pakëz me vonesë.

— Të më ndjeni, pionierë! — kërkoi të falur. — Aparati i filmit për xhirime nënüşore pati një defekt. Tani jemi gati.

Morëm rrugën anës lumit. Kënga e

bretkosave zhurmonte. Aty-këtu plaqurit-jet e peshqve që kërcenin ishin refreni i muzikës fëshfërítëse të kallamishtes. Pilklat ës Vesës lotonin majë bistakëve të gjelbéruar, ku insektet e zogjtë pranverorë gëlonin si mes një tregu të zhurmshëm.

Të gjithë ishim pajisur me akualangët e rrethit të natyralistëve. Mësuesi porositi me durim se duhet të ndaheshim në grupe, të mos shkaktonim zhurmë në ujë, në qoftë se dëshironim të shuanim kureshtjen me bimët dhe kafshët e ujtit...

Befas një britmë e zgjatur e Luljetës drithëroi ajrin e lagësht dhe trupat tanë. Vajza tregonët në drejtim të një cektine. Përse ishte trembur? Uji ishte i tejdukshëm, sa dallohej fundi i shtruar me gurë e zall të rrumbullakët.

Pa e hequr çantën e shpinës Arbeni iu afroa shoqes me shpejtësi. Në ujin e kthjellët lëvizte një gjarpër jo larg këmbëve të saj.

Mësuesi buzëqeshi.

— Mos u shqetëso, Luljeta! Është gjarpër uji.

— Gjarpër uji?! — tha Luljeta me fytyrën dyllë të verdhë. — E pastaj!?

— Pastaj, nuk të kafshon, s'ka dhëmbë.

— Ndërhyri Peti.

— Peti, mos bëj gabime, — ia ktheu mësuesi, — çdo gjarpër ka dy të tillë.

— Mund të jetë dhe nepërkë. — përgatiti një bigë trimoshi ynë.

— Dallimi është i qartë, — u afrua mësuesi, — gjarpri i ujit ka dy njolla të verdha në kokë. Nuk të helmon, Luljeta, pasi nuk ka helm.

Ndërkohë gjarpri dredhoi i trembur, duke lënë një turbullirë të lehtë në llum, po Luljeta e shoqëroi edhe ca me sy.

Kaluam dy-tri vahë pa shkëmbyer asnjë fjalë. Sipër kokave fluturoi një fajkua. Në lumë, ca peshq të shkathët, tepër të ajthshëm në lëvizjet e tyre, sulmonin çdo gjethë a degë të thatë që binte në rrjedhë. Kudo mbizotëronin kuisjet e bretkosave dhe shpendëve të ujit.

Vendin ku do të zhyteshim e caktuam pas gjysmë ore. Dukej i qetë se formonte një gji natyror të mrekullueshëm. Mes klithmave gazmore filluam të kërcenim rreth e rrotull e të matnim thellësinë, shpejtësinë dhe temperaturën e ujit. Ora shënon-te dhjetë. Ngrohtësia e diellit të lejonte t'i gëzoheshe kësaj zhytjeje në brendësi të lutimit.

Akualangët, një veshje për punë nën-ujore, ishin të lehtë, praktikë, me shtresë ajri për ta mbajtur temperaturën të pandryshueshme dhe rezervë oksigjeni për disa orë. Nën maskë vendosej hidrofolësi, kurse në pjesën e ballit kamera e vogël e hidro-

pamësit, që shërbente për ndërlidhje në largësi.

Përgatitjen e bëmë pa u ngutur. Më duhej t'i ndihmoja dhe Petit, që rrrotullonte mbërtheckat i hutuar. Po ta kishin parë shokët në këtë gjendje, do ta mernin me «hya». «Po ti u zhyte në thellësi të detit, u përleshe me oktapodë», i thashë me ironi. «E..! Mendje është, të shkretën!» — vuri gishtin në buzë ai.

Luljeta rrrotullonte fletët e helikës. Zhytej për herë të parë nën ujë dhe nuk e fshih-te emocionin.

— Kjo do të më shtyjë në ujë? — më pyeti.

— Vetëm në raste kur duhet shpejtësi e madhe. Përfytyro sikur të sulmon ndonjë peshkaqen, — i thashë më shumë për t'i treguar se dija shumë gjëra për zhytjet. — Në krah ke tre butona. I pari shërbën për ujëfolësin, i dyti për helikën e lëvizjes, i treti për rregullimin e ajrit gjatë dihatjes. Nën ujë këto kostume ta kthejnë notimin në një shëtitje të këndshme.

Mësuesi kontrolloi për herë të fundit aparatin për xhirime nën ujë dhe projektorin. Filmimi në këto kushte kërkon mprehësi të madhe, duar të fuqishme dhe shkathësi.

Takimi me ujin sikur na shtoi gjallërinë. Në fillim notuam ngadalë, duke mbë-

shtetur herë pas here këmbët në zhavorrin e rrëshqitshëm të tabanit. Në grupin që printe mësuesi bëja pjesë dhe unë së bashku me Arbenin e Luljetën.

Një tufë cironka kërcenin përpara apartateve si për të na treguar pushtetin e tyre. Më tej dy trofta ndërruan drejtimin të trembura. Arbeni lëshonte klithma habie.

— A do të gjuajmë? — dëgjova zërin e tij në kufje. Mësuesi e sqaroi me durim se gjuetia e peshqve lejohej vetëm në muaj të veçantë.

Kishim vetëm dhjetë minuta në ujë, kur papritur u bëmë dëshmitarë të një ngjarjeje jo të zakontë. Peti tregoi një mi uji që zhytej e dilte në një cep të bregut.

— Po lahet? — pyeti Luljeta.

— Mundohuni të mos lëvizni fare. Heklikat të mos përdoren! Kujdes! Përkuluni nën rrënjet e shelgut! — kërkoi me këmbëngulje mësuesi duke përgatitur aparatin filmik.

Miu kishte zgjedhur si pre të vetën një krustace lumi. Gaforrja luhatej mbi barishte, duke lëvizur ngadalë nyjet e këmbëve dhe antenëzat që ngjasonin me mustaqe të holla.

Pas pak miu sulmoi edhe një herë gaforen, që u mbrojt me vendosmëri. Prisnim që gjitari i vogël të shijonte një drekë të mirë pasi ishte sa dyfishi i gaforres me

trup. Veç ndodhi ajo që nuk pritej... Miu e humbi drejtimin. Mashat e gaforres e mbërthyen fort poshtë grykës dhe miu u mbyt mes përpëlitjesh. Pastaj ngadalë-nga-dalë gaforrja e copëtoi gjahun e rrallë.

Ne ngelëm gojëhapur.

— Miu i ujit është armiku kryesor i gaforres, po trimëria e saj shpesh e çon këtë grabitqar trupvogël në disfatë të plotë, — tha mësuesi i kënaqur nga xhirimi.

Shëtitjen nënurore e vazhduam më tej. Siç dukej të papriturat me gaforret do të vazhdonin.

Kur po ktheheshim nga vizita e mrekullueshme nën lumë, mendimi më shkoi përsëri te fluturimi me balonë që po përgatiste im vëlla së bashku me shokët. Gjatë rrugës bëja plane nga më të ndryshmet, por të gjitha dështonin. Gjergji asnjeherë nuk do të pranonte të më tregonjtë, pale të më merrte në fluturim.

— Do të kthehemë në shtëpi?

Zëri i Petit, sikur më zgjoi.

— Mos harro sot. Kemi vendosur të shkojmë në Pallatin e Zhvillimit.

— E kush tha se kam harriuar?! — u hodha. — Po na duhet të marrim vesh çfarë ka sajuar Gjergji për aerostatin.

— E çmund të kenë bërë për tri ditë, — trokëlliti xhepat e mbushur Peti. — Nësër mësojmë ndonjë gjë të re.

Kërkonte t'i linte përgjysmë punët ky Peti ynë, po me mua nuk i shkonin! Kur i vihesha një pune, duhet ta mbaroja që ç'ke me të. Mësuesi i historisë më lëvdonte shpeshherë për vullnet të fortë, që Gjergji e quante kokëfortësi, nëna shpesh e quante tekë, kurse babai qeshte sa herë më qortonin. «Skerdi është tip shkencëtarit», më lëmonte lehtë flokët. Gjergji sa nuk mekej nga të qeshurit, ndërsa gjyshja nxitonë t'i shuante menjëherë gjakrat.

— S'kemi ftesë. — I kujtova vështirësinë e parë shokut tim.

— E... Është e vërtetë, — fërkoi çac-kën e kokës Peti, po nuk e humbi toruan. — Do të marr ftesën e motrës. Zakonisht ajo shkon te tezja ditët e shtuna... Ti merr të Gjergjit. Këto pasdite ai nuk ka kohë të shkojë në Pallatin e Zhvillimit.

Ku s'i shkonte mendja! Ishte mrekulli të rrije pranë nxënësve të rritur, të dëgjoje biseda për shkencën, ndonjë film me jetë kafshësh. Këto ditë pritej të vinte dhe një kozmonaut i njobur që, së bashku me kozmonautë të tjerë botërorë, kishte marrë pjesë në fluturimin drejt Epsilonit të Eridanit.

— Hë, si thua? — priste Peti me padurim, duke picërruar sytë e rrudhur hundën. — Motrën ma quajnë Enkelejda. Unë hedh një pikë bojë mbi «anë» dhe bëhet Enkelejd.

Veprimi, megjithëse i dënueshëm, ishte një zgjidhje e hatashme për të hyrë në pallat. Nxënësit e shkollave të ulëta atje nuk lejoheshin.

Aty për aty nuk e shfaqa entuziazmin tim për mendimin e shokut. Dhe jo pa shkak: Peti do të kujtonte se isha më pak i zgjuar e nuk ma priste për të tilla gjëra.

— Fundja shkojmë, — psherëtiva, si për t'i treguar sakrificën e madhe që po bëja.

Portieri mati shtatin tonë dy herë me sy, rrotulloi po aq herë kokën me mosbesim, por nuk tha asnje fjalë.

Peti, për të qenë brenda, mbante veshur një xhaketë dimërore, flokët i kishte krehur e shtruar me kujdes anash, ndërsa këpucët i kishte lustruar aq shumë, sa në to mund të shikoje fytyrën.

Unë isha veshur si zakonisht. Mundohesha t'i jepja fytyrës një pamje hijerëndë, që rrumbullakësia e saj, sytë e mëdhenj dhe qerpikët e gjatë e shndërronin në ngerdheshje. Peti mezi e përbante të qeshurën kur më shikonte, sepse mundohej t'u shmangej syve të mi.

Në hyrjet e gjëra të pallatit zhurmonin nxënësit e shkollave të mesme. Dikush

fiksonte në aparatin fotografik pamje pik-turash, disa syresh mundoheshin mbi një kamera televizive, të tjerët, pjesa dërrmuese mbushnin sallat e veprimtarive.

Fillimi siht u drejtuam në kopshtin e mrekullueshëm botanik. Aty afroheshin nxënësit e klasave të ulëta, që nuk ndryshon shumë për nga shtati. Edhe aty nuk na u ndanë vështrimet e dyshimta.

— Që kur filluan të merren me shkençë dhe pionierët? — dëgjuam një flokëkuq.

Peti shtrëngoi grushtet nga inati, me gjithatë, pa folur, i ktheu kurrizin.

Kopshti zoologjik na tërhoqi si magnet. Vizituam me radhë kafshët e egra, u ndalëm gjatë para një krokodili, ngacmuam pa na parë njeri majmunët zhurmëmëdhenj, pastaj dora-dorës kaluam në mjediset e brendshme të pallatit.

Pas kopshtit filluam të shkonim nga një sallë në tjetrën, po temat që zhvilloheshin atje ishin aq të vështira për ne, sa Peti si hynte dilte, madje në fund u mërzit dhe të dv përfunduam korridoreve të hutuar.

Befas unë u ndala si me sustë. Përballë nesh u shfaq portieri që po na zhbironte me sy. Kishte hequr edhe syzet, si për të na parë më të shkurtër se ç'ishim.

— Përse sorollateni nëpër korridore, fëmijët e mi?

— Deshëm të thithnim pak ajër të pastër, — kuturisi e tha Peti.

— Ashtu?! — një buzëqeshje qesëndie u end në buzët e holla prej plaku. — Në cilën sallë ndodheshit?

Njeriu i shkretë ndodhet ngushtë para pyetjeve të tilla të njëpasnjëshme, sidomos kur hyn në një vend me ftesa të huaja dhe pa as më të voglën dijeni për morinë e sallave që ka ky vend.

Portieri priste përgjigjen tonë me një ndjenjë triumfi.

— Më tregoni ftesat? — erdhi pa asnë vonesë pyetja tjetër, më e pamëshirishme se e para.

Peti më shikonte si për të më qortuar rëndë. Pse, qëndrim ishte ky? Pas pak ftesat do të binin në duart e portierit dhe loja jonë do të merrte fund si flluskë sapuni... «Eja të ikim!... Të zhdukemi», flisnin sytë e tij.

Jo, or Pet, unë nuk turpërohem! Do të duroj si burrat, fundja gabimin e kishim vetë. Portierit duhet t'i kërkonim të falur, pastaj të shkonim në punën tonë... Pallati Pionierëve kishte mjedise të mrekullueshme, kurse ne të zgjuarit kërkonim të hynim te të mëdhenjtë!

— Dëgjuat?! Ftesat tuaja desha! — nguli këmbë portieri me një zë jodashamires.

— I treguam pak më parë, — u përpëlit edhe një herë bashkëfajtori im. Nuk e

kuptonte se me tē tilla profka nuk bindej portieri?!

Atē çast bëra atē që Peti do ta quante gafën më tē madhe tē shekullit, pasi, duke mos i treguar ftesat, portieri do tē na shqéronte urtë e butë jashtë dhe emrat tanë do tē ngeleshin pa njollë.

— Jemi me ftesa tē huaja, — ia shkrepap me një frymë, i habitur edhe vetë nga ky guxim prej luani. Sigurisht, diku thellë në zemër, në ato qoshe tē saj, ku unë mbaja thesare tē mëdha sinqueriteti, bëhej luftë ndërgjegjeje. Të tilla raste për vëllanë tim unë shkëlqeqa si meteor në qiell tē pastër.

— Ashtu?! Keni vepruar shumë keq!
— tha portieri tashmë i zbutur dhe pakëz kureshtar. — Patë ndonjë aktivitet?

— As edhe një! — shfryu Peti më shumë për inatin tim.

— Sipas rregullit duhet tē më jepni emrat. Le ta gjykojë organizata veprimin tuaj, — shtoi portieri me njëfarë keqardhjeje.

Urdhëro! E mendonim një fund tē ti-llë! Emrat tanë do tē shkonin në shkollë. Të gjithë do ta marrin vesh «proçkën», lexoja në ballin e rrudhosur tē Petit. Kishte tē drejtë, nuk them, por ishte ideja e tij që na solli në këtë përfundim. Të dy e meritonim dënimin.

Thamë pa e zgjatur adresën dhe me

bisht në shalë, siç do të shprehej më vonë Gjergji, ecën mes turmës së kalimtarëve që nxitonin kush në autobusët elektrikë, kush në stacionet e palanerëve fluturues. Peti ankohej vazhdimisht, kurse unë heshtja si Sfinksi i Piramidave.

Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra, shoku Pet!

4

Sjelljen tonë në Pallatin e Zhvillimit as organizata as familja nuk do të na e fal-nin. Shumë vite më parë mbasë ndodhnin më shumë gjëra të tillë, po tani këto faje të lehta s'kalonin pa gjurmë. Peti e kishte më pisk, sepse «trimëritë» e tij po përsëri-teshin fill pas ngjarjes, me lepujt. Ndjeja dhimsuri pér të, por asnjëherë nuk e tregoja me fjalë. I lëshova pe në drejtime të tjera dhe ai e kuptoi fare mirë keqardhjen time.

Cështja e balonës na ngacmontë vazhdimisht. Kishim ditë që s'po mësonim gjë të re. Gjergji na rrëshqiste si ngjale. Te vendi i grumbullimit mblidheshin rrallë. Thua ta kishin kuptuar qëllimin tonë, apo ruhen nga grupi tjetër? Dyshonim se i kishin ndryshuar pikat e takimit dhe punonin në

fshehtësi. Ankthi dhe dyshimet na rrëmbe-nin orë të tëra mbushur me biseda, aq sa Peti regjistroi edhe një notë të dobët. Pas-këtaj iu desh të mësonte seriozisht për ta përmirësuar. Babai s'do t'ia falte këtë rëniet dhe planet tonë do të bëheshin pluhur e hi.

Gjyshja e kuptoi e para ndryshimin tim.

— Ke marrë ndonjë përfundim të dobët?! — më pyeti e merakosur.

— E përsë!? — bëra sikur u habita.

— Ke ndryshuar, mor bir... Sikur ëndërron shpesh.

— Posi! — shfryva. — Ty, gjyshe, sa herë që të dukem pak i mërzitur, mendja për keq të shkon.

— E ku të më shkojë tjetër? — qeshi ajo. — Sëmurë nuk je, se pjatat i përlan me një frymë. Halle nuk ke mbi kokë. Pa më thuaj, ku të më shkojë mendja tjetër?

— S'kam pse gënjej, — hapa fletoren e notave. — Urdhëro shiko! Në qoftë se kenë dëshirë, mund të pyesni në shkollë.

Fjalët më fluturuan pa kuptuar dhe desh kafshova gjuhën. Ç'më duhej t'i kujtoja shkollën! Emrat tanë duhet të ndodhenë diku në fletoren elektronike të drejtoret. Ato s'mund të fshiheshin lehtë, fletorja elektronike, që s'ishte gjë tjetër veç një kompjutër me një ekran të vogël, i kujtonte drejtorit të gjitha punët e lëna përgjysmë.

Së shpejti furtuna do të përplasej në brigjet e mia.

— I thashë tët eti që të interesohet, — sikur e kuptoi mendimin gjyshja. — Këto dy ditë janë të zënë me projektimin e një anije. Sigurisht më pas...

Duhet të isha prishur shumë në fytyrë. Gjyshes i ngelën fjalët në grykë, u kollit nga zori duke më shikuar me vërejtje.

— Do të shkojë në shkollë?! — mërmërita.

— Në shkollë?! — tashmë në zërin e saj dallova dhëmshurinë e zakonshme. — Skerdi, ti diçka më fsheh. Babai s'ka nevojë të shkojë në shkollë, fletorja i tregon të gjitha.

Si dreqin i shqiptova ato fjalë... Fletorja — kompjuter kishte lidhje me çdo shtëpi. Prej saj mund të mësoje në çdo kohë përparimin e nxënësit, madje dhe sjelljen e tij.

— E di si është puna, gjyshe... Unë me Petin kemi një të fshehtë...

— Kaq e rëndësishme është, sa mos ta dijë gjyshja? — u çel fytyra e saj.

— Nuk është puna aty... Po Gjergji s'duhet të marrë vesh gjë, — fillova t'i mbillaçitja fjalët sikur të kisha karamele në gojë.

— Mirë, pra, — psherëtiu gjyshja, —

po të ndihmoj edhe kësaj here. Do ta bind babanë se ndryshimi yt nuk ka lidhje me mësimet.

Kjo u vinte vulën të gjithave. U ngrita si me sustë dhe iu hodha në qafë gjyshes së mirë, e putha plaq e pluq dhe pastaj i hodha një vështrim të shpejtë orarit. Të them, të drejtën dëshiroja ta zbuluaroja dëftesën me nja dy përfundime të forta që të çuditej pallati, madje edhe blloku. Vetëm kështu mund të vihej në vendnderi i humbur.

Të nesërmen u takuam, si zakonisht, me Petin përpara postës. Kishte diçka të gëzuar për të më thënë, pasi fytyra i shkëlqente si zemër bostani e dallohej që larg.

— Shpëtuam! — thirri si i shkalluar, pa pritur të afrohesha mirë.

Disa kalimtarë kthyen kokat të trembur. Kujtuan se Petit i kanosej ndonjë rrezik i tmerrshëm. Kur u bindën se asgjë e tillë nuk kishte gjasë të ndodhte, vazhduan rrugën me një buzëqeshje që mua do të më vinte keq të ma jepnin.

— Përse thërrret?! — i bëra shenjë.

— Nëna dje kontrolloi fletoren elektronike. Portieri s'i ka dhënë emrat tanë.

— Je i sigurt? — pyeta unë serioz, po zemra më këndonte.

— Dhe më thua! Nëna rastësisht takoi vetë drejtorin. Fjalët e zakonshme i tha:

Peti është i shkathët, i dashur, merr pjesë në eksperimente, duhet të ketë kujdes gjuhën.

— Kaq?

— Nuk më beson?!

Kjo ishte një mrekulli... Portieri i besoi sinqeritetit tonë, me një fjalë u bind që ishim djem të mirë dhe vetëm kureshtja na kishte shtyrë të hynim me ftesa të huaja.

Një perde mallëngjimi më mjegulloi sytë. Pas kësaj perdeje Peti më dukej djali më i bukur në botë.

— Kam edhe një sekret, — pëshpëriti shoku tashmë si ndonjë informator me përvojë, — Enkelejda bën praktikën në Kombinatin e Plastikës.

— Shkrepe, të shkretën! — ndala frymën.

— Grupi i shkollës «Rilindja» ka porositur tekstolit një plastmasë me fortësi të madhe...

— Domethënë, — gjithë fytyra ime qeshte, — domethënë ata po e ndërtojnë balonën.

— Këtë them dhe unë. Ata po e ndërtojnë e së shpejti do ta ngrenë në ajër...

— Do ta ngrenë në ajër?! — Përfytyronim koshin, balonën e fryrë dhe ata, ckipazhin... Lart, ajër i tejkthjellët i freskët, poshtë një gjelbërim i ngjer me qindra vezullime, objekte si lodra, njerëz si miza.

— Erdhi autobusi! — më përmendi shoku.

— Sot na duhet t'i marrim vesh të gji-tha, — ia ktheva i vendosur.

— E si! — shtangu Peti.

— Ta them në pushim, — thashë, i bindur se mendja më punonte si orë me kuarc.

* * *

Rrugëzgjidhen kisha dy ditë që po e bluaja në kokë.

Im vëlla mbante një ditar shumë të bukur, ku shënonte mbresat e ditës, përshtypjet, ndonjë gjësim apo hidhërim të tij. E shikoja nga larg atë bllok të bukur shkruar me ngjyra ari dhe habitesha me durimin e vëllait, që shpesh më lexonte pjesë duke më porositur se një gjë të tillë duhet ta bëja edhe vetë. Mbajtja e ditarit më dukej koha më e humbur e ditës dhe nuk ia hidhja asnjëherë sytë.

Këtë e kishte kuptuar me kohë Gjergji, prandaj s'mundohej ta fshihte ditarin. Bloku i praruar dergjej i shtrirë në sirtarin e komodinës natë dhe ditë.

Më ishte mbushur mendja top se në këtë ditar Gjergji duhet të kishte shkruar dhe diçka për ekspeditën. Meqë im vëlla më

ishte latur ta lexoja dhe tē mēsoja prej tij, unē tani do ta bēja me kēnaqësi. Leximin do ta kryeja sē bashku me Petin, që m'u lut shumë. E porosita tē vinte me çantën mbushur, t'i shpjegoja me durim gjyshes se ndihma ishte një metodë që s'do tē harrohej asnjëherë, pastaj tē hynte fishek nē dhomën time. Kështu do tē vrissja me një gur dy zogj, gjyshja do tē na linte tē qetë dhe do tē kujtonte që unë isha nxënësi mē i mirë i klasës.

Kuptohet që Peti i zbatoi pikë pér pikë udhëzimet, veç thartoi pak turinjtë kur gjyshja i kujtoi përfundimet nē gjuhë. E kisha bërë këtë gafë. Pér tē mbuluar ndonjë notë tē dobët, kujtoja nē shtëpi përfundimet e Petit. Më vriste pakëz ndërgjegjja, po qetësohesha kur mendoja se Peti hakmerrej me kumbullat që lëshonte pështë e lart pér gjoja dobësitë e mia nē trimëritë e tij.

Përpara kisha ditarin.

— Ky éshtë? — pyeti ai, që harroi menjëherë «tradhtinë» time.

— Veç duhet tē kemi kujdes!... Porsa tē dëgjojmë sinjalin e derës, blloku duhet tē ndodhet nē komodinë.

Peti s'paraqiti asnjë kundërshtim. Nuk do t'i kishte zgurdulluar më shumë sytë nga habia një njeri i lashtë përpara anijes kozmike, sesa ai para këtij blloku. Këto çaste

autoriteti im ishte i padiskutueshëm. Shoku më shikonte me një respekt të veçantë dhe mezi priste të filloja leximin.

Im vëlla shkruante bukur. Shkronjat merrnin udhë të shtrënguara si ushtarë të bindur. Aty-këtu dallosheshin nënvizime të kujdeshme. Fillova të lexoja me një zë të dridhur por të qartë:

E mërkurë, 20 maj,

Kam gjithë paraden që mendoj për konkursin shkencor. Në dy konkurset e para kemi humbur. Grupi i shkollës «Pavarësia» as kësaj here s'do të rrrijë duarkryq. Gjergji ka mendimin të ndërtojë një vinç automatik. Ideja e tij s'është e keqe, po përrapa telendërlidhësit që do të ndërtojë grupi tjetër humbjen do ta kemi të sigurt...

E Enjte, 21 Maj,

E përpiva me një frysë librën «Pesë javë në balonë»... Sa njerëz të guximshëm!... Libri i vjetër më ngjalli emocione të shumta. Përse të mos ndërtojmë edhe ne një balonë?... Urra!... Më duket se e gjeta atë çka kërkonim... Shokët më panë me habi, por kur u bindën se balona jone do të ishte plotësisht e automatizuar, më mbytën me përqafime. Bledi më quajti «gjeni», kurse Donika «kapiten të mendimeve». Tani

që po shkruaj këto radhë librin e zverdhur
nga koha e kam pranë.

Shënim: Po sot,

Fatmiri u tregua edhe më largpamës, propozoi që ndërtimin e balonës ta mbajmë në fshehtësi dhe fluturimin ta bëjmë pëpritmas. Nuk e ka keq Fatmiri; e papritura është gjithmonë e bukur. Sytë po më mbyllen nga lodhja, gjithë pasditen e kaluam me diskutime dhe plane. Dita e sotme kaloi për bukuri. Qeshëm edhe pak me Petin, shok i vëllait tim të vogël. Skerdi, sa herë që shoku i tij thotë ndonjë...

Ndërpreva leximin për të kaluar më poshtë. Sytë e Petit më kërkonin mëshirë dhe unë, që isha burrë, kalova trimërisht më poshtë.

E premte, 22 Maj,

Drejtuesi ynë shkencor, profesor Bardhyli, e miratoi me entuziazëm planin tonë. Na porositi të studiojmë ligjet aeronautike dhe gjithçka që ka të bëjë me fluturime në ajër.

Bukur deri këtu, megjithatë duhet të tregohem më i vëmendshëm. Pusullën e takimit me shokët e kam humbur. Kontrollova gjithë librat e fletoret, por asnjë gjurmë të saj. Kemi vendosur që asnjë të mos marrë vesh për punën tonë.

E shtunë, 25 Maj,

Shiu i rrëmbyer pranveror nuk na latë takoheshim te vendi, por shumë punë i kryem. Jemi të mendimit që balona të mbushet me helium.

Orientimin uljen dhe ngritjen do t'i organizojë një ordinator i posacëm, ose komandues elektronik. Vetëm Institutit Aeronaute mund të na ndihmojë në këtë rast.

E Diel, 24 Maj,

Jam si në ethe. Dhe jo vetëm unë. Nësër do të marrim përgjigjen e institutit. Shokët atje u habitën, madje na përgëzuan përgjuximin tonë. Drejtori, një njeri i ngrysur në pamje, tha: «Jam i bindur se do t'ia dilni mbanë, fëmijët e mi. Sot, në shekullin e anijeve kozmike, fluturimi juaj me një ballonë nuk është romantizëm, por një eksperiment.

Skerdi duket i trishtuar sot. Pa i thënë gjë atij pyeta në shkollë. Cudi, s'ka marrë asnjë notë të keqe. Megjithëse e nqacmoj vëllanë e voaël, jam i bindur se do të bëhet dicka. Ka një kureshtje të cuditshme. Nuk i them asgjë në sy, por kam bindjen se ai kupton shumë gjëra.

E Hënë, 25 Maj,

Këtë datë e nënvizova. Çdo gjë flet për ne, Përgjigjen e morëm siç dëshironim. In-

stituti do të na ndihmojë me të gjitha pajisjet e nevojshme, përveç atyre që do të përgatitim vetë. Fluturimi është yni dhe do të dëshironim që shumë pajisje t'i prodhonim me duart tonë.

Hartuam listën e pajisjeve të balonës. Një lagështimatës, një barometër, një erëmatës, hartën aéronautike, katapultën e rasteve të vecanta. Këto pajisje të thjeshta s'na kushtonin kohë. Ndryshonte puna me komanduesin elektronik, ndërlidhësin pamor dhe kompjuterin. Bledi u kujtua edhe për robotin Sém. Nuk e ka keq! Do ta marrim edhe atë.

Më duhet t'i mbaroj shpejt këto shënimë. Televizioni do të transmetojë një lidhje më Marsin. Të gjithë duam ta shikojmë.

E Martë, 26 Maj,

Skema e balonës u pëlqeu të gjithëve. Cdo gjë flet për një fluturim të jashtëzakonshëm. Punuam shumë në laboratorin e shkollës dhe pajisjet janë gati.

Ende s'është vendosur kush do të fluturojë.

E mërkurë, 27 Maj,

Më është prerë fare oreksi. Kot nuk thonë që gjëzimi të ngop më shumë se buka. Do të fluturojmë vetëm. Unë, Bledi, Fatmiri dhe Donika.

Balona jonë luhatet midis balonave të tjera të Institutit Aeronautik, plotësisht e gatshme. I kemi vënë numrin pesë.

Çfarë të shkruaj më, nuk më punon dora. Mezi pres mëngjesin ta vizitoj.

E Enjte, 28 Maj,

E bëmë së fundi dhe provën, Balona fryhet për mrekulli. Kërcyem brenda borreve duke i zbavitur mjaft specialistët e institutit. Çdo gjë brenda koshit shkëlqen, kabinet, ordinatori, katapulta e rasteve të iashtëzakonshme, pa îsjet tona. Të gjitha. Inxhinierët futyrëqeshur na treguan një për një komandimin.

Aerostati ynë ngjyrëvjollcë pret ditën e fluturimit. Këtë ngjyrë e kemi zgjidhur që të dallohet...

Shënim: Për itinerarin e fluturimit ka diskutime. Unë jam i mendimit të fluturojmë mbi det...

Bledit iu mbush mendja për lojën me kureshtarët. Lëre ç'do të vejë...

E Premte, 29 Maj,

Më zgjodhën njëzëri kapiten. Është titull nderi dhe përgjegjësie. Do ta justifikoj me punë... Deri në praktikën shkencore ngelen edhe pesë ditë. Pesë ditë me dridhma dhe emocion. Kushedi si do ta presë Skerdi këtë ngjarje. Çmendet për udhëtime të tilla.

Këtu shënimet mbaroni... I hodha një shikim të hutuar Petit, që s'guxonte të nxirrte zë. Pesë ditë dhe gjithçka do të merrte fund. S'do të mundnim as ta shikoni nga afër, pale të fluturonim.

— T'u themi njëherë! — belbëzoi fjalët e zakonshme Peti.

— Mendon se do të na marrin? — tunda kokën me dëshpërim. — Kushedi sa kanë luftuar që t'i lejojnë dhe ata vetë. Pastaj, s'i besoj Gjergjit. Prite kur t'ju thonë se me ju do të vijë dhe një aeronaut me përvojë...

— Si të bëjmë? — ngashëreu.

Atë çast s'po më vinte asnjë mendim. Ku të linin të hyie në institut... Aty kishte dhjetëra balona e planerë të ndryshëm:

— Sa ta shikojmë. — thoshte Peti.

Nuk më kishte marrë malli të shikoja planerë apo balona. Isha ngopur së pari filma të vjetër me ta. Dëshiroja të fluturoja riëherë, pa le të bëhej nami. Të tjerët shkojnë në Hënë, ne nuk mund të ngriheshim jart në ajër. Me aeroplan kisha flutuar disa herë, ndryshtë ishte aerostati.

Mendimi i Petit ishte i mrekullueshëm. E pranoj, disa herë mprehtësia e tij më mahnit, në këto çaste prania e tij më jepte krahë... kërkova që askush të mos mendonte keq për të. Shoku im meritonte lëv-data të rralla dhe më vinte keq përfundata

dimet e tij. Sa keq që nuk regjistroheshin edhe këto mendime në fletoren elektronike... Nuk kisha dyshim që mësuesi i gjuhës do të ndryshonte dhe në dëftesën e Petit do të shkëlqente përfundimi i merituar.

— Skerdi, — më shkundi shoku, — nuk është koha për ëndërrime.

— Të shfletojmë disa libra... Gjergjit nga një libër i lindi ideja.

— Ashtu do të bëjmë, — vendosa pa e zgjatur.

Peti më ndihmonte të zgjidhja librat më të vjetër të bibliotekës.

— Ta shikojmë këtë?

— Flet për mbarështrimin e lopëve...

— Pëh... S'është gjë..

— E kupton që duhen libra fantastiko-shkencorë??!

— E kuptoj...

— Atëherë zgjidhi mirë, të shkretën!

Djersa na doli mbi këmishë por asgjë s'po gjenim. Dëshpërimi gati na i shteroi forcat, kur papritur Peti më tha:

— Gjeta një libër me anije.

E shfletova ngadalë librin. Aty-këtu më kaluan skica anijesh në furtunë, ishuj të shkretë, gjurmë indianësh... Libri u përplas në togun e librave të tjerë.

Ballin e djersitur e mbështeta në rimeson e lustruar i bindur se dështimin e kisha shokun më të afërt. Peti diç rrëmonte...

— Skerdi... shiko ç'thotë këtu! — më goditi me bërryl.

— Ç'thotë? — pyeta pa qejf.

— «Alfonsi vendosi të hipë në anije Kapiteni asnjëherë s'do ta pranonte në këtë udhëtim të largët e me rreziqe. Kishte ditë që vëzhgonte ngarkimin e anijes dhe men-doi të hipte në të duke u fshehur. Pas nis-jes dhe daljes në det të hapur kapiteni do detyrohej të merrte...»

— Të hipim dhe ne në balonë?

Duart më dridheshin nga dy ndjenja të kundërta edhe pse ishte një zgjidhje e mrekullueshme, por edhe pse këtë e kishte gjetur Peti. Pikët që fitoi në këtë rast ishin të mëdha.

— Të fshihemi në të dhe kur ata t'ngrihen... — ngazëllente Peti.

— Do të na marrin, s'kanë ç'bëjnë, — i rashë ballit.

Pra shpresat s'i kishim prerë. Tani do të mendonim më shumë si të hipnim disa orë para fluturimit në koshin e balonës, të rrnim atje pa u ndier, derisa të ngrihej në ajër, pastaj t'u kërkonim të na merrnin në fluturim.

— Datën e nisjes do ta marrim vesh, — tregoi ditarin Peti.

— Si do të hipim pa!?

— Këtë mendoj edhe unë... Ç'thotë libri?

— «Djaloshi u fut në një arkë dhe qëndroi atje gati një ditë e një natë... Tallazet e detit luhatnin si një djep gjigant anjen e së bashku me të edhe arkën. Ndiente uri, të ftohtë, i përzihej, po vullneti dhe dëshira për të lundruar bënë të pamundurën. Anija doli në det të hapur pas disa orëve. Kishte fituar. Tani asnjeri nuk mund ta kthente nga rruga e nisur...», — vazhdoi leximin Peti, por, pasi pa që unë ëndërrroja, e ndërpreu. — Të lexoj ende?!

— Është e kotë. Balona s'është anije.

— Pse?! Po të ketë arka, ne mund të futemi në to disa orë para dhe kur të ngrohet balona...

— Si s'e kuption, xhanëm, që s'është problemi atje. Në radhë të parë na duhet të gjejmë kush është balona jonë...

Fjalën «jonë» e thashë me një theks të fortë. Tashmë ishim të bindur që fluturimi ishte çështje ditësh dhe ne do të ishim pjesëtarë të ekipazhit.

— Do ta gjejmë, — vazhdoi i vendosur Peti. — Ajo ka ngjyrë vjollcë. Dhe numëron pesë! Si më kishte shpëtuar ngjyra e balonës? Po numri? Aftësia e shokut sot ishte për t'u lavdëruar, ndërsa unë isha tepër i hutuar.

— Mirë e ke. Nga ngjyra do ta dallojmë dhe numrin të madh do ta kenë bërë,

— thashë si për një gjë që më kishte shkuar ndër mend edhe vetë. — Të nisemi!

Mbylla ditarin me kujdes, e vendosa në vendin e mëparshëm dhe i thashë Petit:

— Vetëm me një kusht: nesër do të rregullosh notën në gjuhë.

Shoku më pa me dhimbje. Kjo sakrificë, do t'i kushtonte shtrenjtë. Vetëm gjuhën të mos i përmendnin. Ajo turmë rregullash, pikash e presjesh gjithmonë e ngatërronte keqas. Ne shpesh e thërritnim Petin pikëçuditëse. Këtë nofkë fyese ia përmendnim rrallë, megjithatë, kur dikush e thërriste kështu, ai skuqej si lafshë gjeli dhe belbëzonte nga inati.

— Patjetër që do ta rregulloj, — tha me gjysmë zëri.

— Jo për gjë, — kërkova të shfajësohesha, — nxënësit e dobët nuk e meritojnë të jenë pjesëtarë ekspedite.

— Unë vetëm gjuhën kam dobët, — kundërshtoi Peti.

— Në shkencë nuk duhet vetëm elektronika dhe matematika. Pa mendo të gjen-desh nesër në një planet të qytetëuar dhe të dëgjojnë gjuhën tënde. Ç'do të mendojnë?

Kjo gjë s'i kishte shkuar fare ndër mend Petit. Më pa me habi nga koka në këmbë, por s'më kundërshtoi. Kishte dëgjuar se eksploratorët dhe shkencëtarët ishin

njerëz me kulturë të gjerë. Mund të ishte i vetmi që e kishte gjuhën dobët.

— Vendosa ta rregulloj, sikur qielli me tokën të bashkohen! — tha Peti me zë të lartë.

— Më ngadalë! Gjyshja do të kujtojë se grindemi, — ia ndala hovin. Fjalët e tij m'u dukën serioze dhe isha i kënaqur që sadopak kisha ndihmuar edhe unë në mbarëvajtjen e mësimeve. Ky lloj patronazhi po jepte fryte të këndshme.

Të nesërmen çdo gjë na u përbys nga disa pengesa të paparashikuara. E para, klasa jonë do të vizitonte centralin elektrik me dallgë dhe e dyta, Petit i duhej të përcillte motrën për në stacionin e rritjes së algave, ku do të kryente praktikën.

— Nuk mund ta përcjellë njeri tjetër motrën?! — i kërkova me ngulm shokut.

Peti numëronte me sy autobusët elektrikë që rrëshqitnin butë në asfaltin e zi pa lëshuar asnje zhurmë. Herë-herë dëgjohej një tingëllimë e lehtë zileje kur ndalonin para kalimtarëve. Këta autobusë komando-heshin automatikisht sa herë që hasnin në njerëz. Madje nuk kishin as fatorino. Kush-

do hipte e zbriste në vendin ku dëshiron te pa as më të voglën vështirësi.

— Babai ka shkuar në kombinatin e kompjuterave në Shkodër. Kush ta përcjellë tjetër? I premtova, — tha pas pak Peti, që provonte dy ndjenja të kundërta. Dëshiron te edhe të shikonte balonën, por edhe të përcillte motrën, që e donte aq shumë.

— E po kjo është të lësh shokun në baltë, ta dish! — thashë i zemëruar. S'e kisha inatin me të. Kush nuk donte të shikon te centralin me dallgë. Pastaj mungesa do të binte në sy. Vetëm pesë ditë kishin nge-lur, të shkretën. Të mërkurën Gjergji me shokë fluturonin si shqiponja. Atë çast m'u duk vetja një breshkë e mjerë, që zvarritej, kurse Peti, një gur i rëndë në kurrizin tim prej kocke.

— Nuk kemi si veprojmë ndryshe, — filozofonte ai, — shkojmë nesër.

— Nesër? Të gjitha nesër?!

— Përse nuk vjen dhe ti me mua të vizitojmë stacionin e rritjes së algave?

Pa prit. Ky mendim i Petit nuk ishte pa gjë fare. Për katër ditë njerëzit mund të bënin çudira. Atje ku rriteshin algat duhej të ishte shumë bukur. Ah, ky Peti, ah, ky Peti, që përherë më zbuste me atë zemërgjetësinë e tij!

— U pa puna! — pshërëtiva sikur më kërkonte t'i dhuroja diellin. — Do të vij.

Por më parë të nxitojmë. Shokët duhet të jenë mbledhur.

Në oborrin e shkollës shkëlqente që larg një helikopter. Rrotull tij turma e gëzuar e nxënësve cicërinte si një trumbë zogjsh në pranverë.

— Me këtë do të shkojmë? — pyeti Peti pa treguar ndonjë interes të dukshëm.

Beni e pa nga koka në këmbë, por i hoqi sytë i tmerruar, qetësia e Petit të kallte datën. Ç'kishte ndodhur vallë? Në shkollë po zbriste një helikopter i vërtetë, nga ata më të fundit, dhe mezi prisnin të hipnin, kurse Peti nuk tregonte as më të voglin interesim. Sigurisht që ai do të kishte diçka më interesante.

Këto mendime unë i thitha si makarona të freskëta. Ç'do të ndodhte po qe se ata merrnin vesh përgatitjet tona për fluturim? Të gjithë do të kërkonin të mos u shpëtonë një rast i tillë. Atëherë lamtumirë, fluturim me balonë, lamtumirë, pamje të mrekuillueshme në qiellin e hapët!

— Sa helikopter i bukur! Do të jetë një udhëtim i paharruar, — ndërhyra duke përkëdhelur pjesët metalike sikur të kisha përpëra një send të rrallë.

— E morët vesh?! — tha Adriani, që me urtësinë e vet nuk dallohej po të mos fliste. — Helikopterin do ta ngasë vetë mësuesi i fizikës.

— E ç'ka këtu pér t'u çuditur? — ia ktheu Peti. — Helikopteri pér një javë mësohet.

— Si u mësoka pér një javë, — tha Beni. — Vetë t'u desh një muaj të drejtoje automjetin e shkollës.

Sigurisht Peti do të ngulte këmbë në të vetën, por ardhja e mësuesit i ndërpreu diskutimet.

Në kabinën e helikopterit hipëm me gëzim të madh. Pér fat të mirë Petin nuk e kisha afër. Isha ngopur me zmadhimet e tij dhe dëshiroja ta vrojtoja peizazhin i qetë.

Zukatja e lehtë e motorit mbytej nga bisedat plot zjarr.

— Shikoni! Shikoni si duket Tirana!

— Ç'të jetë ai tym atje?

— Si?! Nuk e dallon Kombinatin e Konpjuterave?

— Përse bërtitni? Së shpejti do të duket edhe deti.

— Ja, ja, unë po e shikoj...

— Pse flet kot, mëre Peti? Ai është brez kodrash.

— E megjithatë unë e shikoj...

Po të fliste kështu majë balonës, e kishte hak ta hidhnin që nga bortet, mendoja unë. Duhet ta kuptonte së fundi që ne kishim një mision shumë më të rëndësishëm përpara dhe nuk ia vlente të bëje si vogëlush pér një pamje nga helikopteri.

Deti me gjithë madhështinë e vet u shfaq pas disa minutash. Mësuesi hapi ekranin e pamjeve të afërta dhe filloi të na tregonte me radhë naftën xjerrësit dhe objektet e mëdha ngritur në mes të tij.

Centrali elektrik me dallgë u shfaq pasi kaluam një kodër bregdetare. Ishte me të vërtetë një objekt i bukur. Që lart dukej si një përmendore e bardhë me këmbët zhytur në det. Një gojëzë gjigante thithë si një kuçedër dallgëzimin e bardhë, kurse më tej një ndërtësë kthente energjinë e forcës së dallgëve në energji elektrike. Mësuesi shpjegoonte ngadalë që të kuptionin të gjithë çfarë shikonin që lart.

Të them të drejtën nga kjo vizitë ngela shumë i kënaqur. Për disa orë s'më shkoi mendja fare te balona. E njëjta gjë i ndodhi edhe Petit, aq sa harroi që pasdite duhej të përcillte motrën. Veç unë, si vigjilent që isha, ia kujtoja rrugës, kur ktheheteshim.

— Prandaj po vijmë dhe ne, — thashë më shumë pér t'i treguar se nuk ishim dosido por amatorë të shkencës.

— Skerdi është nga nxënësit më të mirë të klasës. I ka shumë qejf shkencat e natyrës, pale eksperimentet... — më hoqi lëvdatë Peti.

— Po, më ka thënë edhe Gjergji pér ty. Pse ta fsheh, m'u më qejfi. Gjatë rrugës i tregova Enkelejdës lloj-lloj historish ku

protagonistë ishim unë dhe Peti. E shkela aq shumë në teprime, sa ishte hera e parë që shoku im ngeli gojëhapur. Më vonë këtë ditë do ta rrrethoja me një shirit turpi. Njeriu s'duhet të trillojë asnjëherë.

— Përse mërzitesh, — mundohej të më ngushëllonte Peti. — Pak trillime ka në librat fantastiko-shkencorë?

5

Nga ditari i Gjergjit mësuam se balona ishte gati për fluturim. Pritej vetëm koha e përshtatshme, pra kushte të caktuara atmosferike, që udhëtimi të mos kishte shumë pungesa.

Këtë gjë Peti e quajti mungesë burrerie, kurse unë një tektikë për të fluturuar krejt papritur... Natyrisht vendosëm të mos qëndronim duarkryq. Në radhë të parë balona duhej parë nga brenda. Si ishte ndërtuar, ku mund të fshiheshim, si do të mësonim orën e ngritjes dhe hollësitë e tjera më të domosdoshme. Kuptohet që ditën me diell kjo punë s'mund të bëhej, prandaj, pasi u menduam gjatë, vendosëm të zgjidhnim një mbrëmje të kthjellët. Një mjegull e dendur ishte mbërthyer në luginën ku shtrihej zona

industriale e qytetit dhe territori i Institutit Aeronautik. Ndriçimet e llambave atomike çanin bulëzat e imta ujore si fishekzjarrë në një natë shiu.

Fusha ku ndodheshin aerostatet shtrihej jo larg ndërtesës dhjetëkatëshe të institutit. Prej andej dëgjohej një zhurmë e habitshme, sikur të gjitha kafshët e pyllit të ishin mbledhur në kuvend. Britma, fishkëllima, goditje e lloj-lloj sinjalesh përhapesha e vinin deri te ne të pakapshme ose më saktë të pakuptueshme.

Peti ishte strukur poshtë gardhit plastik. Në dorë shtrëngonte projektorin e vogël e në të njëjtën kohë kërkonte të shquante në grumbullin e balonave të shumta atë ngjyrëvjollcë.

— Po sikur të ketë njerëz?

— S'më besohet... Gjergji me shokë përgatiten në laboratorin e shkollës. Ti i pe me sytë e tu.

— I pashë, nuk them, por mund të ketë njerëz të tjerë, — nguli këmbë Peti më shumë për të më nxitur t'i afroheshim sheshit.

Befas nga kulla më e lartë e ndërtesës u shkëput një sondë ajrore e pasuar nga dy aerostatë.

I shoqëruam me sy derisa humbën në gjysmerrësirën që dalëngadalë do të na ndihmonte t'i bënim një vizitë balonës aq shumë të ëndërruar.

— Mos bëjmë gabim gjë? — vazhdoi të fliste Peti.

— Gabim?!... Ne vetëm sa do ta shikojmë balonën nga brenda.

— Mirë e ke. Kushedi sa bukur do të jetë brenda!

— Pale në fluturim...

— Shëeët! Kalojnë njerëz.

Perbri rrëshqitën dhe gati sa nuk na panë dy punonjës të institutit që bisedonin e qeshnin me zë të lartë. Shpejt hapat e tyre nuk u ndien më dhe ne morëm frymë të lehtësuar.

Befas preka pa dashje gardhin plastik. Një ndriçim i fortë dritëroi gjithçka.

— Të ikim, — thërriste Peti.

Ashtu bëmë. Pas pak, ashtu të kapitur nga vrapi i gjatë, u fshehëm në errësirë.

Rreth gardhit plastik brezi i dritës nuk vazhdoi gjatë. Si duket kompjuterat nuk dilluan asgjë për t'u shqetësuar.

— Si nuk na panë?! Mua s'më besohet,

— tha Peti. Edhe vetë nuk ndihesha i sigurt... Megjithatë jo larg nesh njëra nga derikat e gardhit ndodhej e hapur.

— Pa shiko, — i rashë me bërryl shokut.

— E paskan harruar! — kaloi pështymen Peti.

U nisa i pari. Pas më ndiqte edhe Peti. Asnjë zhurmë, asnjë sinjal. Kjo ishte

me të vërtetë pér t'u çuditur. Tanimë ecnim në brendësi të sheshit, duke përfituar nga mjegulla e dendur që tashmë kishte pérhumbur gjithçka. Lagështia e piklave të ujit dallohej më qartë në pushin e fajeve. Kushdo në këto çaste do të na kishte marrë pér çirakë mullisësh. Kuptohet që ne gjithë vëmendjen e kishim te radha e aerostatëve. Midis tyre shpejt dalluam dhe atë që kërkonim. Peti fërshëlleu lehtë pér të më lajmëruar.

— E shikoj, — thashë i përbajtur, por pa e fshehur gjëzimin.

Përsëri nga rreshti i balonave u shkëput njëri prej tyre.

— Edhe natën bëjnë studime? — pyeti Peti.

— Përderisa ngrihen,

— Të ketë njerëz brenda?

— Sa i paduruar je! Prit njëherë të shohim!

Afër balonave s'kishte njerëz. Zhurma e lehtë e ferkimit të pajisjeve me kacekët e fryrë sikur prishte atë monotonji që krijon vendosja në një radhë e mjeteve fluturuese. Për një çast nguruam të hipnim në kosh. Na dukej se gjithçka rrëth e rrotull qortonte pér këtë veprim. Litarët që trokëllinin, paftat ngjyrë argjendi që u buzëqeshnin me ndriçime të befta projektorëve të institutit, qetë-

sia e rrugicave shtruar me beton të lustruar, sikur na e shtonin freskinë e mbrëmjes.

Në të tilla raste shpesh bëhem pakëzëndërimtar, po shpejt më kalon. Puna ime ishte parë me kohë, kisha lindur t'u shkaktoja gjithmonë andralla të mëdhenjve! Këtë arsyetim, që shpesh më nxiste të bëja prapësira, mund ta kishte në të njëjtën kohë edhe Peti.

Iu afrova koshit. Në qafë ndieja frymën e ngrohtë të shokut që s'më ndahej. Deriçkën e hapa pa ndonjë vështirësi. Të ishte harruar padashur hapur? Nejse, tashmë ishim të dy në aerostat dhe dridheshim nga kureshtja. Ndodhej vetëm njëzet centimetra i ngritur nga toka, mbajtur në këmbalecë të bukur metalikë nëpërmjet dy pllakëzave. Çudi si qëndronte balona e palidhur vetëm mbështetur në dy pllakëza të vogla!

Ndërkohë që Peti mundohej ta kuptonte këtë enigmë duke shqyer sytë, nën kosh kisha filluar të shquaja në gjysmerrësirë shumë hollësi interesante. Parmakët ishin ndërtuar me një material të fortë por edhe tepër elastik njëkohësisht. Po të mbështete-she në ta ktheheshe me forcë brenda koshit i paralajmëruar për rrezikun. Në vendin ku lidheshin shkallët me dyshemenë pashë dy llambushka nëpër qoshe që u ndezën porsa vumë këmbët. Shtroja mbulohej nga një

qilim i butë artificial që të kujtonte një lëndinë me bar të porsaçelur.

— Ku mund të jetë motori? — dhe drejtoi projektorin e vogël Peti.

— Në goftë se ke ardhur të thuash budallallëqe, më mirë kthehu, — ia prita pa një pa dy. Ti, mor vëlla, sikur jeton në shekullin e njëzetë! Gjithçka këtu komandohet në mënyrë elektronike. Nuk e shikon ordinatorin?!

Përbri tri derickave, që me sa duket ndanin tri mjedise, pamë një kompjutër të mrekullueshëm mbushur me butona, mikrokamera e sy të ndryshëm magjikë. Peti hapi njérën prej tyre dhe më ftoi të hynim pa bërë zë. Vendi ishte i ngushtë por ngjasonte çuditërisht me një kabinë motoskafi. Në mes dy tryeza të vogla pune, katër stola të mbyllshëm plastikë dhe në një kënd gjithçka që i duhej një ekspedite aeronautike: barometër, shimatës, erëmatës, sondë ajrore, aparatura për matjen e temperaturës së ajrit në lartësi të ndryshme, aerofotografë e tjera.

— C'mund të jenë këto?!

Peti tregonte gjashtë kostume vendosur në radhë. Nuk ndryshonin shumë nga kostumet e zhytësve, përveç maskës.

Lëmova me dorë njërin prej tyre dhe papritur dallova një shënim sqarues: Kostum Ajror, masa 42, lartësia mbi 2000 metra.

— Këto vishen në lartësi të mëdha, — i thashë Petit.

Veçse ai, si një urith i vërtetë, kaloi në kabinën tjetër të koshit.

Ndriçuar prej një llambe atomike që lëshonte një dritë qumështore kjo kabinë s'kishte asgjë të veçantë përveç shtretërve. Derën tjetër, me gjithëse u munduam shumë, nuk e hapëm dot. Për këtë natyrisht na erdhi shumë keq, sepse pas asaj dericke mund të fshihej diçka misterioze, por nuk kishim ç'të bënim.

— Merre me mend si do duket që lart në fluturim! — i thashë shokut duke pshëretirë.

— Edhe e diskuton! Gjergji me shokë kanë bërë një punë të shkëlqyer! Jam i bindur që do ta fitojnë konkursin e shkolave.

— Aq më bën për konkursin! — shfryva sikur të ma kishte fajin Peti. Për mua një fluturim me këtë balonë të mrekullueshme viente më shumë. Mund të kapje retë me dorë. Rreth e rrotull fluturojnë zogj, aeroplanë, planerë, dielli shkëlqen më fort, ajri bëhet më i rrallë...

Peti qesh më hutimin tim.

— Përse qesh? — u nxeha fare kot. — Kujton se jemi në rrugë?! S'është mirë të na gjejnë këtu.

— Po pse? Ne vetëm për të parë...

Kaluam përsëri pranë borteve. Ordinatori me morinë e butonave më tërheq si magnet. Besoj se e keni parë macen përpëra akuariumit, pikërisht kështu rrija para aparaturës. Sipër një butoni shkruhej: Porta e hyrjes. Dora u avit si pakuptuar dhe butoni ishte shtypur. Befas deriçka e koshit u mbyll menjëherë, ndërsa llambushkat ndërruan ngjyrë.

— Eh, — qeshi përsëri Peti, — gjithçka automatike!

Ende s'e kisha marrë veten nga e parritura, kur shoku e kishte bërë të madhen. Pa u thëlluar shtypi një buton që dallohej nga të tjerët. Në ekranin e ordinatorit tashmë dallohej fjala Nisja dhe një sinjal i mprehtë ushtonte herë pas here.

— Ç'na bëre, more Peti! Balona po ngrihet në ajër, — klitha unë.

— Ku ta dija, — u mblođh sa një grusht ai.

Menjëherë rendëm pranë borteve përtë parë poshtë. Diku hë të majtë shkrepthinin dritat e institutit, që shpejt ú fikën si të ishin fshirë nga një dorë gjigante.

Rnim si guhakë para komanduesit. Piklat e vogla të ujit na hynin në qafë, në shpinë, në faqe përtë na shtuar edhe më shumë dridhmat e së papriturës.

— Të kërkojmë butonin e uljes, — tregoi aparatin e komandimit Peti.

— Ku të ulemi!? Në çatitë e shtëpive?

— Kemi bërë gabim të rëndë, — vari kokën Peti. — Të gjitha fajet i kam unë...

Më erdhi shumë keq për të. Përse ta mbante gjithë barrën mbi vete? Bashkë kishim hipur. Ç'rëndësi kishte se ai kishte shtypur butonin e ngritjes, kjo gjë mund t'i ndodhët kujtdo.

— Dëgjo, Peti, s'duhet të dëshpërohem. Kujto mësimet që kemi bërë për fluturimet ajrore. Fundja jemi si dy marinare në mes të detit.

Sigurisht më dukej vetja kapiten i shquar në këto caste. Gabime mund të bëja me okë, po frikacak nuk isha.

— Unë s'kam frikë! — u shkund si të ishte përmendur nga një ëndërr e ligë vrasesi i oktapodit gjigant.

— Shpejt mund të shpërndahet mje-gulla dhe ne do të kemi pamje më të qartë.

— Balona ngjitet vazhdimesh...

Në njérën prej kamerave të komanduesit lexuam shifrën gjashtëqind. Pra futuronim në gjashtëqind metra lartësi, po në ç'drejtim, majtas apo djathtas, sa larg institutit kishim shkuar, s'e kuptionim. Gjatë kësaj kohe më tërhoqi vëmëndjen një buton me mbishkrimin — Ndal! Vendosa ta shtypja, pa të dilte ku të dilte.

— Nuk po ngjitemi më, — thërriste i gëzuar Peti.

Fshiva ballin e djersitur. Në fushën e ndriçuar, treguesi shënonte vetëm shtatë-qind metra lartësi. Më shumë më vriste ndërgjegjja që i kisha prishur punë tim vëllai. Ata prisnin me padurim të fluturonin, kurse ne miqtë e paftuar ua kishim rrëmbyer lavdinë.

— Përse mendohesh?

— Asgjë...

— Sikur të nà përplasë era në ndonjë mal?!

E kuptoja luftën që zhvillohej në shpirtin e Petit, por s'kisha si ta ndihmoja. Për vete nuk më vinte keq aspak.

— S'e shikon që po qëndrojmë në vend? — i dhashë zemër.

— Nuk më besohet... Shiko ordinatin.

Për fat të keq shoku kishte të drejtë. Aty për aty lëshova nga bortet një copë letër që menjëherë devijoi duke fluturuar nga e djathta. Me sa dukej aerostati s'qëndronte në vend. Ngjitja kishte pushuar, por ecte me shpejtësi në një drejtim që s'e përcaktonim dot.

Kaloi gjysmë ore plot ankth. Gjatë kësaj kohe ne vetëm shikonim rreth e rrötull, shkëmbenim biseda të shkurtra pa ditur si të vepronim. Për fat të mirë mjegulla vendevende po shpërndahet dhe patëm mundësi të dallonim grumbuj dritash si xixëllonja,

ndonjë projektor planeri, por më pas asnë gjurmë jete. Aerostati lundronte mes një errësire të frikshme.

Ora e balonës tregoi tetë. Në shtëpi do të bëheshin merak. Në qoftë se Qendra Aeronauteke s'do ta kishte pikasur ngritjen e balonës, sigurisht që do ta kishim pisk. Vëtëm kjo shpresë na ngrohte ende.

Peti kërkoi të shtypte gjithë butonat me radhë për të provuar komandimin, por një sinjal i mprehtë alarmi s'e lejonte të bënte çap.

— Ç'të jetë kjo! — u çudit pikaloshi.

— Kjo do të thotë që s'duhen prekur.

— Eh? Të ishte ditë ndryshonte puna!

— Pshëretiu ai.

— Ja, zëre se janë nisur për të na kërkuar, — vazhdova unë t'i jepja zemër. — Shkojmë në kabinë mos gjejmë ndonjë hartë aeronauteke. Peti më pa me habi. Kishte hartë aeronauteke? Mund të hidheshin në hartë rrymat e ajrit apo erërat që fyrnin në të gjitha drejtimet? Këtë lexova në sytë e tij, por s'u tunda nga imja. Diçka kisha dëgjuar dhe lexuar për to dhe kërkova me këmbëngulje një zgjidhje.

Në kabinën e punës ishte shumë më ngrohtë se jashtë, ku ajri i lagësht e i ftohtë të hynte në hundë dhe në grykë, duke të djegur si alkool. Kërkuaam gjatë, përmbysem aparaturat, palosëm kolltukët, shtretërit dhe

si përfundim asgjë. U ulëm të rraskapitur e të dëshpëruar në fund të borteve. Flokët nă i gufone një fllad i lehtë por këmbëngulës. Aerostati fluturonte vazhdimisht për diku, në lartësinë shtatëqind metra mbi nivelin e detit.

Poshtë edhe mund të na shikonin, po kujt i shkontë ndër mend se kjo balonë ishte shkëputur krejt papritur nga Qendra Aeronauteike dhe aq më shumë që në koshin e saj ndodheshin dy fëmijë.

Shpesh afër kalonin planerë e helikopterë të ndryshëm. Provuan të jepnim shenja me shamitë, kapelat, flamujt që ndodheshin në kosh, por askush nuk kujtohej përne. Dikush na kthente përshëndetjen, dikush kalonte me një shpejtësi që s'të premtonte asgjë. Të gjithë i merrnin për shaka përpjekjet tonë të dëshpëruara! Madje një nga planerët na dërgoi një notë proteste kur Peti, si i marrë, bënte shenja me projektor. Si duket kishim prishur rregullat e fluturimit dhe mund të përplaseshim nga minuta në minutë. E kush e mendonte që në këtë shekull ky aerostat ecte fare kot, në kohën kur mjetet e ndërlidhjes, e të telendërlidhjes ishin kaq të fuqishme.

Peti s'mund të qëndronte gjatë në një vend. Me gjithë dëshpërimin e madh, që e kishte përfshirë arriti të zbulonte diçka të papritur;

— Shiko këtu! — dëgjova një klithmë.
Diku në një qoshe vezullonin dy sy të verdhë. Si nuk e kishim parë më përpara!

— Robot?!

— Ehë, — pohoi Peti pa iu afruar.

— Të kujtohet roboti Sem? — thashë unë, po fjalët më ngrinë në buzë. Roboti ktheu drejt nesh sytë vezullues dhe befas dëgjuam të fliste qartë, me pak ndërprerje:

Unë jam... Roboti Sem. Mirë se vini në aerostatin tonë!

Për një çast i harrova të gjitha. Peti shikonte me sytë e shqyer nga habia e frika herë mua e herë robotin. Nuk dinim si të vepronim.

— Bën ta prek? — pyeti pas kësaj hështjeje të rëndë shoku im.

— Ku ta di unë... — ngrita supet.

Roboti ishte gati shtatëdhjetë centimetra i gjatë, pakëz i rrumbullakët, me një kokë katërkëndëshe si të një milingone dhe dy duar të mrekullueshme mekanike. Në vend të këmbëve rrëshqiste mbi dy rruzuj që shkëlqenin si ar.

— Kështu nga pamja s'ta mbush syrin,
— vazhdoi Peti.

Ju lutem... Jo me ofendime! — vikati roboti.

Peti gati sa nuk u rrëzua përtokë... Edhe vetë isha tepër i habitur... Gati nuk po u besoja veshëve. Zëri më dukej si i njo-

hur... Asnjëherë nuk besonim për fantazma, po kësaj here ky robot me zërin e Gjergjit më la pa mend. Lëviza dy-tre metra për t'u freskuar. Duhej ta mblidhja veten. Si dukej e kisha mendjen te gabimi që kisha bërë dhe zëri i robotit më ngjante me atë të Gjergjit.

Vura gishtin në gojë që të kuptonte Peti se nuk duhej folur vend e pa vend. Mirë do të ishte ta pyesnim robotin se ç'duhet të bënim.

— Ku ndodhemi, Sem? — guxova e pyeta robotin si të ishte njeri i gjallë.

Mekanizmi elektronik nuk u përgjigj menjëherë. Në brendësi të tij diçka kërciti, pastaj lehtë-lehtë rrëshqiti dhe iu afrua aparaturovave. E ndoqëm pas si qengja të bindur. Peti ishte zverdhur në fytyrë dhe prekat në hundë dalloheshin hapur. Edhe vetë duhet të isha prishur në fytyrë, pasi shoku më vërente jo si zakonisht.

Gjashtëqind metra mbi nivel të detit. Gjashtëqind metra mbi nivel të detit. Dyzet gradë gjerësi veriore.

Sinjalizimet e robotit shoqëroheshin një-kohësisht me shkrime të shndritshme në ekranin e vendndodhësit.

Pra diçka ishte qartësuar; roboti dinte shumë gjëra për drejtimin e aerostatit.

— I mrekullueshëm! Apo jo, Peti? — lëmova pjesët metaliko-plastike të robotit.

— Ky robot është disa herë më i zoti nga ata që kemi ne në laboratorin e fizikës së zbatuar.

Gati kishim harruar gabimin që bëmë duke u ngjitur në balonë. Të udhëtoje në qiellin e errët, mes një freskie drithërues, ishte diçka e mrekullueshme.

— Sem, kërkojmë të udhëtojmë në lartësinë mbi një mijë metra, — kururisa dhe i dhashë një urdhër tjetër robotit për të parë sa ishte në gjendje ta drejtonte fluturimin.

Mekanizmi elektronik s'u përgjigj menjëherë. Dukej se truri i tij me qarqe të shumta diçka analizonte. Mos vallë i kishim bërë ndonjë kërkësë të tepërt?!

— Unë e di që jo çdo pyetjeje mund t'i përgjigjet po qe se s'është në program, — vërejti Peti.

Megjithatë durimi im u shpërblye. Roboti rrrotulloi kokën katërkëndëshe, fiku e ndezi tri-katër herë sytë e verdhë dhe tha me zërin metalik: *Vishni kostumet ajrore!* *Vishni kostumet ajrore!*

U pamë sy më sy. Si të vepronim? Po të na kishte parë njeri, sigurisht do të na merrte për tuhafë.

— C'të bëjmë?

Vishni kostumet ajrore! *Vishni kostumet ajrore!* përsëriste roboti pa u tundur nga e tija.

Ngadalë-ngadalë u avita i pari për te

kostumet e varura, kërkova masën që më përshtatej dhe u vesha. Peti i ndoqi veprimet e mia plot dyshim.

— Vërtet kërkon të ngjitemi lart?! —

— E pse? — zëri më dilte pakëz i shfornuar nga aparati i frymëmarrjes.

Pa ç'pa u vesh edhe Peti, të cilit mezi i rrinte kostumi, ashtu trupaktë si ishte. Tashmë dukeshim si kozmonautë të vërtetë.

Komando ordinatorin! Lartësia dy mijë e pesëqind metra... e dëgjuam pas pak robotin.

Ndiem një shkëputje të vogël. Edhe ato pak ndricime që shikonim aty-këtu u zhdukën mes mjegullës dhe reve. Duhet të ishim ngritur shumë lart, megjithëse fluturimi vazhdonte.

— Të merren gjë mendtë? — pyeti Peti.

— Hiç fare! — nuk thashë të vërteten. Maskat na mbronin fare mirë nga ndryshimet e presionit dhe rrallimi i ajrit. Lëviznim pranë borteve për të parë poshtë, por asgjë nuk dallonim. Qilimi stërmadh i reve, edhe pse ndriçohej nga projektorët e fuqishëm, ngjasonte me një det të porsaqetësuar.

— Kushedi sa do të jemi ngritur.

Në ekranin e vogël të lartësisë shkruhej shifra 2700 metra. Kaq lart? Merreni me mend sa do të habiteshin shokët kur ta merrnin vesh.

— Sikur të përplasemi, — vazhdoi hamendjet Peti.

Këto fjalë më bënë akull të gjithin. Shoku nuk e kishte keq. I ishim futur një bëme të rrezikshme, që mund të na kushtonte shtrenjtë. Disa gjëra edhe duroheshin, po që të ishim në duart e një roboti shtatëdhjetë centimetra të gjatë, ishte e rëndë.

Ndërkohë aerostati vazhdonte ngjitjen pa ndërprerje. Tashmë na kishte ikur fare dëshira për të fluturuar më gjatë. Kërkonim medoemos të ktheheshim në shtëpinë tonë. Me siguri që Petit i ishte mbledhur një lëmsh mallengjimi në fyt. Këtë e merrja me mend, pasi fjalët i dilnin të shkëputura e të mybatura.

— E ka fajin maska, — kërkoi të shfajësohej, kur pikasi mendimin tim.

— Mirë është të kthehem, apo jo, Peti?

— Kjo do të ishte më e mira. Po si?! — e tregoi robotin Peti.

Po kjo punë! Çdo gjë nga Semi duhej kërkuar? Nuk të vinte plasja? Duhej duruar paskëtaj edhe Gjergji. Do të tallej paq me ne dhe e kishte me hak.

— Nuk duhet të ngelemi në duart e Semit, — thashë fytyrëngrysur.

— Shëëët! Mund të të dëgjojë!

— Le të më dëgjojë! — shfryva duke parë me inat herë shifrat që ndryshonin në ekranin e vogël, herë antenëzat e robotit të heshtur. Më dukej se ai buzëqeshte me qesëndi për paaftësinë tonë.

— Përse bëhesh kokëfortë, Skerdi? Nuk ishte Semi që na çoi kaq lart? — këmbëngulte Peti.

Natyrisht që e kuptoja. Semi ishte ndërtuar të ndihmonte aeronautët në fluturim, po këmbëngulja më shumë nga inati pse nuk dija si drejtohej ordinatori. Kjo kokëfortësi nuk zgjati shumë.

— Sem, — i fola robotit duke iu afruar në largësi të përshtatshme, — duhet të kthehem. Si mund të kthehem në institut?

Roboti kësaj radhe heshti më gjatë. Në fillim kujtuam se aq e pati. Gjaku më ngriu në dej dhe djersa e ftohtë bulëzoi nën maskë.

— Më duket se kaq e patëm! — u ul i dëshpëruar, me sytë tek lartësimatësi, Peti.

— Përse bëhesh qaraman, more Peti? Ordinatori i balonës nuk e lejon të ngrihet më shumë se kufiri i lejuar. E shikon pesëmijëmetërshin?

Ndërkohë sytë e robotit ndryshuan ngjyrë dhe dëgjuam përgjigjen aq të dëshiruar: *Përcaktoni koordinatat e institutit!* *Përcaktoni koordinatat e institutit!*

U turrëm menjëherë për te harta aeronautike. Kishim mësuar disa gjëra për përcaktimin e koordinatave, po në atë mori vijash, izobaresh dhe shenjash sikur hutohesh. Petit i dridheshin duart, kurse unë, megjithëse isha i qetë, s'po orientohesha dot.

— I mban mend formulat? — kërkoj Peti.

— Jo të gjitha më kujtohen, — ia ktheva i mërzitur.

— Mua hiç fare! — tha i dëshpëruar shoku, — Kompjuteri sigurisht mund të na ndihmonte, po ne s'e dimë si përdoret...

— Vallë, duhet të dorëzohemi? — fillova të shtroja një nga një formulat që më kujtoheshin. — Kushdo mund të ndodhet në vështirësi.

Formulat i shtrova pak nga pak. Më duheshin disa të dhëna, prandaj, doja nuk doja, pyeta Semin. Ai ma ktheu përgjigjen shpejt e shpejt: *Kaloja zgjidhjen ordinatorit!* *Kaloja zgjidhjen ordinatorit!*

— Ja pra! — u ngrit në këmbë Peti pasi shoqëroi me sy veprimet e mia, shkrimin e zgjidhjes në tastierën e ordinatorit. Tani prisnim me ankth para tij. — Pesëdhjetë milje. E shikon, kemi fluturuar pesëdhjetë milje larg institutit.

Isha i kënaqur nga përfundimi i zgjidhjes. Maska ma fshihte buzëqeshjen, që Peti sigurisht do të ma merrte për mendjema-dhësi. Të paktën nuk isha turpëruar, dija të veproja në rastet e vështira.

— Kërkoj të ulemi në lartësinë gjashtë-qind metra, — i kërkova menjëherë robotit me shpresë se kështu mundet edhe të ktheheshim nga kishim ardhur.

Për habinë time më të madhe, me gjithë pritjen e gjatë roboti kësaj radhe nuk u përpitjen e

gjigj. Pyetjen e përsëriti edhe Peti, i njëjti rezultat. Roboti heshtte si mumje. Ç'të kishte ndodhur?

— Mos është prishur?

Ngrita supet. Pak më parë ishte fare mirë. Ç'dreqin kishte pësuar? Antenëzat vazhdonin të rrotulloheshin si më parë dhe drita e verdhë në të kaltërreme s'ishte fikur.

— Nuk do. Ka edhe ai huqet e veta, — bërtita me sa kisha në kokë.

Ju lutem, jo me ofendime! Ju lutem, jo me ofendime — vikati roboti i pabindur.

Kjo gjë na ngurosi të stepur. Kishim ngelur pa gojë. Roboti ishte në rregull, por s'donte t'u bindej urdhavrave. Në programin e tij sigurisht kishte defekt, për këtë ishim më se të sigurt. Edhe në shkollë kishte ndodhur që një nga robotët e prishur të hynte në klasë në vendin e mësuesit të historisë.

— Le të mos shpresojmë te Semi, — i thashë Petit, — Të dalim vetë nga kjo gjendje. Butonin e uljes tashmë e kemi mësuar.

— Çfarë presim? Shtype menjëherë!

Poshtë aerosatatit shtrihej vetëm ajër ngjyrëvjollcë. Shtëllungat e reve kishim kohë që i kishim lënë. Të vazhdonte ende ngjitja. punën do ta kishim pisk.

Nuk e zgjata më, shtypa butonin në pritjen e asaj që do të ndodhë. Njëqind metrat e parë të uljes i kaluam në heshtje të

þlotë, pastaj dora-dorës e morëm vëten dhe filluam të shëtitnim lart e poshtë korteve. Re s'dallonim. Një humnerë e zezë gllabëronte si e babëzitur ndriçimin e projektorëve të fuqishëm.

— Ulja ishte aq e shpejtë, sa filluam të ndienim një boshillëk të madh në stomak. Kjo gjë mbasë na vinte meqenëse ishim edhe të uritur.

Hiqni kostumet ajrore! Hiqni kostumet ajrore! ndërhyri pa e pyetur njeri roboti.

Ec e mos u nxeh po deshe! Kur e pyesnim ne, s'përgjigjej. Hoqa me kujdes kostumin tim ajror, pastaj i ndihmova edhe Petit. Në ftyrën e tij prekat spikatnin më shumë se kurrë ndonjëherë. Tani po, kishte të drejtë t'u fliste shokëve, jo atëherë me oktapodin!

— Pa dëgjo, — vuri veshin shoku.

Një zhaurimë të lehtë dëgjova edhe unë. C'të ishte? Ordinatori shënonte vetëm katërqind metra lartësi, po nuk po shikoja asnjë dritë apo shenjë tjetër toke.

— Më duken si zhurmë dallgësh, — bëri veshët pipëz Peti.

— Dallgë?!

— Jemi mbi det. Diku afër bregut, — tha i sigurt Peti.

Ndërhyra me shpejtësi tek ordinatori para se të bënim një banjë të mirë. Trupi më dridhej dhe tëmthat më rrihnin si çe-

kan. Aq zët e kisha marrë Semin, sa s'ia hidhja fare sytë.

Qëndronim të varur mbi det vetëm dy-qind metra lart. Balona luhatej lehtë nga puhiza detare dhe të vinte në gjumë.

— Ah, sa uri që kam! — nuk e përbajti thirrmën e një llupësi të vërtetë shoku im.

Befas Semi lëvizi mbi rrizujt, kaloi brenda në kabinë dhe u duk me një tabaka mbushur plot. Ndaloj para Petit dhe plot mirësjellje ia la para këmbëve.

Fillimisht nuk prekëm asgjë me dorë, por shpejt era e ushqimit na e hoqi atë kre-nari të kotë. C'faj kishte Semi, që ne nuk dinim të gjenim gjuhë të përbashkët me të? Në tabaka kishte gjithë të mirat: dy gota kakao, sallam, pasta, çokollata e pije oreks-ndjellëse, shoqëruar me bukë algash. Të gjitha këto i përlamë pér pak çaste.

Herë-herë i hidhним vështrime miqësore Semit, që na shikonte hijerëndë. Na ngushëllonte mendimi që Semi s'do t'i tregon-te kurkujt pér sa kishte ngjarë.

Darkën e thamë me një frymë. Sytë po na mbylleshin dhe lodhja e bëri të sajën. Edhe Semi dukej se flinte. Antenëzat s'po rrotulloheshin, kjo na bindi se duhej marrë një sy gjumë. Koshi i balonës as ngrihej, as ulej. Vendosëm të çlodheshim në kabinën e fjetjes, duke bërë rojë çdo dy orë.

Gjumi na kaplloi sytë dhe përkundjet e balonës na zgjuan vetëm në mëngjes. I pari u turr pranë borteve Peti.

— Eh! Shiko sa bukur!

Ishte e madhërishme pamja që po shikonim. Balona ngjyrëvjollcë luhatej rrëth dyqind metra mbi det, jo larg bregut. Cila forcë e mbante balonën në po atë vend? Kush e drejtonte me aq saktësi? Këto pyetje na vërtiteshin në kokë, por nuk u jepnim dot përgjigje.

Vija shkëmbore e bregut dredhonte mes plazhesh të vogla zhavorri. Dallgët përpinqeshin e thërrmoheshin në mijëra cikla të bardha.

Dita e re na e hoqi pak nga pak trishtimin. E përfytyronim veten aeronautë të sprovuar, pa përfillur rrezikun.

Semi vazhdoi të mos u përgjigjej pyetjeve tona. Kjo këmbëngulje e tij na dukej gjëja më e çuditshme. Fundja le të heshtte, patjetër me hapjen e ditës dikush do të na shikonte dhe do të na vinte në ndihmë.

— Delfinët, delfinët. Si u shkëlqejnë kurrizet! — thërriste vazhdimisht Peti.

— Kujdes! Mund të biesh poshtë, — qesha unë. Petit këto këshilla i shijonin të tharta fort. E si mund të ndodhë ndryshe? A nuk ishte ai rregulluesi i paneleve të ngrohjes në pallatet shumëkatëshe? Sa herë kishte hipur në lartësi të mëdha dhe nuk ishte

trembur? Nejse, të gjitha këto nuk m'i shfaqte, po përt'i menduar i mendonte, ama!

— T'i themi gjë? — tregoi me gisht robotin pasi iu fashit dëshira për të parë.

— Asgjë. Të gjitha do t'i zgjidhim vëtë, — u zhyta përsëri mbi hartë.

E dini që ky udhëtim tanë po më pëlqente? Vetëm për një gjë më brente ndërgjegjja, vëllait tim do t'i hiqnin vërejtje përsa kishin ndodhur.

— Sa mirë do të ishte të dinim si punon koordinatori! — vazhdoi të qahej Peti.

— Të paktën do të mësonim vendndodhjen.

S'po ia ndaja sytë ekranit të vogël, që vetëm heshtte me kokëfortësi. — Ata të shkollave më të larta sigurisht që do ta dinë... Këto fjale më sollën ndër mend Gjergjin. Kushedi sa do të ishte mërzitur. Aerostati i ndërtuar me aq mund e djersë ishte zhdukur pa lënë gjurmë. Pale në shtëpi! Sa shqetësime u sollëm familjeve fare kot. Me siguri që kërkimet për të na gjetur do të kishin filluar me kohë.

Një lëmsh mallëngjimi m'u mblodh në grykë, po nuk e dhashë vehten. Kaq donte Peti, që të lëshonte lotët rrëke, megjithëse mbahej si vrasës oktapodësh gjigantë.

— Çfarë po mendon? — më kapi nga supet shoku.

— Habitem, Peti, si nuk na kanë gjetur ende!

— Hëm! ... Edhe unë këtë po blua j
në kokë. Do të kujtojnë se unë jam në shtë-
pinë tënde e ti në timen.

— Kaq vonë?!

— E vërtetë është, shumë vonë, — po-
hoi Peti, pastaj vazhdoi me mëdyshje! —
Të them të drejtën mua m'u duk se në një-
rin prej planerëve që kaloi pak më parë pra-
në nesh dikush po na vëzhgonte.

— Po na vëzhgonte?! Unë s'pashë gjë.

— Po, bile edhe qeshi.

— Të kanë bërë sytë, — ia ktheva ta-
shmë i mësuar me zmadhimet e tij.

Paskëtaj një heshtje përfshiu koshin e
aerostatit. Dëgjohej vetëm zukatja e lehtë e
ordinatorit dhe syndezjet e kamerës së kon-
trollit. Dukej se diçka punonte në mënyrë
automatike, po ku po shkonim s'e dinim.
Roboti Sem, si të ishte zemëruar keq, vazh-
donte të mos u përgjigjej thirrjeve tona.

Dëshira e madhe për të fluturuar për-
sëri lart fitoi edhe një herë. Këtë mano-
vrim e mësuam mirë dhe veprimet i kryem
menjëherë. Në lartësinë 2500 metra nda-
lëm. Aty mundësia për t'u ndeshur me pla-
nerë ishte më e madhe. Përgatitëm flamujt
me ngjyra, ndezëm projektorët e sinjaleve,
por, meqenëse nuk dinim si përdorej tele-
ndërlidhësi, u mjaftuam me kaq. Peti u për-
ul edhe një herë përparrë robotit për t'i kër-
kuar ndihmë, por u zhgënjiye keq. Njeriu

prej metali vazhdonte kokëngjeshjen si mu-shkë e sertë.

— Nuk duhet ta kishim sharë! — shpre-hu dëshpërimin Peti.

— Mirë ia bëmë! Nga një robot do të varemi?! — klitha unë i fyter keq. — Nje-riu është më i fortë se makinat!

Këtë do ta shohim, fërshëlleu si papa-gall roboti.

Të gjitha duroheshin, po një paturpësi e tillë jo. Tashmë edhe Peti, pakëz më i du-ruar se unë, ishte nxehur keq. Kërkoi ta fikte fare robotin mosmirënjojës, veç kur arriti t'i afrohej më shumë se dy hapa, kur u zmbraps sikur të ishte djegur në stufë.

— Pëf! Më dogji! — futi gishtërinjtë në gojë. Unë s'e përmbajta të qeshurën, po shpejt heshta si me sustë. Goja m'u mpi, si të kisha ngrënë kumbulla të tharta nga një rrezatim që lëshoi roboti aty për aty.

U tërhoqëm në qoshen më të largët të koshit. Kushdo do të na ngatërronte me dy qenushë të rrahur përpala kolibës së vet. Dëshironim më shumë se kurrë ta hidhnim nga borti këtë shkurtabiq të shëmtuar, po s'na e mbante. Roboti vogëlush deri në këto çaste kishte triumfuar mbi ne.

Befas, në lartësinë dy mijë e pesëqind metra, ku fluturonim, ndiem një të ftohtë jo të zakonshëm.

— Ç'po ndodh kështu, — u habit Pe-
ti, — kam shumë ftohtë! . . .

Jeni futur në një masë ajri të ftohtë.
Vishni kostumet! Maskat e rrallimit të ajrit
mos i hqani! — paralajmëroi disa herë ro-
boti. Ky njoftim na ndihmoi mjaft. Ende s'e
besonim që këto fjalë na i kishte thënë ro-
boti i pabindur.

Një mjegull e hollë, shumë e ftohtë, përfshiu aerostatin mes një mizërie piklash që përplaseshin në tekstolit, litarë e bortet plasti. Pamë me tmerr se këto pika ngrinin menjëherë porsa preknin diçka. Mbi qer-
pikë, në flokë, kudo krijohej një brymë që sa vinte e trashej. Aq shpejt ndodhët akullzimi, sa nuk kishte kohë të fshije ekranet e ordinatorit. Gjendja paraqitej mjaft e rrezi-
kshme. Dëborë s'na dukej se ishte, po çfarë po ndodhë, nga kishte ardhur gjithë ky akull?!

Ndërkokë duart dhe këmbët na rëndo-
nin nga pesha. E njëjta gjë me sa dukej po
ndodhë edhe me balonën. Nga kjo peshë
po i merrej fryma dhe kishte rrezik të pér-
plasej. Litarët e koshit ishin trashur dhe
shkëlqenin. Ordinatori tregonte një ulje që
sa vente shtohej nga kjo ngarkesë e paftuar.
Çarçafi i akullit mbuloi bortet, madje edhe
dyshemenë. U bë e pamundur edhe ecja në
të, pasi rrëshqitje.

— Të dalim menjëherë nga kjo zonë!

— i thashë Petit të zverdhur dyllë në fytërë.

— Ç'është kjo dëborë në këtë lartësi?!

— mërmëriste herë-herë Peti.

— Nuk është dëborë. Të kujtohet mësimi për pikat e mbiftohura? Menjë prekje të vogël materiale këto pika kthehen në akull. Jemi në rrezik.

Koshi vazhdoi të rëndohej. Ordinatori shënonte ulje, megjithëse komandimi ishte ndalje në vend.

— Nuk ka më shpejtësi.

— Është e kotë, rryma e pikave të mbiftohura ecën bashkë me ne.

Si të bënim?! Ngrirja vazhdonte pa ndërprerje dhe s'kishte shenja se mund të largohej. Ishim veshur me një shtresë akulli dhe dukeshim si arinj polarë. Lëvizjet në kosh u vështirësuan shumë. Maskat e ajrit mund të bllokoheshin. Ky mendim na ngriu gjakun.

Papritur Semi filloi nga paralajmërimet: *Rrymë e akullt!. Kujdes! Rrymë e akullt. Kujdes!*

Sa shpejt ishte kujtar! Shoqëria e pakëndshme me robotin tekanjoz na turbullonte edhe më shumë.

— Fundja le të përdorim katapultën e shpëtimit, — tha me zë të shuar Peti.

Çfarë përgjigje t'i ktheje?! E kisha të humbur nga kjo gjendje e rrezikshme, po

nuk doja kurrsesi të dëshpërohesha. Një ide e vagëlluar më ngacmonte vazhdimisht. Sikur të ngriheshim pakëz më lart. Rrezet e diellit, që diku përgjonin atë mëngjes pranvere, s'mund të na linin në baltë.

— Them se na duhet të ngrihem më lart, Peti.

— Më lart?! Je në vete?! — u tremb Peti. — Të presim, dikush do të na ndihmojë me siguri.

— Asgjë s'duhet pritur nga të tjerët. Në radhë të parë përpjekjet duhet t'i bëjmë vetë, — ia ktheva me një vendosmëri të pritur dhe ngadalë iu avita ordinatorit. Mes atij akullzimi çdo gjë mbulohej me një brymë që vështirësonte shumë ecjen. Megjithatë veprova saktë dhe pa as më të voglin ngurrim. Prania e Semit syverdhë më ngacmonte, por nuk i dhashë rëndësi.

Cudia ndodhi me të vërtetë, porsa u ngjitëm njëqind metra më lart. Dielli ndriste i fortë dhe i bukur. I ftohti dalëngadalë filloj të dobësohej dukshëm.

— Fituam... Fituam... Akulli po shkrihet! Shpëtuam nga rreziku! — bërtiste si i marrë Peti duke më shtrënguar duart.

— Të thashë unë, — mërmërita i lumbur.

Tashmë rrezet e ngrohta filluan ta kthenin në ujë të pastër brymën e rrezikshme. Koshi bashkë me balonën ishin çiruar nga

pesha e padëshirueshme. Ishte çasti më i vështirë, por më i bukur i këtij fluturimi të papritur. Çdo gjë në këtë lartësi më dukej e bukur.

Ende s'e kishim marrë veten nga kjo e papritur e këndshme, kur në ekranin e teledërlidhësit u shfaq pa asnje komandim një fytyrë tepër e njojur. Ishte Gjergji, dora vetë. Fytyra i queshte. Unë, që e njihja mirë tim vëlla, dallova menjëherë ironinë e zakonshme.

Peti gati sa nuk u rrëzua nga bortet. Vetë isha aq i hutuar e pak më pas edhe i dëshpëruar nga qeshja e Gjergjit, sa padashur shtypa një buton të ordinatorit. Tinguilli i mprehtë e paralajmërues i Semit nabi i të qartë se s'duhej të preknim asgjë pa leje. Të gjitha u qartësuān, aerostati gjatë gjithë kohës komandohej nga toka, kurse ne mendonim për heroizma.

— U habitët? Kështu është kur hipni pa leje në balonën e të tjerrëve, — vazhdonte të fliste Gjergji në telendërlidhës.

— Ne... Ju ku jeni?! — pëshpërita disa fjalë të shkëputura.

— Ne ku jemi?! — mezi e mbante të qeshurën Gjergji. Fytyra e shtrirë, pakëz e skuqur, tregonte se im vëlla pak donte t'ia shkrepente një të qeshuri të hareshëm. — Jemi në tokë, sigurisht. Po ju, more aero-

ħautē tē famshëm, çfarë doni kaq lart tokës?!

— Po na dëgjojnë!... Po na dëgjojnë!... Jemi vënë nē lidhje, — hidhej përpjetë Peti.

Mua më vinte plasja. Që dikush na kishte vënë nē lojë, nuk diskutohej, po si e tek ende s'e kisha tē qartë.

— Mos bëj si kalama! — i ndala gëzimin Petit.

— Si! Po nuk e shikon têt vëlla! Nuk e shikon që nga toka kanë mësuar vendndodhjen tonë!

— E shikoj, — ia preva. — Po ti, nuk e shikon dhe aq më shumë nuk e kupton që s'kemi flutruuar vetëm?!

— Si nuk kemi flutruuar vetëm?! — ngeli me gojë hapur pikaloshi.

— Na kanë kontrolluar që nga poshté, — thashë pa ua ndarë sytë dy pikave që sa venin e zmadhoheshin. Tashmë po më kujtohej edhe zéri i Gjergjit nëpërmjet robotit.

Petit i ngriu buzëqeshja nē buzë. Tashmë diċċa po kuptonte. I vinte më shumë inat pér frikën e tij pak çaste më parë. Asgjë nuk do tē ndodhte. Me rrezikun e parë, apaturat do ta drejtonin balonën sipas komandimit nga toka. Sigurisht edhe budallallëget që kishim thënë ishin regjistruar me hollesi. Hej, bela! C'mund t'u thoshe paskëtaj shokëve, që prisnin gojëhapur. Këto mendi-

me të zymta mund t'ia lexoje lehtë në fytyrë shokut tim.

— Mbërritën edhe planerët, — tregova në drejtim të pikave që tanimë ngjanin me dy brumbuj të mëdhenj.

Afrimin e planerëve e pritëm në heshje, pa ndonjë gëzim të veçantë. Më vonë dalluam pas mburojave plastike fytyrat aq të njoitura të Gjergjit. Luljetës, Bledit dhe dy të rinxve të tjerë që na përshëndetnin me duar.

— Mos e lësho veten, — i pëshpërita Petit.

Por ishte e kotë ta këshilloje. Pikaloshi, që i kishte qejf bëmat, mbante një qëndrim prej kapiteni të madh, thua jse ky fluturim i papritur të ishte më se i zakonshëm dhe planerët që po afroheshin, miza të papërfillshme.

Këto çastë ishin me të vërtetë komike. Po ne vetëm dy ditë më vonë u bindëm përkëtë.

6

E papritura më e këndshme ishte pritia që na u bë. Askush nuk na qortoi, askush nuk e përfoli për të këq grabitjen e aerosta-

tjt. Babai im dhe i Petit, me gjithë punët e rëndësishme që kishin, erdhën vetë për të na pritur. Pjesa më e madhe e turmës na tregonte me gisht. Për fluturimin e papritur kishte shkruar gazeta «Pionieri shkencëtar», madje edhe kanali i fëmijëve në televizion transmetoi një emision të posaçëm.

E kush e mendonte të tillë lavdi. Petit, edhe në zmadhimet më të guximshme, nuk do t'i kishte shkuar ndër mend një gjë e tillë.

Posaçërisht për këtë qëllim atë pasdite u organizua një bisedë e gjerë me temën: «Fluturimi i papritur me aerostatin numër 5». Natyrisht të gjitha këto i kishte përgatitur Gjergji me shokë.

Përshtypjet dhe mbresat e ditës nuk më lanë të merrja frymë, megjithëse nuk më mbante vendi. Dëshiroja të bisedoja gjatë me tim vëlla për çka kishte ndodhur. Rasti m'u dha vetëm në darkë.

— Gjergji!?

— Si është puna? — u shkëput vëllai nga një videokasetë ku kishte regjistruar pa-mje nga ekspeditat në Mars.

— Duhet të më falësh, — fillova pak nga pak.

— E përse?! — u shtir i habitur vëllai.

— Të kam lexuar ditarin. Të kam gjetur pusullën. Të kam përgjuar, — vazhdova pastaj me një frymë, — por jo me qëllim të

keq. Desha ta shikoja nga brenda aerostatin...

— Vetëm kaq?!

— Fundja, po të më merrje, edhe të fluturoja.

— Të gjitha këto i kam ditur, — më rrahu shpatullat vëllai.

— I ke ditur?! — shtanga. — Si i ke ditur?!

— Të kam thënë që ti, Skerdi, do bë-hesh shkencëtar!

— Ë, mo, léri këto! — vara buzët.

— E vlerësoj kureshtjen tënde, prandaj edhe nuk të pengova...

— Nuk më pengove?! Po ju humbët konkursin! — ia ktheva me gjysmë zëri.

— Përkundrazi. Lexoji këta rreshta! — më zgjati një gazetë. Përbajtja e rreshtave sikur më dha flatra. Ja çfarë shkruhej: *Gru-pi i shkollës së mesme «Rilindja» me shumi-cë votash fitoi konkursin e ndërtuesve. Aerostati me komandim elektronik, i aftë për-studime të ndryshme aeronautike, kaloi pro-vën më të mirë gjatë fluturimit të papritur me dy pionierë kureshtarë. Aparatet e ndër-lidhjes, sistemi i komandimit me ordinator, funksionuan në mënyrë të shkëlqyeshme. U urojmë pjesëtarëve të këtij grupei suksese në fluturimin e ardhshëm... Këto shkruheshin me shkronja të mëdha e të qarta.*

— Më duhet t'ia them menjëherë Petit,
— kërcëva në videofon.

— Mos u mundo. Ia ka thënë e motra, — buzëqeshi Gjergji. — Çdo gjë e dinte edhe Enkelejda. Në fillim sikur u step për lojën, por, kur u bind që nga fluturimi s'kishte asnjë rrezik, pranoi të bashkëpunonte me ne. Edhe punën e ftesave e dimë.

— Pra, na keni tallur paq! — u vrenjta në fytyrë.

— Nuk e besoj të jetë tallje, — më ngushëlloi im vëlla. — Aparaturat tona të ndjeshme e kapën menjëherë afrimin tuaj në balonë. I morëm leje profesor Bardhylit, njëkohësisht edhe babait, pastaj çdo gjë u programua nga kompjuteri.

— Po Semi? — pyeta papritur.

— Ah, Semi! — ia plasi të qeshurit Gjergji. — Semi i pabindur!

— Një robot të prishur nuk ke ç'e do!

— Jo, vëllaçko, Semi është një robot i mrekullueshëm. Por Enkelejdës i shkrepit një mendim. Semin e urdhëruam t'ju kundërshtonte për të parë si do të vepronit ju në rastet e vështira.

— Bobo! Kushedi sa do të kenë qeshur me ne, me fytyrat tona të zverdhura, me fjälët tona të pamatura!

— Të gjitha i kemi regjistruar në videokasetë. — shtypi një buton.

Përpara syve kaluan pamjet e aerostatit, hyrja jonë e fshehtë, frika nga ngritja e pa-

pritur, lëvizjet para ordinatorit të pakuptueshëm, zënkat me Semin.

Nuk kisha q'të thosha. Goja më ishte mbyllur, po krenarinë të paktën nuk e kisha humbur. Në të gjitha rastet isha treguar burrë.

— Këtë gjë e pranuam të gjithë, — sikur e kuptoim mendimin tim Gjergji. — Disa shokë të mi menduan se ju do të lebetiteshit, përveç meje. Unë e njoh karakterin tënd, Skerdi, dhe për këtë të uroj nga zemra. Ju lumtë!

— Ta pret mendja, — u ngrefosa pakëz. Im vëlla e kishte kuptuar që tashmë nuk isha fare i vogël, diçka merrja vesh edhe unë nga punët e të mëdhenjve. Këto sigrisht nuk ia thashë, se do t'i merrte përmbyrrje.

— Kemi vendosur t'ju pranojmë anëtarë të grupit tonë shkencor, — shtoi pas pak Gjergji.

— Ne!? Mua dhe Petin?!

— E meritoni. Vetëm për qëndrimin dhe llogaritjet e sakta të koordinatave, — tha pa as më të voglin ngurrim im vëlla.

Të nesërmen, si zakonisht, Petin e takova përpara ndërtesës shumëkatëshe të PT së. Dukej se kishte ardhur më herët se zakonisht dhe ishte mërzitur nga vonesa ime.

— Përherë më pas do të vish! — shprehu pakënaqësinë e vet, duke trokëllitur, si

gjithmonë, gjithfarë sendesh në xhepat ë mëdhenj.

— Sot kemi elekroteknikë?

— Kemi... Përse pyet?

— Po ta kishim studuar me vëmendje këtë lëndë, nuk do të na kishin vënë në lojë Gjergji me shokë.

— Mos ma kujto... Fajin ma ka edhe Enkelejda! — s'u përbajt Peti.

— Asnjeri nuk na ka faj. Të paktën na e plotësuan dëshirën për fluturim, këtë mos e harro. Bile na pranuan edhe anëtarë nderi të grupit.

— Vërtet?! — fërshëlleu pikaloshi.

— Unë asnjëherë nuk gënjej! — ia përplasa me vendosmëri.

Përpara nesh autobusët pa shoferë ndalonin, tingëllonin sinjalin e hipjes, por, pasi asnjëri nga ne s'vendoste, rrëshqitnin lehtë në asfaltin e zi.

— E di, Skerdi, — tha befas Peti, — këtej e tutje nuk do të zmadhoj asgjë. Do të them vetëm të vërteta.

Betim më të madh se ky s'kishte thënë ndonjëherë Peti. Ia shtrëngova fort dorën dhe gati sa nuk e putha në faqe.

— Kam një ide, — shtova pas pak.

— Me gjithë mend? — prekat në hundën e shokut u shtuan menjëherë. — Ma trego!

— Ta them në pushim...

Përpara nesh ndaloj një autobus. Hippëm menjëherë, duke u rehatuar në kolltukët e ajrit. Peti më shikonte drejt në sy i përfshirë nga një kureshtje e madhe çfarë do t'i thosha. Kjo gjë mua më pëlqente më shumë nga të gjitha,

PERMBAJJA